



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY

PUNIM SHKENCOR

FAKULTETI JURIDIK

MASTER - E DREJTA PENALE

TEMA:

**Vepra penale kundër trupit dhe jetës si vepër
penale e posaçme në rrethin e Gjykatës themelore
në Tetovë për periudhën 2012-2017**

Mentor:

Prof. Dr. ISMAJL ZEJNELI

Studentja:

HABIBE IDRIZI

Tetovë 2018



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY

PUNIM SHKENCOR

FAKULTETI JURIDIK

MASTER - E DREJTA PENALE

TEMA:

**Vepra penale kundër trupit dhe jetës si vepër
penale e posaçme në rrethin e Gjykatës themelore
në Tetovë për periudhën 2012-2017**

Mentor:

Prof. Dr. ISMAJL ZEJNELI

Studentja:

HABIBE IDRIZI

Tetovë 2018

Përmbajtja

| | |
|--|-----------|
| Parathënie..... | 4 |
| 1. Vepra penale e vrasjes..... | 6 |
| 2. Format e veprës penale të vrasjes..... | 7 |
| 2.1. Vrasja | 7 |
| 2.2. Vrasja e kualifikuar | 10 |
| 2.3. Vrasja në mënyrë mizore..... | 11 |
| 2.4. Vrasja në mënyrë tinëzare (dinake)..... | 11 |
| 2.5. Vrasja me dashje, me ç’rast rrezikohet jeta e personave të tjerë..... | 12 |
| 2.6. Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore | 60 |
| 2.7. Vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale..... | 61 |
| 2.8. Vrasja nga hakmarrja e paskrupullt..... | 61 |
| 2.9. Vrasja për motive të ulëta..... | 62 |
| 2.10. Vrasja në bazë të porosisë | 62 |
| 2.11. Vrasja e gruas shtatzënë | 62 |
| 2.12. Vrasje për motive fisnike - eutanazia | 63 |
| 2.13. Vrasja nga pakujdesia..... | 63 |
| 3. Faktorët objektivë dhe subjektivë që ndikojnë në veprën penale të vrasjes..... | 65 |
| 3.1. Varfëria..... | 65 |
| 3.2. Papunësia..... | 66 |
| 3.3. Migrimi i popullsisë | 67 |
| 3.4. Kushtet e vështira të banimit..... | 67 |
| 3.5. Konfliktet politike | 68 |
| 3.6. Arsimimi..... | 69 |
| 3.7. Mjetet e informimit | 71 |
| 3.8. Faktorët subjektivë | 71 |

| | | |
|-----------|---|-----------|
| 3.8.1. | <i>Personaliteti</i> | 71 |
| 3.8.2. | <i>Karakteri</i> | 72 |
| 3.8.3. | <i>Temperamenti</i> | 72 |
| 3.8.4. | <i>Shprehitë, prirjet dhe kriminaliteti</i> | 74 |
| 3.8.5. | <i>Inteligjenca</i> | 75 |
| 3.8.6. | <i>Emocionet</i> | 75 |
| 3.8.7. | <i>Motivet</i> | 76 |
| 4. | Viktimat e krimeve të vrasjes | 77 |
| 4.1. | Raporti ndërmjet viktimës dhe kryerësit të krimit te krimi i vrasjes..... | 77 |
| 4.2. | Motivet e viktimizimit te vrasjet..... | 78 |
| 4.3. | Mosha e viktimave të vrasjes..... | 78 |
| 4.4. | Gjinia e viktimave të vrasjes..... | 79 |
| | Përfundim | 81 |
| | Literatura | 83 |
| | <i>I - Libra</i> | 83 |
| | <i>II - Burime të tjera</i> | 84 |

Parathënie

Sa i përket temës së hulumtimit të kriminalitetit, si dukuri negative, mund të thuhet se kriminaliteti është i përhapur në forma të ndryshme në mbarë botën. Një ndër format e krimit është edhe krimi i vrasjes. Me vrasje nënkuptojmë privimin e kundërligjshëm të një personi nga jeta. Ky privim themi se është i kundërligjshëm për arsye se është në kundërshtim me të gjitha aktet më të larta, si ndërkombëtare, ashtu edhe të brendshme. Por, përkundër masave të ndryshme të mbrojtjes së njeriut sot, njeriut për çdo ditë po i rrezikohet e drejta themelore, që është e drejta për jetë.

Vrasja si krim më i rëndë me të cilin cenohet njëra nga të drejtat më themelore të njeriut, siç është e drejta për jetë, është prezente edhe në qytetin e Tetovës. Tetova shpesh po ballafaqohet me dukurinë e vrasjes, e cila në vitet e fundit është në rritje të vazhdueshme. Karakteristike për vrasjet, janë llojet e shumta të saj, edhe pse të gjitha nuk janë prezente në qytetin e Tetovës. Po ashtu, edhe mënyra e kryerjes së tyre është e veçantë nga krimet e tjera. Vrasja si krim, ka qenë prezente në të gjitha shoqëritë, që nënkupton se nuk kemi të bëjmë me një vepër të panjohur, por karakteristike është se format dhe përsosmëria e kryerjes së saj kanë ndryshuar dhe do të ndryshojnë edhe në të ardhmen.

Veprën penale kundër jetës dhe trupit e kam zgjedhur si temë për punimin tim hulumtues, me qëllim që të njihemi me disa karakteristika të saj dhe të kryerësve të vrasjes. Po ashtu, të njihemi se sa është prezente kjo në Tetovë. A shënon rritje apo ulje. Kush bën pjesë në vrasje, mosha më të rritura apo edhe të miturit janë të përfshirë në vrasje. Sa zbulohen kryerësit e veprës penale të vrasjes, sa është numri i aktgjykimeve në Gjykatën themelore të Tetovës lidhur me vrasjet. Për këtë punim kam shfrytëzuar literaturë profesionale, Kodin penal të Republikës së Maqedonisë, të dhëna nga Gjykata themelore e Tetovës, të dhëna nga Sektori për punë të brendshme në Tetovë dhe të dhëna të tjera nga interneti. Gjatë hartimit të këtij punimi jam shërbyer me metodën dogmatike-normative, me metodën e studimit të rasteve, me metodën statistikore, me metodën krahasuese, me metodën e analizës, me metodën e studimit kritik etj.

Vepra penale kundër jetës dhe trupit është prezente edhe në RM. Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit janë të shumtë. Në vijim të punimit do t'i përmendi format e veprave penale kundër jetës dhe trupit të cilat janë të shumta si: vrasja e kualifikuar, vrasja në mënyrë mizore, vrasja në mënyrë tinëzare, vrasja me dashje, vrasja pa dashje etj. Të gjitha veprimet të cilat ndërmerren me qëllim të privimit të një personi nga jeta

janë në kundërshtim me të drejtën themelore të njeriut, që është e drejta për jetë. Edhe Deklarata universale e të drejtave të njeriut e vitit 1948 e garanton të drejtën e jetës, të lirisë dhe të sigurisë së personit. Faktorët që kanë ndikim të posaçëm janë faktorët objektivë dhe subjektivë që kanë një rol vendimtar në paraqitjen e dukurisë së vrasjes.

Gjithashtu, i kam përmendur edhe viktimat e krimit të vrasjes. Në brendi të punimit kam paraqitur dy aktgjykime që i kam marrë nga Gjykata themelore e Tetovës. Qëllimi im në këtë punim është që të njihemi më së afërmi me një nga krimet më të përhapura në Tetovë, si dhe të paraqes informacione të ndryshme të cilat i kam marrë nga burime të ndryshme, me qëllim që kjo vepër të shpjegohet ashtu siç duhet, me të gjitha elementet e saj.

Punimin hulumtues e kam ndarë në katër kapituj. Në kapitullin e parë kam shkruar për veprën penale të vrasjes. Në kapitullin e dytë, për format e saj dhe të dhëna statistikore nga burime të ndryshme me të cilat jam shërbyer. Në kapitullin e tretë i kam pasqyruar faktorët të cilët ndikojnë në kryerjen e vrasjes. Në kapitullin e katërt kam folur për viktimat e krimit të vrasjes.

1. Vepra penale e vrasjes

Veprat penale kundër jetës janë vepra më të rënda sepse ato cenojnë të drejtën për të jetuar si një e drejtë më e çmuar dhe themelore, e cila njëkohësisht është e garantuar edhe me kushtetutë, edhe me aktet ndërkombëtare¹.

Respekti ndaj jetës së njeriut dhe integritetit trupor paraqet bazën elementare të civilizimit tonë. Historia e njerzimit është edhe historia e luftës së njeriut për ekzistencën (mbijetesën) e tij fizike kundër vetvetes (për dallim nga bota shtazore, në të cilën armik i njërit lloj është lloji tjetër, ndërkaq armiku më i madh i njeriut është, siç thuhet, vetë njeriu!). Sot nuk ekziston legjislacion penal që nuk u ofron mbrojtje këtyre të mirave themelore dhe më të vlefshme të njeriut. Vetëdija për karakterin e tyre universal është inkorporuar edhe në shumë dokumente ndërkombëtare të rëndësishme fundamentale për liritë dhe të drejtat e njeriut (kështu: Deklarata universale për të drejtat e njeriut e OKB-së e vitit 1948, neni 3; Pakti për të drejtat civile dhe politike, neni 6, ku thuhet: Çdo njeri ka të drejtën e lindur në jetë, që duhet të mbrohet me ligj; askush nuk mund në mënyrë arbitrare të privohet nga jeta). Pacenueshmëria e jetës dhe integriteti trupor tek ne është ngritur në rang të parimit kushtetues (neni 10 i Kushtetutës së RM-së).

Vrasja, në Kodin penal të RM-së është përkufizuar në formë të thjeshtë, si privim i jetës nga personi tjetër. Ai që tjetrin e privon nga jeta, dënohet me burgim prej së paku pesë vjet.²

Krimet ndaj jetës dhe trupit në shkencën juridiko-penale dhe në kriminalistikë, cilësohen si një ndër format më të rënda të atakimit të vlerave dhe të të mirave më të shtrenjta të njeriut, megjithëse ato në masën e përgjithshme të krimeve të kryera, nuk janë edhe aq masive. Mirëpo, fakti se me veprimet e tilla kriminale atakohet jeta dhe trupi, rrezikohet shëndeti dhe siguria fizike e njeriut, ato shpesh zënë vend qendror në trajtimet e ndryshme kërkimore-hulumtuese.

¹ I. Zejneli, “E drejta penale pjesa e posaçme”, Tetovë 2007, fq. 17

² I. Zejneli, “Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë”, Tetovë 2018, fq. 76

2. Format e veprës penale të vrasjes

Në vitet e fundit, në qytetin e Tetovës vërehet një rritje e numrit të veprës penale të vrasjes si dhe të formave të saj.

Si forma të cilat më shumë paraqiten janë:

- Vrasja
- Vrasja e kualifikuar
- Vrasja në mënyrë mizore
- Vrasja në mënyrë tinëzare (dinake)
- Vrasja me dashje me ç' rast rrezikohet jeta e personave të tjerë
- Vrasja me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore
- Vrasja me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë veprë penale tjetër
- Vrasja për hakmarrje të paskrupullt
- Vrasja për motive të ulëta
- Vrasja në bazë të porosisë
- Vrasja e gruas shtatzënë
- Vrasja për motive fisnike
- Vrasja nga pakujdesia
- Vrasja e foshnjës gjatë lindjes (fëmijëvrasja)

Këto janë disa nga format e vrasjes të cilat janë të parapara në Kodin penal të RM-së, edhe pse të gjitha nuk janë prezente në qytetin e Tetovës. Në vazhdim do t'i përmend përkufizimet e këtyre formave të vrasjeve.

2.1. Vrasja

Me vrasje nënkuptojmë atë vepër të kundërligjshme, me anë të së cilës i merret jeta një personi tjetër, me dashje ose nga pakujdesia. Përveç veprës themelore të vrasjes ekzistojnë edhe vepra të kualifikuara dhe të privileguara të vrasjes, të cilat nga vepra themelore dallohen me

disa rrethana shtesë, siç janë: mënyra e kryerjes, karakteristikat e viktimës, rrethanat subjektive dhe të ngjashme.³

Objekti i mbrojtjes të të gjitha veprat e vrasjes është jeta e njeriut. Veprimi i kryerjes është përcaktuar nëpërmjet shkaktimit të pasojës: privimit nga jeta dhe çdo veprim me të cilin shkaktohet vdekja e një personi. Pasoja qëndron në paraqitjen e vdekjes. Vepra konsiderohet se është përfunduar në momentin e paraqitjes së vdekjes.

Subjekt i veprës penale të vrasjes mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën e caktuar me ligj, për përgjegjësi penale. Vrasja mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia. Për veprën penale të vrasjes është paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje prej së paku pesë vjet. Forma e rëndë e veprës penale të vrasjes është paraparë nëse kryhet në këto raste: po qe se tjetri privohet nga jeta në mënyrë të paskrupullt; po qe se tjetri privohet nga jeta me paramendim; po qe se tjetri privohet nga jeta për arsye të ndonjë interesi ose për t fshehur ndonjë veprë tjetër penale etj.

Metodat dhe mjetet që përdoren për t'i shkaktuar vdekjen me dhunë personit në mënyrë të kundërligjshme janë të shumta. Metodatat janë: mbytja me lak, me duar, në ujë, vrasja, shkaktimi i dëmtimeve trupore, djegia, helmimi, mosdhënia e ndihmës ose mostregimi i kujdesit për foshnjën. Mjetet janë: armë zjarri, armë të ftohta, mjete të rastit, si shkop, gurë, sëpatë, çekiç etj., lëndë helmuese, objekte që shtypin rrugët e frymëmarrjes, si shami, litar, tel, peshqir, duar etj., rrymë elektrike, temperatura të larta ose të ulëta. Në praktikë, për vrasje më shumë përdoren armët e zjarrit, armët e ftohta dhe mjetet e rastit⁴.

Sipas të dhënave të Gjykatës themelore të Tetovës, gjatë periudhës së viteve 2012 - 2017 janë regjistruar gjithsej këto vepra penale të vrasjes:

Në vitin 2012 janë regjistruar gjithsej 610 raste, prej të cilave 14 lëndë për vepër penale të vrasjes dhe të gjitha janë zgjidhur. Ndërsa, sa u përket të miturve, në po të njëjtin vit kemi vetëm një rast dhe i njëjti është zgjidhur.

Në vitin 2013 janë regjistruar gjithsej 709 raste, prej të cilave 4 lëndë për vepër penale të vrasjes dhe të gjitha janë zgjidhur. Ndërsa, sa u përket të miturve, në po të njëjtin vit kemi vetëm një rast dhe i njëjti është zgjidhur.

³ I. Zejneli, "Edrejta penale pjesa e posaçme", Tetovë 2007, fq.19

⁴ V. Latifi, "Kriminalistika", Prishtinë 2006

Në vitin 2014 janë regjistruar gjithsej 691 raste, prej të cilave 6 lëndë për vepër penale të vrasjes dhe të gjitha janë zgjidhur. Ndërsa, sa u përket të miturve, në po të njëjtin vit nuk është regjistruar asnjë rast.

Në vitin 2015 janë regjistruar gjithsej 762 raste, prej të cilave 7 lëndë për vepër penale të vrasjes dhe të gjitha janë zgjidhur. Ndërsa, sa u përket të miturve, në po të njëjtin vit nuk është regjistruar asnjë rast.

Në vitin 2016 janë regjistruar gjithsej 768 raste, prej të cilave 10 lëndë për vepër penale të vrasjes, prej të cilave 9 raste janë zgjidhur, kurse 1 rast ka mbetur i pazgjidhur. Sa u përket të miturve, në po të njëjtin vit janë regjistruar 2 raste dhe që të dyja janë zgjidhur.

Në vitin 2017 janë regjistruar 775 raste, prej të cilave 16 lëndë për vepër penale të vrasjes, prej të cilave 10 janë zgjidhur, kurse 6 kanë mbetur pa u zgjidhur. Sa u përket të miturve, në po të njëjtin vit janë regjistruar 4 raste, prej të cilëve vetëm 1 është zgjidhur, kurse 3 të tjerë kanë mbetur pa u zgjidhur.

Këto janë vetëm disa raste të cilat janë paraqitur për shqyrtim në Gjykatën themelore të Tetovës, por ka edhe një numër bukur të madh të rasteve të cilat nuk janë të paraqitura në gjykatë apo në Sektorin e punë të brendshme.

Në vazhdim do t'i paraqes në mënyrë tabelare të dhënat lidhur me numrin e padive për vrasje që janë shqyrtuar nga Gjykata themelore e Tetovës.

| Viti | Gjithsej / Vrasje |
|-------------|--------------------------|
| 2012 | 14 |
| 2013 | 4 |
| 2014 | 6 |
| 2015 | 7 |
| 2016 | 10 |
| 2017 | 16 |

Sa u përket padive për vrasje në Gjykatën themelore të Tetovës, në bazë të të dhënave kemi këtë sqarim: në vitin 2012 ka pasur 14 padi, ku të paditur janë 10 persona të moshës madhore dhe 4 të mitur; në vitin 2013 ka pasur 4 padi, ku personat e paditur janë persona të moshës madhore; në vitin 2014 kemi 4 padi, ku 3 të paditur janë të moshës madhore, kurse 1 është i mitur; në vitin 2015 ka pasur 7 padi, ku 5 të paditur janë të moshës madhore, kurse 2 i kemi të moshës së mitur; në vitin 2016 ka pasur 10 padi, ku të gjithë të paditurit i përkasin moshës madhore; në vitin 2017 kemi 16 padi, ku 12 të paditur janë të moshës madhore, kurse 4 të paditur janë të mitur.

2.2. Vrasja e kualifikuar

Vrasja e kualifikuar (e rëndë) është privim i paramenduar i tjetrit nga jeta, i kryer në rrethana specifike rënduese, të përcaktuara me ligj, që e ngrenë shkallën e padrejtësisë dhe të fajësisë së kryerësit, për të cilat ligji për këtë vepër parasheh dënim të rëndë (burgim të përjetshëm). Vrasja e kualifikuar dallohet nga vrasja e rëndomtë sipas rrethanave të caktuara kualifikuese të natyrës objektive ose subjektive⁵. Rrethanat që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes: Vrasja në mënyrë mizore, vrasja me vënien në rrezik të jetës edhe të ndonjë personi tjetër. Rrethanat subjektive që kanë të bëjnë me motivet e kryerësit: Vrasja nga lakmia për shkak të kryerjes ose fshehjes së veprës tjetër penale, vrasja nga hakmarrja, nga motive tjera të ulëta: si vrasja në bazë të porosisë⁶.

Sipas një artikulli nga Agjencia Informative e Maqedonisë (MIA), Maqedonia llogaritet si vend i pasigurt. Sipas Entit statistikor "Eurostat" të BE-së, Maqedonia radhitet ndër vendet e pasigurta në Evropë. Vetëm Shkupi, me vrasjet në rritje radhitet në radhët e kryeqendrave të pasigurta si Bratislava, Belfasti dhe Praga, ku krimi dhe vrasjet që mbulojnë kronikën e zezë, janë në përmasa shqetësuese.

Të gjitha kryeqendrat e tjera rajonale si Tirana, Sofja, Beogradi dhe Zagrebi janë me mesatare më të ulët të vrasjeve sesa Shkupi. Eurostatit ka bërë të ditur se mesatarja prej 40 vrasjeve në vit në Maqedoni është shumë e lartë për një vend të vogël si Maqedonia⁷.

Numri i shtuar i vrasjeve si dhe incidentet e natyrave të tjera e bëjnë Maqedoninë vend gjithnjë e më të pasigurt, për të bërë një jetë normale. Të dhënat statistikore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të publikuara nga INA, flasin se vetëm në vitin 2012 në Maqedoni kanë ndodhur 36 vrasje.

Vrasjet makabre në të shumtën e rasteve janë realizuar me armë zjarri. Më së shumti vrasje, përkatësisht 12 vrasje, kanë ndodhur në Shkup, ndërsa vendin e dytë e ndajnë Tetova dhe Manastiri me nga pesë vrasje në vitin 2012.

Sipas të dhënave të Bashkimit Evropian apo Eurostatit, më së shumti vrasje në Maqedoni kanë ndodhur në vitin 2012, kur janë vrarë 70 persona. Nga viti 2013 deri në vitin 2014, numri i vrasjeve ka lëvizur ndërmjet 42 dhe 49. Të dhënat e Eurostatit thonë se në

⁵ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, neni 123

⁶ I. Zejneli", E drejta penale pjesa e posaçme", Tetovë 2007, fq. 20

⁷ Marrë nga Interneti - Agjencia Informative e Maqedonisë (MIA) të publikuar më 16.04.2010.

periudhën kohore 2012-2014 në Shkup kanë ndodhur 18 vrasje në vit, përkatësisht 3,5 vrasje në 100 mijë banorë.

Me këtë statistikë, Shkupi renditej i gjashti në Evropë sipas numrit të vrasjeve në 100 mijë banorë. Në dy vitet e fundit, numri i vrasjeve në Shkup është zvogëluar në më pak se 2,5 në 100 mijë banorë.

Zëdhënësi i MPB-së, Ivo Kotevski, thotë se numri i vrasjeve në Maqedoni, në vitet e fundit në kontinuitet shënon zvogëlim. Ndërkaq, ekspertët shprehen se policia duhet të tregojë efikasitet më të madh në zbulimin e kryerësve të veprave penale, ndërsa gjyqësia të shqiptojë dënime maksimale për autorët e krimit. Krijohet përshtypja se kriminaliteti në Maqedoni është në rritje, gjë që i përgënjeshton pohimet e zyrtarëve të MPB-së.

2.3. Vrasja në mënyrë mizore

Çdo privim nga jeta është thjesht i ndërlidhur me vuajtje të mëdha fizike dhe psikike të viktimës. Vrasja në mënyrë mizore karakterizohet me shkallën enorme të mundimeve dhe të vuajtjeve fizike të viktimës. Për ekzistimin e këtij lloji të vrasjes janë të nevojshme dy elemente të natyrës objektive dhe subjektive. Elementi objektiv shprehet në të shkaktuarit e mundimeve dhe të dhimbjeve të mëdha ndaj viktimës, ndërkaq elementi subjektiv flet për vetëdijen, për dëshirën apo për parapëlqimin e kryerësit për të shkaktuar mundime dhe dhimbje të tilla⁸.

2.4. Vrasja në mënyrë tinëzare (dinake)

Kjo vrasje e kualifikuar karakterizohet me intensitetin e saj më të lartë. Ajo paraqet veprimin që në kuptimin objektiv dhe subjektiv i tejkalon suazat e fshehtësisë dhe të dinakërisë, të cilat rëndom shfaqen te vrasja me dashje.

Nga ana objektive, te ky lloj i vrasjes kryerësi vepron në mënyrë të fshehtë, ndërsa në aspektin subjektiv, kryerësi vepron në mënyrë tinëzare (dinake), të pasinqertë, mashtruese dhe me qëllim të keq, si dhe duke shfrytëzuar edhe besimin e viktimës që ka ndaj tij⁹

Vrasja në mënyrë tinëzare mund të kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë.

⁸ I. Zejneli, "E drejta penale pjesa e posaçme", Tetovë 2007, fq. 21

⁹ I. Zejneli, Po aty. fq. 21

2.5. Vrasja me dashje, me ç'rast rrezikohet jeta e personave të tjerë

Vrasja e tillë ekziston atëherë kur bëhet fjalë për atë mënyrë të kryerjes, me të cilën kryerësi shkon, vepron ose pajtohet me faktin që ta verë në rrezik edhe jetën e ndonjë personi tjetër gjatë kryerjes së veprës penale të vrasjes¹⁰. Për kryerjen e vrasjes, kryerësi ndërmerr veprim përgjithësisht të rrezikshëm (përdorimi i armës së zjarrit, hedhja e bombës në grumbullin e njerëzve dhe etj.), me ç'rast rrezikimi i ndonjë personi tjetër është nus-produkt i kryerjes së veprës.

Për ekzistimin e kësaj vrasjeje të kualifikuar është e nevojshme të shkaktohet rreziku konkret për jetën, së paku edhe të një personi tjetër, përveç viktimës së vrasjes. Ana subjektive të vepra kryhet me dashje, e cila duhet të përmbajë edhe vetëdijen për rrezikimin e jetës edhe të personave të tjerë. Vrasja e kualifikuar do të ekzistojë kur gjatë kryerjes së vrasjes me dashje është privuar nga jeta edhe ndonjë person tjetër¹¹.

Ky lloj vrasjeje mund të kryhet me dashje direkte apo me dashje eventuale.

Në vazhdim do të paraqes dy aktgjykime të marra nga Gjykata themelore e Tetovës, kundër të pandehurit S. B. nga fshati N. dhe H. SH., J. XH dhe A. M., të cilët kanë kryer vepër penale të vrasjes nga neni 123 paragrafi 1 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë **i cili e ka realizuar figurën e veprës penale të vrasjes sipas nenit 123 paragrafi 1 të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë** dhe nga neni 19 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë dhe vepër penale përpunim, armëmbajtje dhe tregti e palejuar me armë apo me lëndëve shpërthyes nga neni 396 paragrafi 1 i Kodit penal dhe ndaj të cilëve është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 10, 20, 5 vjet, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim.

P. Nr. 721/08

¹⁰ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.3

¹¹ I. Zejneli "Edrejta penale pjesa e posaçme", Tetovë 2007

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË!

GJYKATA THEMELORE NË TETOVË, si gjykatë penale e shkallës së parë, në Trupin gjykues të përbërë nga gjykatësi N. I – kryetar i Trupit gjykues, nga gjykatësi N. I. dhe nga gjyqtarët porotnikë M. B, J. Z. dhe N. A. si anëtarë të Trupit gjykues me mbajtësen e procesverbalit L.T., gjatë zhvillimit të procedurës penale kundër të pandehurit S. B nga fshati Nerasht për vepër penale **VRASJE** nga neni 123 paragrafi 1 të KP, **VRASJE** nga neni 123 paragrafi 1 dhe sipas nenit 19 të KP dhe **ARMËMBAJTJE PA LEJE, PËRPUNIM DHE TREGTI ME ARMË OSE LËNDË SHPËRTHYESE** nga neni 396 paragrafi 1 të KP, me propozim akuzë P. Nr. 676/08 të datës 24.11.2008 të Prokurorisë Publike Themelore në Tetovë, pas mbajtjes së seancës publike kryesore dhe të seancës gojore, më datë 29.12.2008 në praninë e prokurorit publik D. P., të pandehurit dhe të avokatit të tij të caktuar kryesisht - N. T. nga Tetova dhe të dëmtuarit A. N. nga fshati Nerasht, nxori dhe shpalli publikisht këtë:

AKTGJYKIM

I PANDEHURI:

S. B. nga babai A., nga nëna L., i lindur më 14.12.1964 në fshatin Nerasht ku edhe jeton, me përkatësi etnike shqiptare, shtetas i Republikës së Maqedonisë, me profesion bujk, i martuar, baba i 3 fëmijëve, me arsimim fillor, me shërbim ushtarak të kryer më 1985 në L. të Republikës së Kroacisë, deri më tani i pagjykuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër.

ËSHTË FAJTOR

PËR ARSYE SE:

Më datë 17.10.2008, rreth orës 14:30 në vendin e quajtur "Tumnicë" në ngastrën e fshatit Nerasht, me paramendim e ka privuar nga jeta personin K.M. të moshës 37-vjeçare dhe me paramendim ka tentuar ta privojë nga jeta edhe vëllain e tij H.B. të moshës së njëjtë, që të dytë nga fshati Nerasht, pas një mosmarrëveshjeje verbale ndërmjet tani të ndjerit dhe të dëmtuarit, nga njëra anë dhe të pandehurit, nga ana tjetër, për shkak të kullotjes së lopëve të të pandehurit në livadhin e tyre, nga ku i pandehuri ka shkuar në shtëpi, e ka marrë pistoletën e tij të markës "Cërvena zastava" me kalibër 6,35 mm dhe numër fabrike ET-7110994, të cilën e ka poseduar pa leje një kohë të gjatë në shtëpinë e tij, bashkë me një kornizë me 6 plumba dhe një paketë me 25 copë municion, është kthyer në livadh ku i ka kullotur lopët dhe me atë

rast ka shkrepur dy plumba në ajër dhe më pas ka qitur në drejtim të të dëmtuarit H., por nuk ka mundur ta privojë nga jeta, mirëpo me një plumb e ka qëlluar në këmbën e djathtë duke i shkaktuar lëndime trupore nga të shtënat me pistoletë dhe në momentin kur i ndjeri K. ka vrapuar që ta ndalë të pandehurin të mos gjuajë, atëherë i pandehuri S. ka gjuajtur 5 plumba në drejtim të tij duke e qëlluar në kokë dhe kraharor, duke i shkaktuar plagë nga armë zjarri në kokë, tri plagë në kokë, në kraharor dhe në stomak si dhe një plagë sipërfaqësore në shpinë, nga ana e majtë e pasme, nga të cilat plagë, tani i ndjeri Kabil ka vdekur në vend, me të cilat veprime i pandehuri ka kryer tri vepra penale, e pikërisht **VRASJE** nga neni 123 paragrafi 1 i KP, **VRASJE** nga neni 123 paragrafi 1 dhe sipas nenit 19 të KP dhe **ARMËMBAJTJE PA LEJE, PËRPUNIM DHE TREGTI ME ARMË OSE ME LËNDË SHPËRTHYESE** nga neni 396 paragrafi 1 I KP dhe në përputhje me këto nene si dhe me nenet 40 e 41 paragrafi 1 pika 1 të KP, gjykata për vepra të veçanta i cakton dënim, e pikërisht:

1. Për vepër penale **VRASJE** nga neni 123 paragrafi 1 i KP, dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj,
2. Për vepër penale **VRASJE** nga neni 123 paragrafi 1 dhe sipas nenit 19 të KP, dënim me burg me kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet, ndërsa
3. Për vepër penale **ARMËMBAJTJE PA LEJE, PËRPUNIM DHE TREGTI ME ARMË OSE LËNDË SHPËRTHYESE** nga neni 396 paragrafi 1 i KP, dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Në pajtim me nenet e lartpërmendura si dhe me nenet 4, 7, 32, 33, 34, 35 dhe 44 paragrafi 2 të KP si dhe me nenin 369 të LPP gjykata:

E DËNON

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjet, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.10.2008 e këndej.

TË PAGUAJË

Në emër të paushalit penal të gjykatës **shumën** në lartësi prej 3.000,00 denarëve si dhe t'i mbulojë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 46.540,00 denarëve, prej të cilave 15.500,00 denarë në emër të autopsisë së kryer dhe raportit mjekësor nga ana e Spitalit klinik publik të Tetovës, 17.000,00 denarë në emër të protokollit nga Dr. A.R., Dr. D.D. dhe

14.040,00 denarë në emër të tre përfaqësuesve avokatë - të caktuar kryesisht, N.T. nga Tetova, në afat kohor prej 30 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të kundërtën do të detyrohet që të njëjtën ta realizojë detyrimisht.

Nga i pandehuri në dobi të shtetit të RM-së, MERRET arma e zjarrit – pistoletë e markës "Cërvena zastava", kalibër 6,35 mm, me numër të fabrikës ET-7110994, 1 kornizë me 6 copë municion dhe një fishek me 19 copë municion të kalibrit 6,35 mm, si dhe mjete të tjera që kanë shërbyer për kryerjen e veprave penale.

I dëmtuari H.M. për dëmshpërblimin e tij udhëzohet në kontest civil.

ARSYETIM

Me Aktakuzën PO Nr. 676/08 të datës 24.11.2008, Prokuroria Themelore Publike në Tetovë, e ka akuzuar të pandehurin S.B. nga fshati Nerasht për veprën penale vrasje nga neni 123 paragrafi 1 i KP për veprën penale vrasje nga neni 123 paragrafi 1 dhe sipas nenit 19 të KP dhe për veprën penale armëmbajtje pa leje, përpunim dhe tregti me armë ose lëndë shpërthyes nga neni 396 paragrafi 1 i KP.

Gjykata, pasi e shqyrtoi këtë akt, caktoi dhe mbajti seancë kryesore më datë 29.12.2008 në të cilin përfaqësuesi i akuzës - prokurori publik, pasi të njëjtën e sqaroi, i propozoi gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor për veprat penale dhe të dënohet sipas ligjit, ndërsa masa e paraburgimit kundër tij të vazhdohet deri në nxjerrjen e aktgjykimit të plotfuqishëm, mjete armë e zjarrit të merret në dobi të RM-së, si mjet i shfrytëzuar në kryerjen e veprës penale.

I dëmtuari H.M. nga f. Nerasht, si person i dëmtuar si dhe si përfaqësuesi ligjor tanimë i të ndjerit K.M. iu bashkëngjiti aktakuzës dhe kërkoi kompensim të formës materiale dhe jomateriale. Për kërkesën e tij kërkoi të drejtohet në kontest civil.

I pandehuri personalisht dhe përmes mbrojtësit të tij, gjatë hetimit dhe në seancën kryesore i pranoi veprat penale të cilat i ngarkohen, duke deklaruar se nuk ka pasur më parë paramendim dhe qëllim ta vrasë tani të ndjerin K.M. dhe vëllain e tij - të dëmtuarin H.M., por ka dashur që me dy plumbat që i ka gjuajtur në ajër, t'i paralajmërojë ata dy të largohen nga vendi i ngjarjes, përkatësisht nga livadhi i tyre në mënyrë që t'i marrë lopët e tij që kanë qenë aty, por meqë ata nuk janë larguar, ai u është afruar atyre dhe në një moment kur tanimë i ndjeri i është afruar të pandehurit, me dorën e majtë e ka kapur tytën e pistoletës, me të djathtën ka dashur ta godasë atë, kështu që pa kontroll ka gjuajtur nga pistoletë e vet, e pasi e ka bërë këtë

dhe pasi ka ardhur në vetëdije, ka vërejtur njerëz rreth tij të cilët i kanë thënë që të ikë nga vendi i ngjarjes në të cilin e ka kryer aktin dhe prej aty është drejtuar dhe është dorëzuar në Sektorin e policisë në Jegunovcë. Të njëjtit nuk i kujtohet se a ka shtënë me pistoletën e tij edhe në drejtim të të dëmtuarit H.M., por pranon se pistoletën e ka marrë para 4-5 vitesh në Kosovë me një çmim prej 150 eurosh dhe të njëjtën e ka ruajtur në shtëpi. Po ashtu e ka mbajtur me vete pa leje përkatëse dhe e ka marrë për t'i mbrojtur lopët dhe veten nga ujëqit dhe qentë. Ai e ka mbajtur me vete çdo ditë, po ashtu edhe në ditën kritike, por jo me qëllim që ta vrasë tani të ndjerin apo edhe të sulmojë të dëmtuarin, ngase sikur të kishte dashur të bënte një gjë të tillë, të njëjtën do ta kishte bërë kur me të njëjtin ka pasur kontakt në mëngjes. Për këtë, i njëjti ndihet fajtor dhe përgjegjës. I vjen keq për veprat e kryera dhe premtoi se në të ardhmen nuk do ta bëjë të njëjtin gabim, ndaj për këtë kërkon nga gjykata t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Gjykata, pasi mori në pyetje të pandehurin, të dëmtuarin H.M. si dëshmitar dhe në pajtim të palëve, i lexoi deklaratat e dëshmitarëve V.Z., V.R. dhe I.M. të dhëna në procesverbal më datë 14.11.2008, duke i analizuar të dhënat nga shënimet zyrtare për këqyrje në vendin e ngjarjes më datë 17.10.2008 OKT Tetovë, Vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve Nr.8 të datës 17.10.2008 në Komunën e Jegunovcës, Shënimet zyrtare Nr. 6240/08 për kontrollin e kryer në Qendrën mjekësore të Tetovës më datë 17.10.2008, Procesverbalin e kontrollit të kryer ndaj personit, Raportin e spitalit Nr.03-114/2 të datës 18.10.2008, Raportin e sekcionit Nr.03-114/2 të datës 12.11.2008 të Spitalit Klinik Shtetëror të Tetovës, rezultatet laboratorike nga shërbimi i mjekësisë ligjore dhe kriminalistike të datës 17.10.2008 të Spitalit Klinik Shtetëror të Tetovës dhe një certifikatë në emër të të pandehurit me Nr.7/349 të datës 29.11.2008 të Sektorit për punë të brendshme të Tetovës dhe duke bërë vlerësimin dhe analizën e çdo dëshmie, përkatësisht tërë strukturën e dëshmimeve, në pajtim me dispozitat e neneve 14 dhe 365 të LPP, e vërtetoi gjendjen faktike, si vijon:

I pandehuri është i lindur në vitin 1963 në f. Nerasht ku edhe jeton bashkë me bashkëshorten dhe tre fëmijët, në një shtëpi me familjen. Njëri prej fëmijëve është në shkollë, kurse njëra vajzë është me probleme shëndetësore.

I njëjti, më datë 17.10.2008, rreth orës 14.30 në vendin e quajtur "Tumnicë" në ngastrën e fshatit Nerasht, me paramendim e ka privuar nga jeta personin K.M. të moshës 37 vjeçare dhe me paramendim ka tentuar ta privojë nga jeta vëllain e tij H.M. të moshës së njëjtë, që të dy nga fshati Nerasht, pas një mosmarrëveshjeje verbale ndërmjet tani të ndjerit dhe të dëmtuarit nga një anë, dhe të pandehurit, nga ana tjetër, për shkak të kullotjes së lopëve të të pandehurit në livadhin e tyre. Pas kësaj, i pandehuri ka shkuar në shtëpi, e ka marrë pistoletën

e tij të markës "Cërvena zastava" me kalibër 6,35 mm dhe me numër fabrike ET-7110994, të cilën e ka mbajtur pa leje një kohë të gjatë në shtëpinë e tij, bashkë me një kornizë dhe 6 plumba dhe me një paketë me 25 copë municion është kthyer në livadh ku i ka kullotur lopët dhe me atë rast ka gjuajtur dy plumba në ajër. Pas kësaj ka gjuajtur në drejtim të të dëmtuarit H.M. por nuk ka mundur ta privojë nga jeta. Megjithëkëtë, me një predhë e ka qëlluar në anën e djathtë të këmbës, duke i shkaktuar lëndime trupore nga të shtënat me pistoletë dhe në momentin kur i ndjeri K.M. ka vrapuar që ta ndalë të pandehurin të mos gjuajë, atëherë i pandehuri i ka shkrehur 5 plumba në drejtim të tij, duke e qëlluar në kokë dhe në kraharor, duke i shkaktuar plagë me armë zjarri në kokë, tri plagë në kokë dhe në kraharor e stomak, si dhe një plagë sipërfaqësore në anën e majtë të shpinës, nga të cilat plagë, tani i ndjeri K.M. ka vdekur në vend.

Kështu që **faktin** për kohën dhe për **vendin** e kryerjes së veprës penale, gjykata e vërtetoi me pohimin e të pandehurit, me deklaratën e të dëmtuarit H.M., me deklaratat e dëshmitarëve V.Z., V.R. dhe I.M., si dhe në bazë të Procesverbalit për këqyrjen në vendin e ngjarjes Nr.115/08 të datës 17.10.2008 të kësaj gjykate.

Fakti i **mënyrës** së kryerjes së veprës penale, si në aktakuzë, u vërtetua nga pohimi i të pandehurit, i cili në gjykatë, si gjatë hetimit, ashtu edhe gjatë seancës kryesore pohoi se armën e zjarrit - pistoletë të markës dhe të numrit si në padi, e ka marrë para 4-5 vitesh në Kosovë me një çmim prej 150 eurosh. Të njëjtën e ka mbajtur në shtëpi, ndërsa në ditën kritike dhe në momentin kritik e ka pasur me vete. Me të njëjtën armë të cilën e ka poseduar pa leje, në ditën kritike dhe në momentin kritik, pas një mosmarrëveshjeje verbale me të dëmtuarin H.M. për lopët e tij që i ka kullotur në livadhin e të dëmtuarit dhe të vëllait të tij të ndjerë K.M., kur i dëmtuari H.M. e ka urdhëruar t'i largojë lopët nga livadhi i tij, i inatosur me të ka ikur nga vendi i ngjarjes, sipas mbrojtjes së tij, në një largësi prej 400 metrash nga vendi i ngjarjes dhe është kthyer më pas me të, kur është afruar në afërsi rreth 200 metra nga i dëmtuari dhe tani i ndjeri K.M., të cilët kanë qenë pranë traktorit të cilën e kanë ngarkuar me misër, ka gjuajtur 2 plumba në ajër. Pastaj ka filluar t'u afrohet atyre dhe kur ka arritur në distancë prej rreth 20 metrave (sipas tij) deri te traktori ku ka qenë i dëmtuari dhe tani i ndjeri K.M., ka shtënë disa plumba në drejtim të të ndjerit Kabil, por nuk i kujtohet se a ka shtënë edhe në drejtim të të dëmtuarit Habil Murtezani. Nga deklarata e të dëmtuarit **H.M** i cili sqaron para gjykatës se, derisa e kanë ngarkuar traktorin me misër bashkë me të vëllain, tani të ndjerin K.M., ka dëgjuar sesi i pandehuri ka shtënë dy plumba në ajër dhe më pas ka parë sesi i pandehuri është afruar deri te traktori dhe kur ka arritur deri në 6 metra, sipas tij, me pistoletën të cilën e ka mbajtur

në dorë, drejt ka shtënë një plumb poshtë rimorkios së traktorit, në anën e djathtë të shputës dhe më pas ka gjuajtur disa plumba edhe në drejtim tanimë të të ndjerit K.M., i cili ka qenë në anën tjetër të traktorit edhe sipas të pandehurit e ka vrarë në vend. Nga deklarata e dëshmitarit V.Z., i cili mes tjerash ka deklaruar se personalisht e ka parë S, i cili ka shkuar në drejtim të traktorit dhe kur ka arritur në largësi prej 10 metrave (sipas tij), së pari ka shtënë në drejtim të H.M., të cilin e ka qëlluar në këmbë dhe në atë moment kur K.M. e ka parë, ka vrapsuar në drejtim të S dhe ka arritur ta kapë për pistolete. Atëherë i pandehuri S ka shtënë disa plumba në kokë, nga të cilët tanimë i ndjeri K.M. e ka humbur fuqinë dhe ka rënë në tokë. Nga deklarata e dëshmitarit V.R., i cili në momentin dhe ditën kritike ka dalë ta marrë bagëtinë dhe ka parë sesi ka filluar zënka ndërmjet të pandehurit, me tani të ndjerin K.M. dhe ka parë sesi S ka gjuajtur nga pistoleta e tij, pastaj se ka tentuar t'i largojë, por duke qenë se edhe ai ka qenë i rënë në tokë, nuk i kujtohen detajet e mëtejshme të ngjarjes, si dhe nga deklarata e dëshmitarit I.M. i cili mes tjerash pranon se kur ka arritur në vendin e ngjarjes, ka parë sesi i dëmtuari dhe tani i ndjeri K.M. e ngarkojnë traktorin me misër dhe pas një kohe e ka parë S dhe kur e ka parë se është me pistoletë, i ka thënë të ndalet, të mos shkojë kah i dëmtuari dhe tani i ndjeri dhe po ashtu ka dëgjuar sesi i pandehuri, duke iu afruar të dëmtuarit dhe të ndjerit, ia ka drejtuar fjalët "e tani do ta luajë.... " dhe si ka shtënë me plumb në drejtim të H.M., po ashtu ka dëgjuar sesi H.M. është ankuar nga plagët, në fakt ka thënë "oh, më dogje", kështu që në atë moment, tani i ndjeri K.M. ka vrapsuar kah S dhe kur i është afruar në distancë prej 3 metrave, S i ka thënë të mos i afrohet dhe se me të nuk ka asgjë, por me vëllain e tij H.M., megjithatë, K.M. është nisur nga ai, e ka kapur dhe atëherë i pandehuri S ka shtënë në të dhe K.M. ka rënë në tokë i vrarë.

Fakti se i pandehuri veprat i ka kryer me **paramendim**, është vërtetuar nga pohimi i tij i pjesshëm, i cili para gjykatës pohoi se që nga momenti që ka gjuajtur dy plumba në ajër, i njëjti nuk është kënaqur me atë, përkundrazi edhe më tej ka vazhduar të afrohet kah i dëmtuari dhe tani i ndjeri dhe pasi ka gjuajtur me plumb kah i dëmtuari H.M., të cilin ka arritur ta qëllojë në anën e djathtë të këmbës, i njëjti ka vazhduar me të shtëna edhe më tej edhe ndaj tani të ndjerit K.M., madje me disa plumba, derisa e ka vrarë të njëjtin, që do të thotë se i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm se me veprimet e tilla mund të shkaktohet pasojë e dëmshme dhe është pajtuar me shkaktimin e saj, përkatësisht me vdekjen e tani të ndjerit K.M.

Në këtë drejtim gjykata nuk e pranoi mbrojtjen e mbrojtësit të të pandehurit se i pandehuri gjatë kryerjes së veprave penale nuk ka pasur paramendim dhe as qëllim t'i privojë nga jeta tani të ndjerin K.M. dhe të dëmtuarin H.M., pasi që, siç ishte arsyetuar i njëjti, ka pasur

paramendim dhe qëllim dhe në pajtim me deklaratën e dëshmitarit I.M., i pandehuri prej kur ka shtënë dy plumba në ajër, është drejtuar kah i dëmtuari dhe tani i ndjeri dhe të dëmtuarit i është drejtuar me kërcënimin "e tani do ta tregojë" dhe menjëherë pas kërcënimit ka shtënë me plumb në drejtim të të dëmtuarit H.M. dhe duke mos pasur sukses ta vrasë atë dhe në momentin kur tanimë i ndjeri K.M. është drejtuar kah i pandehuri që ta ndalë në qëllimin e tij, i pandehuri është kthyer në drejtim të vëllait të tij, tani të ndjerit K.M. duke arritur që ta vrasë në vend me plumbat e shkrepur nga pistoleta e tij.

Fakti se si pasojë e plumbave të shkrepur nga i pandehuri drejt të ndjerit K.M. ka ndodhur **vdekja** momentale e të njëjtit është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit H.M., nga deklaratat e dëshmitarëve V.Z., V.R. dhe I.M., e në veçanti nga këqyrja e shënimeve zyrtare për kontrollin e kryer në Qendrën Mjekësore Tetovë, si dhe e Protokollit të sekcionit të datës 12.11.2008, pra është konstatuar se vdekja e të ndjerit K.M. është e dhunshme dhe e njëjta ka ardhur si pasojë e ndërprerjes së furnizimit të trurit me gjak, e dëmtimit të kanalit të trurit nga koka nga arma e zjarrit dhe se në trupin e të ndjerit në kokë, në gjoks dhe në stomak gjenden 4 plagë nga armë zjarri, prej të cilave njëra në kokë dhe tre në gjoks dhe stomak, po ashtu edhe në shpinë, më saktë në anën e majtë të pasme gjendet edhe një plagë nga armë zjarri, e cila është e sipërfaqshme dhe nuk e ka prekur lëkurën.

Fakti i llojit dhe i **karakterit të lëndimeve trupore** të cilat i ka marrë i dëmtuari H.M. është vërtetuar nga deklaratat e tij si dhe nga raporti i Spitalit Klinik Shtetëror të Tetovës të datës 11.11.2008 ku mes tjerash është theksuar se tek i dëmtuari është konstatuar lëndim i llojit plagë nga të shtëna arme, në anën e djathtë të këmbës, ku është gjetur trup metalik "plumb" nga armë zjarri, pa lëndim të ashtit, lëndim i cili sipas aspektit juridik-penal përfaqëson lëndim të lehtë.

Faktin për llojin dhe kalibrin e armës së zjarrit si dhe numrin e municionit të gjetur, gjykata e vërtetoi nga pohimi i ta pandehurit si dhe nga shënimet zyrtare të këqyrjes në vendin e ngjarjes, nga Vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i pandehuri të datës 17.10.2008 nga ana e Sektorit të Punë të Brendshme Tetovë - Stacionit policor në Jegunovcë, si dhe nga Procesverbali i kësaj gjykate me Nr.115/08 të datës 17.10.2008.

Fakti se i pandehuri më parë nuk ka qenë person i dënuar, u vërtetua nga pohimi i tij si dhe nga këqyrja e evidencës së personave të dënuar në emër të tij nga ana e SPB-së Tetovë.

Gjykata, gjatë vërtetimit të gjendjes faktike e kishte parasysh edhe mbrojtjen e mbrojtësit të të pandehurit, se në rastin konkret bëhet fjalë për vepër penale *vrasje në çast*,

ndëshkuese sipas nenit 125 të KP, mirëpo të njëjtën gjykata nuk e pranoi pasi mbrojtja e tillë nuk përputhet me prova materiale dhe verbale konkrete, nga një anë dhe nga ana tjetër nuk u vërtetua fakti se i pandehuri gjatë kryerjes së veprave ka qenë në gjendje të zemërimit të lartë, nga ndonjë sulm apo ofendim të rëndë nga tani i ndjeri. Ashtu siç ishte vërtetuar dhe ashtu siç pranoi edhe vetë i pandehuri ai pas gjysmë ore pasi është zënë me të dëmtuarin H.M., ka shkuar nga vendi i ngjarjes dhe është kthyer me armë zjarri në dorë dhe ka filluar të shkrehë, së pari në ajër dhe më pas kur i është afruar të dëmtuarit dhe tani të ndjerit, edhe në drejtim të tyre.

Po ashtu, gjykata e refuzoi propozimin e mbrojtësit për ekspertizë neuropsikiatrike të pandehurit, pasi në përputhje me deklaratën e të pandehurit, i njëjti nuk ka qenë asnjëherë i sëmurë nga ndonjë sëmundje më e rëndë, por ka pasur problem me veshët, ndërsa për momentin i dhemb koka si pasojë e ngjarjes, që sipas mendimit të gjykatës, kjo nuk është arsye që të caktohet një ekspertizë e tillë, pasi i njëjti nuk ka ndonjë sëmundje serioze, apo që eventualisht mund të ketë ai, për arsye se i njëjti, në momentin e kryerjes së veprës ka mundur t'i drejtojë veprimet e tij, përkatësisht ka pasur mundësi ta kuptojë rëndësinë e veprës, përkatësisht ka qenë i vetëdijshëm.

Po ashtu gjykata e refuzoi pjesërisht mbrojtjen e të pandehurit në pjesën ku deklaroi se menjëherë pas mosmarrëveshjes me të dëmtuarin H.M., nuk ka qenë në shtëpi por diku afër vendit të ngjarjes, në distancë prej 400 metrash, pasi në pajtim me deklaratën e të dëmtuarit H.M., i pandehuri, pas mosmarrëveshjes, është drejtuar në shtëpinë e tij e cila nga vendi i ngjarjes është në një distancë prej jo më shumë se nja 500 metra, fakt i cili tregon se i pandehuri, menjëherë pas mosmarrëveshjes me të dëmtuarin është drejtuar drejt shtëpisë së tij, ku e ka marrë pistoletën dhe ka ardhur në vendin e ngjarjes, me çka hidhet poshtë mbrojtja e të pandehurit se pistoletën e ka pasur me vete tërë ditën.

Me faktin se me veprimet e të pandehurit janë konsumuar të gjitha karakteristikat e veprave penale të cilat i ngarkohen, të njëjtin gjykata e shpalli fajtor për tri veprat dhe në pajtim me dispozitat për matjen e dënimit për vepra të kryera sipas nenit 44 të KP si dhe të dispozitave për zbutje të dënimit sipas neneve 40 dhe 41 paragrafi 1 pikat 3 dhe 6 të KP, të pandehurit i shqipton dënim të vetëm me burg në kohëzgjatje prej 10 vjet, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.10.2008 e këndeje, pasi gjykata konstaton se në rastin konkret ky dënim, sipas llojit dhe lartësisë përputhet me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe se e njëjta mjaftueshëm do të ndikojë tek i pandehuri që në të ardhmen të mos kryejë këso veprash penale apo vepra penale të ngjajshme, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat sipas nenit 39 të KP të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i madh apo më i vogël, edhe ato rëndueset

të cilat kanë të bëjnë me paraqitjen e shpeshtë të këtij lloji të veprave penale, bashkëngjitjen e të dëmtuarit për ndjekje penale dhe kërkesën për kompensim, faktin se nuk është pajtuar me përfaqësuesin ligjor tanimë të të ndjerit dhe tjetër si dhe lehtësinë se bëhet fjalë për person të pagjykuar më parë, se është bujk, se nga të ardhurat e tij e mban familjen, pranimin e veprës së kryer, se është person familjar, baba i tre fëmijëve prej të cilëve njëri prej fëmijëve është nxënës shkolle, ndërsa tjetri me probleme shëndetësore serioze, i varfër, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do t'i ndodhë një gjë e këtillë apo e ngjashme.

Gjykata, duke marrë parasysh gjendjen materiale të të pandehurit dhe në përputhje me dispozitat e neneve 89 dhe 92 të Ligjit për procedurë penale, e detyroi të njëjtin që në emër të paushalit penal në dobi të gjykatës, t'ia paguajë gjykatës shumën prej 3.000,00 denarëve, si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 15.500,00 denarëve Spitalit Klinik – Tetovë për autopsinë e kryer dhe për lëshimin e raportit mjekësor për llojin dhe karakterin e lëndimeve tek i dëmtuari H.M., shumën prej 17.000,00 denarëve në emër të Protokollit të sekcionit, e pikërisht 7.000,00 denarë Dr. A.R., 7.000,00 denarë Dr. D.D. dhe 3.000,00 denarë personit ndihmës gjatë autopsisë - Nadi Vejselit, si dhe shumën prej 14.040,00 denarë në emër të tre përfaqësuesve - avokatit të caktuar kryesisht - N.T. nga Tetova, të gjitha në afat prej 30 ditëve, pasi aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm. Në të kundërtën do të detyrohet që të njëjtat t'i realizojë detyrimisht.

Gjykata, nga i pandehuri, në dobi të shtetit të Republikës së Maqedonisë dhe në përputhje me dispozitat e nenit 396 paragrafi 3 dhe sipas nenit 100-A paragrafi 2 të KP, mjetin armë zjarri i llojit dhe numrit si në aktakuzë, e sekuestron si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Gjykata, të dëmtuarin H.M. nga f.Nerasht, për kërkesën e tij për kompensim të llojit material, e udhëzoi në kontest civil në përputhje me nenin 100 të LPP.

Në bazë të gjithë kësaj që u shtrua si më sipër, gjykata nxori aktgjykimin si në dispozitiv.

Gjykuar në Gjykatën themelore në Tetovë, më 29.12.2008 nën P. Nr. 721/08.

Mbajtëse e procesverbalit,
LEPA TODEVSKA, d.v.

Kryetar i Trupit gjykuar
NAZIF ILIJAZI, d.v.

UDHËZIM: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat kohor prej 15 ditëve nga dita e marrjes të së njëjtës, nëpërmjet kësaj gjykate -Gjykatës së Apelit në Gostivar.

Mendimi kritik

Duke u bazuar në të dhënat e pasqyruara në aktgjykim në të cilin përshkruhen veprat me të cilat ngarkohet i pandehuri, vepra të cilat janë të parapara në KP, gjykata, gjatë shqyrtimit të rastit i ka marrë parasysh të gjitha faktet që janë relevante. Përshkrimi i veprës penale, është bërë ashtu siç parashikohet me KP gjatë zhvillimit të procedurës penale kundër të pandehurit S.B. nga fshati Nerasht për veprën penale VRASJE nga neni 123 paragrafi 1 i KP, VRASJE nga neni 123 paragrafi 1 dhe sipas nenit 19 të KP dhe ARMËMBAJTJE PA LEJE, PËRPUNIM DHE TREGTI ME ARMË OSE ME LËNDË SHPËRTHYESE nga neni 396 paragrafi 1 i KP, ndaj mendoj se gjykata, duke u bazuar në të gjitha faktet e proceduara, në pohimin e vetë të pandehurit si dhe në deklaratat e dëshmitarëve, i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme.

Procedura është zhvilluar duke e respektuar LPP. Po ashtu, me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit ajo ka nxjerrë aktgjykim me të cilin e ka shpallur fajtor të pandehurin S.B. i cili ngarkohej për tri vepra penale të rënda, duke përfshirë edhe vrasjen. Ai është shpallur fajtor pasi gjykata ka vërtetuar se në momentin dhe në ditën kritike, ai me vetëdije e ka privuar nga jeta K.M. dhe e ka plagosur rëndë vëllain e tij binjak H.M. Me këtë, gjykata i ka hedhur poshtë pretendimet e mbrojtjes se në momentin kritik, i pandehuri nuk ka qenë në vetëdije, apo se veprën e ka kryer në çast. Po ashtu, duke marrë parasysh faktin se i njëjti e ka privuar nga jeta të ndjerin K.M disa orë më vonë pasi ka ndodhur zënka dhe se armën me të cilën e ka kryer krimin nuk e ka pasur me vete por ka vajtur në shtëpi për ta marrë atë, kjo tregon se ai ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se me veprimet e tij shkakton pasojë të ndaluar.

I pandehuri është ngarkuar që t'i paguajë edhe shpenzimet lidhur me procedurën, kurse për masën e dënimit gjykata ka vendosur ta dënojë me burg në kohëzgjatje prej 10 vjetësh. Si rrethanë lehtësuese gjykata e ka marrë parasysh faktin se i pandehuri më parë nuk ka qenë kryerës i ndonjë vepre penale, pohimin dhe keqardhjen e tij për atë që ka ndodhur. Po ashtu, do t'i llogaritet edhe periudha gjatë së cilës ka qenë në paraburgim.

Mendoj se gjykata këtë aktgjykim e ka nxjerrë ashtu siç duhet, duke e respektuar zhvillimin e procedurës, të drejtat e palëve, vlerësimin e të gjitha fakteve deri në nxjerrjen e aktgjykimit meritor.

K. Nr. 193/10

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË !

GJYKATA THEMELORE - TETOVË, si gjykatë penale e shkallës së parë, me trupin gjyqësor të përbërë nga gjykatësi **L.I.** - kryetar i këshillit, **B.J.** – gjykatës, anëtar i trupit gjyqësor dhe gjyqtarët porotë: **J.N.**, **V.K.** dhe **J.R.** – anëtarë të trupit gjyqësor dhe me mbajtësen e procesverbalit **GORDANA PETROVSKA**, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarve: **H.SH.**, **J.XH.** dhe **A.M.** nga fs. Xhermë – Tetovë, të cilët gjenden në paraburgim në ENP – burgu në Shkup, të akuzuar me aktakuzën e PPTH-Tetovë KO Nr.576/09 datë 08.03.2010 dhe të precizuar në seancën kryesore të zhvilluar më datë 11.06.2010, që të tre të akuzuar për një vepër penale **VRASJE të parashikuar me nenin 123 paragrafi 1, pika 1, lidhur me nenin 22 të KP, ndërsa i akuzuari JUMNI XHEMAILI edhe për veprën penale PËRPUNIM, ARMËMBAJTJE DHE TRAFIKIM TË PALEJUAR ME ARMË OSE ME LËNDË SHPËRTHYESE të parashikuar me nenin 396 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KP**, pas seancës kryesore verbale dhe publike, të mbajtur më datë 11.06.2010 në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit publik D.P., të të akuzuarve, të mbrojtësve: E.I. - avokat nga Tetova për të akuzuarin e parë H.SH. dhe L.K. - avokat nga Tetova për të akuzuarin e dytë dhe të tretë J.XH. dhe A.M., të përfaqësuesit ligjor të të ndjerit - të dëmtuarës D.J. dhe të autorizuarit të saj O.R. – avokat nga Shkupi, më datë 15.06.2010 e nxori dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I

TË AKUZUARIT:

1. H.SH., i biri i SH dhe GJ, i lindur më datë 03.03.1987 në f. Xhermë ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, me profesion mjeshtër fasade, shqiptar, shtetas i RM-së, nga data 16.09.2009 gjendet në paraburgim në burgun e Shkupit, e cila masë i është vazhduar deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, më parë i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, mbrohet duke qenë në paraburgim;

2. J.M., i biri i M. dhe R., i lindur më datë 10.05.1990 në f. Xhermë ku edhe jeton, nga data 17.09.2009 deri më datë 15.06.2010 gjendet në paraburgim në burgun e Tetovës dhe të vazhduar me aktvendimin e Gjykatës së apelit Gostivar, llogaritur nga data 08.07.2010 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, di shkrim-lexim, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i papunë, shqiptar, shtetas i RM-së, më parë i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, mbrohet duke qenë në paraburgim;

3. **A.M.**, i biri i M. dhe F., i lindur më datë 14.10.1986 në f. Xhermë ku edhe jeton, nga data 16.09.2009 deri më datë 15.06.2010 gjendet në paraburgim në burgun e Tetovës dhe të vazhduar me aktvendimin e Gjykatës së apelit Gostivar, llogaritur nga data 08.07.2010 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, di shkrim-lexim, ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, me profesion gjipspunues, shqiptar, shtetas i RM-së, më parë i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, mbrohet duke qenë në paraburgim.

JANË FAJTORË

PËR SHKAK SE:

1. Më datë 14.09.2009 rreth orës 20 e 30 minuta, në f. Xhermë i akuzuari H. me të akuzuarit J. dhe A. si bashkëkryerës, me paramendim, në mënyrë tinëzare e kanë privuar nga jeta I. J. nga Tetova, i moshës 58 vjeçare, në atë mënyrë që pasi paraprakisht në OH “Amazon” në Tetovë i akuzuari H. të ndjerit i është paraqitur me telefon celular dhe e ka mashtruar duke i thënë se do ta presë para Shkollës së muzikës në Tetovë, që të shkojnë në f. Xhermë ku do t’ia paguajë për 2 muaj qiranë e banesës të cilën e ka marrë me qira nga ai, e cila ka qenë pronë e tij. I ndjeri i ka besuar kësaj dhe ka ardhur në vendin e caktuar. Aty ka ardhur dhe i akuzuari H. Këtu i akuzuari e ka hipur veturën “Daewoo-Reiser” me targa TE 677- BL dhe janë nisur në drejtim të f. Xhermë dhe kur kanë ardhur në vendin e quajtur “Livadhi i Jonuzit” aty i kanë pritur i akuzuari A. dhe i akuzuari J. i cili me vete e ka sjell pushkën automatike të tij të tipit 56, kalibër 7,62 x 39 mm me Nr. të fabrikës 14185309 - prodhim kinez dhe i akuzuari H. Kur ka arritur tek ata, e ka ndalur veturën dhe nga i ndjeri ka kërkuar që të dalë jashtë, Pas kësaj e kanë sulmuar fizikisht duke e goditur me grushte nëpër trup, e gjatë kësaj i akuzuari H. e ka marrë pushkën nga i akuzuari J., e ka repetuar dhe ka shkrepur 9 plumba në drejtim të tij, duke i shkaktuar 4 plagë shpuese-tejkaluese në pjesën e kokës, 3 plagë shpuese-tejkaluese në anën e majtë të gjoksit dhe 2 plagë tangjente në pjesën e djathtë të hundës si dhe gjakderdhje nënlëkurore me dimension 7 x 4 cm në pjesën mbi gjurin e djathtë, nga të cilat plagë i dëmtuari ka ndërruar jetë në vendngjarje. Pas kësaj të akuzuarit J. dhe H. e kanë tërhequr trupin e të ndjerit rreth 10,5 metër në drejtim të pyllit ku e kanë lënë dhe janë arratisur.

Me këto veprime i akuzuari H.SH. ka kryer vepër penale VRASJE të parashikuar me nenin 123, paragrafi 2, lidhur me nenin 22 të KP, ndërsa të akuzuarit J.XH. dhe A.M. kanë kryer vepër penale VRASJE të parashikuar me nenin 123, paragrafi 1, lidhur me nenin 22 të KP.

Në bazë të këtyre neneve dhe neneve 32, 35 dhe 39 të KP Trupi gjykues:

I DËNON

Të akuzuarin H.SH. me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vjet.

Të akuzuarit J.XH. dhe A.M. me dënim burgu në kohëzgjatje prej nga 5 (pesë) vjet.

Në dënimet e shqiptuara burgim ndaj të tre të akuzuarve të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, e pikërisht për **të akuzuarin H.SH.** llogaritur nga data 16.09.2009, ndërsa për të akuzuarit J.XH. dhe A.M., llogaritur nga data 17.09.2009, në përputhje me nenin 47 të KP.

TË PAGUAJNË

Secili për vetveten, në emër të paushalit penal në dobi të mjeteve buxhetore të gjykatës, shumën prej nga 3.000,00 den. dhe të tre në mënyrë solidare t'i kompensojnë shpenzimet reale të procedurës për ekspertizë dhe shoqërim në shumë prej 43.720,00 den., brenda 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara – përfaqësuesi ligjor i të ndjerit Ismet Jahja – bashkëshortja D.J. e përfaqësuar nga i autorizuari O.R. – avokat nga Shkupi, për të realizuar kërkesën për dëmshpërblim, UDHËZOHET që të hapë kontest civil.

Arma e zjarrit: pushkë automatike e tipit 56, e kalibrit 7,62 x 39 mm, me Nr. të fabrikës 14185309, e prodhimit kinez, në përputhje me nenin 100 - A paragrafi 1 të KP SEKUESTROHET në favor të shtetit TË RM-së si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

II

I AKUZUARI:

**JUMNI XHEMAILI, me të dhëna personale si në pikën 1,
në përputhje me nenin 368, pika 1 të LPP**

LIROHET NGA AKUZA

NGASE:

Në të njëjtën ditë, në dhomën e tij në f. Xhermë, në mënyrë të paautorizuar ka mbajtur municion – një plumb të kalibrit 7,62 x 54 R mm për pushkë luftarake dhe pushkë-mitraloz, ndërsa në bodrumin e katit përdhes, në regallin prej druri - edhe armë zjarri - pushkë automatike të tipit 56, me kalibër 7,62 x 39 mm me Nr. të fabrikës 14185309 - prodhim kinez, me kondak prej druri, e cila është e ndaluar që të mbahet nga qytetarët dhe e cila është përdorur me rastin e privimit nga jeta të I. J. nga Tetova, dhe gjatë bastisjes së kryer në shtëpinë e tij më datë 17.09.2009 është gjetur dhe është sekuestruar kondaku prej druri ngjyrë kafeje, e së njëjtës pushkë automatike, bashkë me plumbin.

Me këtë veprim, i akuzuari J.Xh. DO TË kishte kryer vepër penale PËRPUNIM, ARMËMBAJTJE DHE TRAFIKIM TË PALEJUAR ME ARMË OSE LËNDË SHPËRTHYES të parashikuar me nenin 396, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të Kodit penal.

Plumbi i kalibrit 7,62 x 54 R mm SEKUESTROHET në favor të shtetit të RM-së në përputhje me nenin 532, paragrafi 2 të KP.

A R S Y E T I M

Me aktakuzën e PPTH Tetovë KO Nr. 576/09 të datës 08.03.2010, e të precizuar në seancën kryesore më datë 11.06.2010, janë akuzuar: H. Sh., J. Xh. dhe A. M. - të gjithë nga f. Xhermë – Tetovë, për veprën penale VRASJE, të parashikuar me nenin 123 paragrafi 1, pika 1, lidhur me nenin 22 të KP, ndërsa i akuzuari i dytë J. Xh. edhe për veprën penale përpunim, armëmbajtje dhe trafikim të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyes, të parashikuar me nenin 396 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KP.

Trupi gjykues, për këtë çështje juridike penale caktoi dhe zhvilloi seancë kryesore më datë 11.06.2010 në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit publik D. P., të të akuzuarve, të mbrojtësve: E. I. - avokat nga Tetova për të akuzuarin e parë H. Sh. dhe L. K. - avokat nga Tetova për të akuzuarin e dytë dhe të tretë J. Xh. dhe A. M., të përfaqësuesit ligjor të të ndjerit - të dëmtuarës D.J. dhe të autorizuarit të saj O.R. – avokat nga Shkupi.

Përfaqësuesi i akuzës, në seancën kryesore, në diskutimin përfundimtar të tij, pasi e precizoi pikën 1 të aktakuzës për veprën penale vrasje, të parashikuar me nenin 123 paragrafi 1, pika 1, lidhur me nenin 22 të KP, me të cilën ngarkohen të tre të akuzuarit, lidhur me kohën e kryerjes së veprës penale dhe sulmin fizik ndaj të ndjerit para se me pushkë automatike të privohet nga jeta nga i akuzuari H., dhe pikën 2 për veprën penale përpunim, armëmbajtje dhe trafikim të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyesë të parashikuar me nenin 396 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KP, me të cilën ngarkohet i akuzuari i dytë J. Xh., pastaj aktakuzën e precizuar në këtë mënyrë ndaj të tre të akuzuarve e mbështeti në tërësi dhe propozoi që të tre të akuzuarit të shpallen fajtorë për veprën penale vrasje, të parashikuar me nenin 123 paragrafi 1, pika 1, lidhur me nenin 22 të KP, ndërsa i akuzuari i dytë J.Xh. edhe për veprën penale përpunim, armëmbajtje dhe trafikim të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyesë, të parashikuar me nenin 396 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KP dhe propozoi që të dënohen sipas ligjit, ndërsa arma e zjarrit dhe 1 plumb të sekuestrohen në dobi të shtetit të RM-së.

Theksoi se nga të gjitha provat, mund të vërtetohet se të tre të akuzuarit në kafeterinë “Amazon” në Tetovë janë marrë vesh që ta privojnë nga jeta të ndjerin I. J., se i akuzuari i parë H. Sh. e ka thirrur të ndjerin I. J. që të vijë te Shkolla e muzikës në Tetovë që t’ia paguajë për 2 muaj qiranë e banesës, se pastaj me veturën e tij e ka dërguar në vendin e quajtur “Livadhet e Jonuzit” afër f. Xhermë, ku paraprakisht e kanë pritur të akuzuarit J. Xh. dhe A. M., me të cilët është marrë vesh që t’ia sjellin pushkën automatike, se të akuzuarit J. dhe A. e kanë siguruar armën, se të tre të akuzuarit e kanë sulmuar fizikisht duke e goditur me shqelma dhe grushte nëpër trup, se pas kësaj i akuzuari H. Sh. e ka marrë pushkën nga i akuzuari J. dhe se e ka repetuar dhe ka shkrepur 9 plumba në drejtim të të ndjerit, e që si pasojë e kësaj i ndjeri I.J. ka ndërruar jetë dhe derisa i akuzuari A. ka bërë roje që mos të vijë dikush, të akuzuarit H. dhe J. e kanë tërhequr trupin e të ndjerit rreth 10,5 metra në drejtim të pyllit dhe pas kësaj që të tre të akuzuarit janë larguar. Sa i përket të akuzuarit të dytë J. Xh., theksoi se ai në ditën kritike, më datë 14.09.2009 në dhomën e tij në f. Xhermë, në mënyrë të paautorizuar ka mbajtur armë zjarri - pushkë automatike edhe pse e ka ditur se për qytetarët është e ndaluar mbajtja e një

arme të tillë, e cila është përdorur me rastin e privimit nga jeta të I. J. nga Tetova. Pas ngjarjes pushën e ka marrë i akuzuari Jumni i cili ka pasur zotërim faktik mbi të.

E dëmtuara D.J. - përfaqësuese ligjore e të ndjerit, personalisht dhe nëpërmjet të autorizuarit të saj O.R. – avokate nga Shkupi, në diskutimin përfundimtar i mbështeti deponimet e përfaqësuesit të aktakuzës të bëra në diskutimin përfundimtar të tij dhe iu bashkëngjiti ndjekjes penale ndaj të tre të akuzuarve dhe njëkohësisht paralajmëroi kërkesë për dëmshpërblim të cilin do ta realizojë në kontestin civil.

I akuzuari H. Sh. personalisht dhe nëpërmjet mbrojtësit të tij E.I. – avokat nga Tetova, gjatë seancës kryesore dhe në diskutimin përfundimtar të tij, propozoi që i akuzuari të lirohet nga akuza për shkak të mungesës së provave se ai e ka privuar nga jeta tani të ndjerin I. J. Theksoi se i akuzuari H. ka shkuar në drejtim të f. Xhermë me tani të ndjerin I.J. që t’ia paguajë qiranë për 2 muaj, se papritmas në rrugën për në fshatin Xhermë, te vendi i quajtur “Livadhet e J.” ka qenë i ndaluar nga të akuzuarit A. dhe J. të cilët menjëherë kanë hipur në veturë dhe të akuzuarin H. e kanë urdhëruar që me veturë të hyjë në livadh dhe të ndalet, se kur janë ndalur dhe kanë dalë nga vetura, i akuzuari J. ka filluar të gjuaj me pushkë automatike të cilën e kishte me vete në drejtim të tani të ndjerit Ismet, se pastaj të akuzuarit H. dhe A. i ka urdhëruar që trupin e të ndjerit ta tërheqin në pyll, se pastaj të tre janë larguar, e pikërisht të akuzuarit A. e J. në drejtim të fshatit, ndërsa H. në drejtim të Tetovës. Gjithashtu theksoi se i akuzuarit H. nuk ka pasur asnjë motiv e as paramendim që ta privojë nga jeta tani të ndjerin, por ka pasur qëllim vetëm t’ia paguajë borxhin dhe është nisur me qëllim të mirë, se i ka besuar të akuzuarit A. se do t’i japë para hua që ta paguajë qiranë.

Të akuzuarit J.Xh. dhe A. M. personalisht dhe nëpërmjet mbrojtësit të tij L. K. – avokat nga Tetova, gjatë seancës kryesore dhe në diskutimin përfundimtar të tyre deklaruan se nuk janë kryerës të veprës penale vrasje, të parashikuar me nenin 123 paragrafi 1, pika 1, lidhur me nenin 22 të KP, siç ngarkohen me aktakuzë, përkatësisht se si bashkëkryerës me të akuzuarin H. me paramendim dhe në mënyrë tinëzare, ndërsa me marrëveshje paraprake në OH “Amazon” e kanë privuar nga jeta tani të ndjerin I. J. dhe propozoi që në përputhje me nenin 368, paragrafi 3 të LPP të lirohen nga akuza. Theksoi se nga provat e nxjerra rrjedh se kryerës i veprës penale vrasje është i akuzuari i parë H. Sh., ndërsa për ekzistimin e bashkëkryerjes të të akuzuarit J. dhe A. duhet të ekzistojë paramendimi te secili se në çfarë vepre penale merr pjesë dhe secili nga ata të paraqitet si ekzekutues i pavarur në çështjen bazë të veprës penale, gjë që në këtë rast te këta të akuzuar nuk ekziston. Theksoi se ka prova materiale dhe verbale se i akuzuari i parë H. i është paraqitur të dëmtuarit - Ismetit dhe se e ka thirrur që në mbrëmjen

kritike të takohen, se i akuzuari i parë H. vetë e ka marrë në veturën e tij te Shkolla e muzikës, e ka mashtruar që të hyjë në veturë dhe e ka dërguar në vendin kritik dhe personalisht ka gjuajtur dhe e ka vvarë të dëmtuarin. Theksoi se pushkën e kanë sjellë J. dhe A. me urdhër të të akuzuarit të parë H. për shitje; sikur të akuzuarit J. dhe A. të dinin se kjo pushkë do të përdorej për vrasjen e të ndjerit I., ata nuk do t'ia sillnin pushkën të akuzuarit të parë H. Më tutje u theksua se nuk ka prova për ekzistimin e marrëveshjes dhe planit të të akuzuarit J. dhe A. për ta privuar nga jeta të ndjerin, as që kishte vendim të prerë, vetëdije dhe dëshirë që i nevojiten një personi për të privuar dikë nga jeta.

Lidhur me veprën penale përpunim, armëmbajtje dhe tregti të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyes, sipas nenit 396 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KP e cila ndaj të akuzuarit të dytë J. Xh. që ngarkohet, theksoi se pushka automatike me të cilën është kryer vrasja, është në pronësi të të akuzuarit të parë H. dhe se nga ana e të akuzuarit J. dhe A. është sjellë me kërkesën e të akuzuarit të parë H. dhe se është marrë nga stalla e H. dhe i akuzuari i parë i ka sjellë në lajthitje nëpërmjet shitjes së pushkës për ta sjellë dhe po qe se pushka do të ishte e të akuzuarit dhe po qe se ishte në dije se do ta marrë për vrasje, atëherë i akuzuari Jumni do të kishte mundësi për ta fshehur në mal dhe asnjëherë të mos zbulohej **kondaku i pushkës i cili nuk është marrë nga i akuzuari J., është gjetur në shtëpinë në të cilën jeton familja e tij shumanëtarëshe**, ndërsa për pushkën e prodhimit serik për të cilën thuhet se është përdorur në këtë vrasje, thotë se është apo mund të jetë çdo pushkë tjetër e të njëjtës seri, kështu që për veprën penale të sipërthënë propozoi që të lirohet nga akuza.

Trupi gjykues, pas nxjerrjes së provave të propozuara të domosdoshme, e pikërisht dëgjimit të përfaqësuesit ligjor të të ndjerit I. J. - bashkëshortes së tij D.J. si dëshmitare, këqyri sendet e sekuestruara përkohësisht nga SPB Tetovë më datë 15.09.2009 nga K.Xh., këqyri Vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga SPB Tetovë më 17.09.2009 nga i akuzuari A.M, këqyri Vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga SPB Tetovë më datë 17.9.2009 nga i akuzuari J. Xh., këqyri Vërtetimin e sekuestrimit të përkohshëm të sendeve nga SOPB Tetovë Nr. 165/3399 më datë 17.9 2009, këqyri certifikatën nga Libri i amzës i të lindurve të të akuzuarit A. M. Nr. 11-1/253 të datës 3.4.2009 të nxjerrë nga Libri i amzës në fshatin Xhepçisht, këqyri Procesverbalin për bastisjen e shtëpisë së H.Sh. në Bllok 82, ndërtesa 3 B. Nr.11, të kryer nga SPB më datë 15.9.2009, këqyri Vërtetimin për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga SPB Tetovë më datë 15.9.2009 nga M. M., këqyri Lejen për posedim dhe armëmbajtje të lëshuar nga SPB Tetovë Nr 4109 në emër të M. M., këqyri Vërtetimin për sekuestrimin e sendeve nga SPB Tetovë Nr. SL datë 15.9.2009 nga i

akuzuari H.Sh., këqyri Vërtetimin për sekuestrimin e sendeve nga SPB Tetovë datë 15.9.2009 nga personi A. A. për të cilën i akuzuari H. deklaroi se është bashkëshortja e tij, këqyri Procesverbalin për bastisjen e shtëpisë së J.Xh. nga ana e SPB më datë 15.9.2009, këqyri Certifikatën nga Libri i amzës i lindjeve të të akuzuarit H. Sh. me numër 11-01/241 të datës 4.4.2009 të LA – Xhepçisht, këqyri Vërtetimin për sekuestrimin e sendeve nga ana e SPB Tetovë më datë 15.9.2009 nga i akuzuari H.Sh., këqyri fotokopjen e Policës së sigurimit nga SHA "Vardar" Nr 021092468 në emër të Zulqfli S, këqyri Procesverbalin për bastisjen e shtëpisë së A.M. nga ana e SPB më datë 15.9.2009, këqyri Ekzemplarin MK 1048994 për veturën "Daewoo Reiser" në emër të Z.S., këqyri Urdhëresën e gjykatësit hetues të OID Nr.15/09 të datës 15.9.2009 për bastisjen e shtëpisë së J. Xh., këqyri Procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes nga Gjykata themelore Tetovë, OID 159/09 të datës 15.9.2009 të gjykatësit hetues kujdestar, këqyri Protokollin e Spitalit Klinik Tetovë - Shërbimi për mjekësi ligjore, Nr 03-102/2 të datës 28.9.2009 të personave ekspertë Dr. A.R. dhe Dr. D. D. specialist i mjekësisë ligjore për të ndjerin Ismet Jahja, këqyri Procesverbalin për dorëzimin dhe gjetjen e sekuestrimin e sendeve nga MPB dhe nga gjykatësi hetues të datës 7.12.2009, e pikërisht 4 procesverbale, këqyri Procesverbalin e gjurmëve të gjetura dhe të sendeve të përdorura në vendin e ngjarjes, Nr. 1372/09 të SPB Tetovë në shtëpinë e të akuzuarit A. M. në f. Xhermë, këqyri Lejen për posedim të pushkës së gjuetisë në emër të M. M. të marrë më 15.9.2009, këqyri Procesverbalin e SPB Tetovë për gjetjen e gjurmëve dhe të sendeve të përdorura në vendin e ngjarjes Nr. 1357/09 të datës 15.9.2009 në veturën "Daewoo Reiser", leximin e ekspertizës nga MPB - Sektori për krim teknik në formën e analizës daktiloskopike të gjurmëve në linjat papilare Nr. 19.9-62831/1 të personit ekspert S. D., këqyri Procesverbalin për gjurmët e gjetura dhe për sendet e përdorura në vendin e ngjarjes nga SPB Tetovë Nr. 1371/09 të datës 15.9.2009 në shtëpinë e Jumni Xh. në f. Xhermë, këqyri Procesverbalin për gjetjen e gjurmëve dhe të sendeve nga SPB Tetovë Nr. 1373/09 të datës 15,9.2009 në hapësirat e Sektorit për PB Tetovë, këqyr Shkresat e MPB Shkup Nr. 19.9-62906/1 të datës 27.11.2009, leximin e Procesverbalit për kryerjen e konstruksionit nga Gjykata themelore Tetovë HP Nr. 130/09 datë 8.1.2010 me fotodokumentacionin e propozuar nga kryerja e konstruksionit nga SPB Tetovë Nr. 41/2010, këqyri Ekspertizën e gjurmëve të vijave papilare të MPB-Sektorit për krim teknik Shkup të kryer nga personat ekspertë S.D. dhe M. P. S. Nr. TE 2230/09 datë 30.12.2009 me letër **rekomanduese** të MPB Nr. 19.9-62831/1, këqyri Ekspertizën e MPB në formën e analizave daktiloskopike të vijave papilare të Sektorit për krim teknik Nr 19.9-62765/1 datë 22.10.2009, këqyri Ekspertizën e MPB-Sektorit për krim teknik dhe analizë daktiloskopike të gjurmëve të linjave papilare Nr. 19.9-6296/1 datë 21.10.2009, leximin e Ekspertizës plotësuese

të MPB me Nr regj. 19.9-1985/1 datë 27.1.2010 të SKT të kryer nga personat ekspertë, inxhinier i diplomuar - biologu R. J. dhe inxh. kimisti V.A., leximin e Njoftimit të Sektorit për krim teknik pranë MPB Shkup me Nr. 19.9-1985/1 datë 28.1.2010 në formën e përgjigjes së Urdhëresës për ekspertizë të gjurmëve nga linjat papilare, këqyri Fotodokumentacionin e SPB Tetovë Nr. 1371/09 nga bastisja e shtëpisë së K.Xh. në f. Xhermë më datë 15.9.2009, këqyri Fotodokumentacionin e SPB Tetovë Nr. 1373/09, nga përpunimi i teknikës kriminalistike të akuzuarit H. Sh. datë 15.9.2009 në SPB Tetovë me rrëfimin e të akuzuarit dhe veshmbathjen dhe atletet që janë marrë nga i akuzuari dhe që janë dhënë për ekspertizë, këqyri Ekspertizën e gjurmëve me prejardhje biologjike, mikrogjurmë, armë zjarri dhe të gjurmëve nga armë zjarri të MPB-Sektorit për teknikë kriminalistike Shkup Nr. 10788/09 të personave ekspertë – fizikani i diplomuar Nexhat Muriq, kimisti i diplomuar Vesna Antiq dhe inxhinieri i diplomuar - biologu Robert Janevski Nr. 1088/09 dhe numrat 19.9-62906/1, 62729/1, 62765/1,62762/1, 62730/1 dhe 62831/1 të datës 27.11.2009, këqyri Fotodokumentacionin e SPB Tetovë Nr. 1375/09 e nga përpunimi i teknikës kriminalistike të veturës "Daewoo Reiser" të gjetur më 15.9.2009 në stadiumin e qytetit në Tetovë, këqyri Fotodokumentacionin e SPB Tetovë Nr.1372/09 datë 15.9.2009 nga bastisja e shtëpisë së M. M. në f. Xhermë ku jeton edhe i akuzuari A. M., leximin e konstatimit të personit ekspert Dr. A.R. Nr. 03-14/1 datë 18.2.2010, këqyri Fotodokumentacionin dhe skicën e SPB Tetovë Nr 1369/09 nga këqyrja e bërë në vendin e ngjarjes të quajtur "Livadhet e Jonuzit" datë 15.9.2009 me letërpërcjellësen e SPB Tetovë Nr. 30.2-932/1 datë 26.11.2009, këqyri Vërtetimin e Shkollës së mesme tekstile "Gjoce Stojçevski" Tetovë f. 950 datë 8.4.2010 për të akuzuarin J.Xh. dhe Vërtetimin e Zyrës së vendit të f. Xhermë për llojin e karakteristikave për të akuzuarin J. Xh. dhe Vërtetimin e Zyrës së vendit të f. Xhermë për llojin e karakteristikave për të akuzuarit J.Xh. dhe A.M., leximin e Informatës së SPB Tetovë Nr 30.8-3726/1 datë 4.5.2010, leximin e Informatës së Shoqërisë për shërbime komerciale – operatori VIP Shkup datë 13.5.2010, me vazhdim të letrave të hollësishme të thirrjeve telefonike Nr. 077-531-617 që në pajtim me mbrojtjen e dhënë e ka shfrytëzuar i akuzuari A. M., leximin e Informatës së T-Mobil ShA Maqedonia Shkup Nr. 06-810/1 datë 13.5.2010 lidhur me thirrjet hyrëse dhe dalëse nga numrat telefonikë të evidencuar në T-Mobile për të ndjerin Ismet Jahja dhe për të akuzuarit H.Sh. dhe J. Xh. dhe këqyri Kontrollin e hollësishëm sipas kërkesës për periudhën prej 13.9.2009 deri më 15.9.2009 në numrin parapagues 389..... që e shfrytëzonte i akuzuari H.Sh., këqyri edhe Kontrollin e hollësishëm të thirrjeve telefonike për periudhën prej 13.9.2009 deri më 15.9.2009 të telefonit celular për parapaguesin me numër..... që e shfrytëzonte H.Sh. me kontroll të hollësishëm, këqyri Kontrollin e hollësishëm me kërkesë për periudhën kohore prej 13.9.2009 deri më

15.9.2009 për numrin parapagues të celularit me Nr 38970580946 në emër të të ndjerit I. J., këqyri Kontrollin e hollësishëm të thirrjeve telefonike në periudhën prej 13.9.2009 deri më 15.9.2009 për numrin parapagues..... për të ndjerin I. J. me kontroll të hollësishëm, këqyri Kontrollin e hollësishëm për thirrjet e marra telefonike me celular të T-Mobil për periudhën prej 13.9 2009 deri më 15.9.2009 për parapaguesin me numër xxxxxx me të cilin është shërbyer i akuzuari J. Xh., këqyri Kontrollin e hollësishëm për numrin parapagues xxxxxx për periudhën prej 13.9. deri më 15.9.2009 që e ka përdorur i akuzuari J. Xh. me kontrollin e hollësishëm për të gjitha thirrjet telefonike, këqyri Kontrollin e hollësishëm T-Mobil për thirrjet e ardhura në emër të numrit parapagues xxxxxx pra në emrin e të akuzuarit J. Xh., leximin e Njoftimit nga ana e Sektorit për PB Tetovë Nr. 30.4.1-3725/1 datë 06.5.2010 me fotokopje të ofruara telegrami nga SPB Tetovë Nr. 1558 datë 15.9.2009 për kërkimin e personit J. Xh., këqyri Certifikatën e të lindurve dorëzuar në fotokopje nga ana e SPB Tetovë me fotografi të bashkangjitur të evidencës së SPB Tetovë ndaj të njëjtave për të akuzuarit H.Sh. dhe A.M. të bashkangjitur Njoftimit Nr. 30.4.1-3725/1 datë 6.5.2010, leximin e Informatës së SPB Tetovë Nr. 30.804086/1 datë 17.5.2010 në lidhje me personat zyrtarë kujdestarë më datë 17.9.2009 në SPB Tetovë me fotokopje të bashkangjitura të veprimeve të ndërmarra të SPB Tetovë dhe fotokopje të Vërtetimit për sendet e sekuestruara përkohësisht të SP Tetovë Nr. 165/3399 datë 17.9.2009 nga i akuzuari J. Xh., leximin e Informatës së SPB Tetovë dorëzuar Gjykatës themelore në Tetovë - Sektori i hetuesisë KU Nr. 903 datë 17.9.2009, leximin e përmbajtjes së Librit të ngjarjeve ditore të SPB Tetovë Nr. 4 formulari 8 me Numër protokolli 3399 datë 17,9.2009 në orën 01.55 e cila përmbajtje është konstatua në procesverbal nga seanca kryesore datë 03.6.2010, leximin e Deklaratës së dëshmitarit I. J. dhënë në procesverbal para gjykatësit hetues KI Nr. 130/09 datë 9.10.2009 dhe seancës kryesore më datë 26.4.2010, leximin e Deklaratës së personit ekspert - biolog i diplomuar R. J. dhënë në procesverbal nga seanca kryesore më 26.4.2010, leximin e Deklaratës së personit ekspert V.A. dhënë në procesverbal nga seanca kryesore më 26.4.2010, leximin e Deklaratës së personit ekspert N.M. dhënë në procesverbal nga seanca kryesore më 26.4.2010, leximin e Deklaratës së personit ekspert Dr. A.R. dhënë në procesverbal nga seanca kryesore më 26.4.2010, leximin e Deklaratës së dëshmitarit D. M. dhënë në procesverbal nga seanca kryesore më 10.5.2010, leximin e Deklaratës së dëshmitarit A. A. dhënë në procesverbal para gjykatësit hetues K.I. Nr 130/09 datë 5.10.2009, leximin e Deklaratës së dëshmitarit Fatmir Ameti dhënë në procesverbal para gjykatësit hetues K.I. Nr 130/09 datë 5.10.2009, leximin e Deklaratës së dëshmitarit V.P. dhënë në procesverbal jashtë seancës kryesore më datë 9.6.2010, leximin e Deklaratës së dëshmitarit Z. A. dhënë në procesverbal jashtë seancës kryesore më datë

9.6.2010, leximin e Deklaratës së dëshmitarit T. P. dhënë në procesverbal jashtë seancës kryesore më datë 9.6.2010 dhe këqyri Certifikatën e KE në emër të të akuzuarve dhe duke i vlerësuar të gjitha këto dëshmi veç e veç dhe në përgjithësi si një tërësi, bashkë me mbrojtjet e dhëna të të akuzuarve, **në bazë të nenit 14 të LPP dhe vlerësimit të lirë gjyqësor, e vërtetoi këtë gjendje faktike:**

Të akuzuarit H.Sh. i lindur më 1987, J. Xh. i lindur më 1990 dhe A. M. i lindur më 1986 të gjithë nga f. Xhermë - Tetovë janë bashkëfshatarë, ndërsa të akuzuarit H.Sh. dhe J. Xh janë fqinj, njihen ndër vete, kanë komunikuar dhe janë shoqëruar. I akuzuari H. Sh. është i martuar, fëmijë nuk ka, kurse dy të akuzuarit e tjerë janë të pamartuar, deri tani të paakuzuar dhe të padënuar.

Gjatë muajt shtator i akuzuari i parë H.Sh. ka shfrytëzuar telefonin me Nr xxxxxx të T-Mobil Shkup, i akuzuari i dytë J. Xh, shfrytëzoi telefonin celular me numër parapagimi xxxxxx dhe xxxxxx të T-Mobile Shkup, kurse i akuzuari i tretë A.M. shfrytëzoi telefonin celular me numër parapagimi xxxxxxxx të operatorit VIP Shkup.

I ndjeri I. J. i lindur më 1952, i moshës 58-vjeçare, me profesion rrobaqepës dhe pronar i banesës e cila gjendet në lagjen 82 Tetovë, ndërsa jetonte me familjen në shtëpi banimi, bashkë me vëllain I. N. J. në Rr. “Mirçe Acev” Nr 73 në Tetovë. I ndjeri shfrytëzonte telefonin celular me numër parapagimi xxxxxxxx të operatorit T-Mobil Shkup.

I akuzuari H.Sh. me bashkëshorten e tij, para ngjarjes rreth dy muaj e gjysmë jetonte me qira në banesën e të ndjerit I.J. e cila gjendet në lagjen 82 në Tetovë, për të cilën me të ndjerin kishin lidhur marrëveshje për të paguar qira mujore në shumë prej 150 euro, por i akuzuari H. prej kur kishte hyrë në banesë nuk i kishte paguar asgjë të ndjerit Ismet, pra i kishte borxh për qira për dy muaj por i ndjeri nuk kishte bërë presion ndaj të akuzuarit H. për shkak të vonimit të pagesës dhe ishte përgatitur që ta presë prej kur filloi muaji i ramazanit në shenjë të veprave të mira, për dy muaj dhe sipas traditave fetare ishte përgatitur që t’ia falë qiranë.

I akuzuari i parë H.Sh., pasi që jetonte në Tetovë, më 14.09.2009 derisa zgjaste agjërimi i ramazanit, është marrë vesh nëpërmjet telefonit me të akuzuarin e tretë A. i cili në atë kohë punonte si gjipspunues në Shkup, që të takohen të gostiten në Tetovë.

Më 14.09.2009 rreth orës 19, para iftarit, i akuzuari H. u takua me të akuzuarin A. në objektin OH “Amazon”. I akuzuari i parë H. disa herë nëpërmjet telefonit celular ka kontaktuar me të ndjerin I.J., gjatë së cilës, për një paraqitje të I. e ka shfrytëzuar edhe telefonin celular të të akuzuarit të tretë A., me arsyetim se nuk ka kredi, ndërsa kontaktin e fundit me të ndjerin, i

akuzuari H. e ka realizuar përmes telefonit celular të tij në orën 20.15:44 sekonda kur e ka thirrur Ismetin që të takohen te Shkolla e muzikës që t'ia paguajë qiranë e banesës për dy muaj. I ndjeri I. pasi darkoi, bashkë me vëllain e tij I.J. dolën nga shtëpia për të shkuar në xhami. I ndjeri Ismet tha se do të shkonte te Xhamia e Sahatit e cila është në afërsi të Shkollës së muzikës për shkak se duhej të takohet me "qiraxhiun" - të akuzuarin H. për t'ia paguar qiranë e banesës.

Kur i ndjeri I. J arriti te Shkolla e muzikës, aty e priste i akuzuari i parë H. me veturën "Daewoo Reiser" ngjyre të kuqe me tagra TE-677-BL e cila ishte në emër të personit Z. S. nga Tetova. E mori të ndjerin Ismet në veturë duke i premtuar se paratë do t'ia japë në f. Xhermë. Me të ndjerin I. u drejtuan në drejtim të f. Xhermë. Kur i akuzuari H. me të ndjerin I. rreth orës 21 me veturë arritën në vendin e quajtur "Livadhet e Jonuzit" në ngastrën e f. Poroj në anën e djathtë të rrugës e cila çonte për në fshatin Xhermë, aty e priste i akuzuari A dhe J. I akuzuari J kishte me vete pushkë automatike me Nr.14185309 të prodhimit kinez për të cilën i akuzuari H më parë i kishte thënë që ta merrte me vete nga stalla e tij në f. Xhermë dhe t'ia sillte për ta shitur. Pasi që i akuzuari H e ndali veturën, kërkoi nga i ndjeri që të dalë nga vetura. I akuzuari H filloi që ta shajë të ndjerin duke i thënë se i ka borxh 20.000 euro dhe kërkoi t'ia kthente borxhin duke e goditur të ndjerin I. me grushte dhe me shqelma. Kundër të ndjerit u bashkuan edhe të akuzuarit J dhe A. I akuzuari Jumni me një rëndë dorë e mbante pushkën automatike të cilën ia mori i akuzuari H, e repetoi pushkën dhe nga një distancë prej 70 deri 80 cm gjuajti 9 plumba në drejtim të të ndjerit I. J., i cili ndodhej përballë tij, duke i shkaktuar katër plagë shpuese në pjesën e kokës dhe tri plagë shpuese në gjoks, në anën e majtë dhe dy plagë në anën e djathtë të hundës dhe çarje e rrjedhje gjaku prej 7x4 cm mbi gju, nga të cilat i dëmtuari I. J. Ndërroi jetë në vendin e ngjarjes. Më pas, i akuzuari H. e porositi të akuzuarin J. që ta tërheqë zvarrë trupin e të ndjerit 10-15 m në drejtim të malit. Ky e bëri një gjë të tillë dhe e lanë aty. I akuzuari H. pasi ua ktheu pushkën automatike të akuzuarve A dhe J u tha që të largohen. Të akuzuarit A dhe Jumni, me veturën e J. dhe me pushkën automatike të cilën e morën me vete, u drejtuan në drejtim të f. Xhermë, kurse i akuzuari H me veturën e tij u drejtua në drejtim të Tetovës. Kur i akuzuari H arriti në Tetovë, veturën e tij, me qëllim që ta lyejë, e la te autolyerësi - punëtori e personave A. dhe F. A. në afërsi të stadiumit të qytetit. Pastaj u kthye në banesën e të ndjerit ku banonte me qira. Të nesërmen rreth orës 04 vëllai i të ndjerit I. vjen bashkë me djalin e të ndjerit dhe me polici. Kur e kanë pyetur të akuzuarin H. ku është i ndjeri I., i akuzuari H. u është përgjigjur se pas takimit te Shkolla e muzikës, i ndjeri I. ka shkuar në shtëpi kah rruga e pilarës (ushqimores) "Vukovar", duke e fshehur faktin se tashmë i ndjeri I. është vrasë.

Gjendjen faktike të lartpërmendur, Trupi gjykues e vërtetoi në bazë të dëshmive të nxjerra, e pikërisht:

Fakti se i akuzuari H e ka thirrur përmes tel. celular të ndjerin Ismet që të takohen te Shkolla e muzikës që t'ia paguajë qiranë dhe se kjo ka ndodhur pas "iftarit" më datë 14.9.2009 dhe para se i ndjeri I. të shkonte në xhami, vërtetohet nga deklarata e gruas së të ndjerit I. - dëshmitares D. J. cila ishte prezente kur i akuzuari H. është paraqitur dhe ka biseduar me burrin e saj në telefon celular dhe gjatë bisedës e kanë përmendur Shkollën e muzikës. Pas mbarimit të bisedës i ndjeri I. i ka thënë se qiraxhiu ka mbledhur para dhe se dëshiron t'ia paguajë qiranë për dy muaj dhe për atë shkak i duhet të shkojë te Shkolla e muzikës. Gjithashtu, nga deklarata e saj u vërtetua se as atë ditë, e as para asaj dite nuk është diskutuar që qiranë ta paguajë për një vit paraprakisht, ngaqë i ndjeri e dinte se i akuzuari nuk kishte para që ta paguajë qiranë. Madje ishte i gatshëm që t'ia falë qiranë për dy muaj në emër të bamirësisë për shkak të festës fetare "Ramazan Bajramit". Gjithashtu, nga deklarata e saj u vërtetua se qiraja mujore për banesën të cilën e huazoi i akuzuari Haki nga i ndjeri ishte 150 euro dhe se qiraja nuk ishte paguar dy muaj e gjysmë që kur ishin vendosur në banesë.

Nga deklarata e dëshmitarit Idrisnebi Jahja, i vëllai i të ndjerit, me të cilin bashkëjetonte në të njëjtën shtëpi dhe punonin bashkërisht si rrobaqepës, u vërtetua se ka qenë prezent kur i akuzuari H. ka ardhur në punëtorinë e rrobaqepësisë tek i vëllai i ndjeri I. dhe ka kërkuar që t'ia japë banesën me qira sepse nuk ka se ku të jetojë sepse shtëpinë në Xhermë ia ka rrëmbyer lumi. Në vijim tha se vëllai i tij, edhe pse deshi që me të drejtë t'i caktojë qira në një shumë prej 200 eurosh, e uli çmimin në 160 euro dhe se pas ngjarjes kanë kuptuar se i akuzuari H. ka pasur shtëpi në f. Xhermë dhe se nuk ia kishte rrëmbyer lumi.

Në vazhdim nga deklarata e tij u vërtetua se pas mbarimit të "iftarit", më 14.9.2009 të dy kanë dalë nga shtëpia që të shkojnë në xhami dhe se i ndjeri I. i ka thënë se do të shkojë te "Xhamia e Sahatit" e cila është më afër Shkollës së muzikës, ngaqë atje, pas lutjes duhet të takohet me të akuzuarin H. i cili e ka thirrur që ta paguajë qiranë. Gjithashtu, nga dëshmitari I. J. u vërtetua se në mëngjes, para fillimit të ngrënies së mëngjesit (syfyrit), ka ardhur gruaja e të ndjerit – D., e cila e ka lajmëruar se i ndjeri, që kur ka dalë mbrëmë të takohet me të akuzuarin H. dhe ta marrë qiranë, nuk është kthyer më në shtëpi. Është brengosur dhe e ka lutur që ta kërkojnë. Ajo pohon se ky dëshmitar, me të birin e të ndjerit janë drejtuar te banesa e të akuzuarit H. ku banonte me qira që të informohen se çka ka ndodhur me të ndjerin, ngaqë mbrëmë së fundit është takuar me të, se i akuzuari H. nuk ka dashur t'ua hapë derën dhe prandaj kanë thirrur policinë që ta hapin me dhunë banesën. Kur policia ka nisur të trokasë që ta hapë

derën, ka dalë i akuzuari dhe pyetjes se ku është i vëllai I., i akuzuari H., edhe pse e ka ditur se i vëllai është i vrarë, i ka thënë se pas takimit të Shkollës së muzikës, i vëllai I. është drejtuar për në shtëpi kah rruga e pilarës “Vukovar”. Nga deklarata e kësaj dëshmitareje vërtetohet se i ndjeri I. nuk ka bërë presion ndaj të akuzuarit që t’ia paguajë qiranë për dy muaj dhe paraprakisht për tërë vitin dhe se ka qenë i gatshëm, për nder të festës t’ia falë ato dy muaj dhe të mos i kërkojë qira.

Nga deklarata e tij del se i akuzuari H. është dashur ta parapaguajë qiranë për tërë vitin.

Nga këqyrja e raportit të SPB Tetovë dërguar gjykatësit hetues të Gjykatës themelore Tetovë KU. Nr. 903 datë 17.9.2009 dhe nga këqyrja e vërtetimeve për sendet e sekuestruara nga ana e SPB Tetovë datë 17.9.2009 nga të akuzuarit A. M. dhe J. Xh., në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet fakti se gjatë arrestimit të të akuzuarve A. M. dhe J. Xh. më 17.9.2009 në SPB Tetovë për shkak të dyshimit se bashkë me të akuzuarin Haki Shabani janë kryerës të veprës penale **vrasje**, nga i akuzuari A. M. është marrë celulari me numër parapagues të operatorit VIP xxxxxx, ndërsa nga i akuzuari J. Xh. janë marrë dy telefona celularë edhe atë një i tipit Nokia 6230 me numër parapagues të T-Mobil xxxxxxxx dhe një i tipit Nokia N 73 me numër parapagues të T-Mobil xxxxxxxxxx.

Më tutje, nga këqyrja e Vërtetimit të SPB Tetovë Nr. 165/3399 datë 17.9.2009 është vërtetuar se të akuzuarit J. Xh. në SPB Tetovë i është sekuestruar një pushkë automatike pa kondak, prodhim kinez me Nr. fabrike 14185309 me një karikator me plumba të kalibrit 7,62 mm, gjë që është shënuar në Librin e ngjarjeve ditore Nr. 3399, se të akuzuarit J. Xh. dhe A. M. më 14.9.2009 kanë poseduar dhe kanë shfrytëzuar këta telefona celularë me këta numra parapagues. Kjo është vërtetuar edhe nga deklaratat e tyre të dhëna në seancën kryesore si dhe nga raporti i pranuar – thirrjet telefonike të operatorëve VIP dhe T- Mobil. Fakti se nga i akuzuari H.Sh. më 15.9.2009 është marrë një tel. celular i tipit “LG” dhe se i akuzuari H.Sh. e ka shfrytëzuar me numër parapagues T-Mobil xxxxxxxx, është vërtetuar nga Vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga SPB Tetovë më 15.5.2009 nga i akuzuari H. si dhe nga deklarata e të akuzuarit H. në seancën kryesore që ka të bëjë me numrin parapagues.

Fakti që i ndjeri I. Jaja me armë zjarri është privuar nga jeta më 14.9.2009 rreth orës 21 në vendin e quajtur “Livadhet e Jonuzit” në ngastrën e f. Poroj rreth rrugës për në f. Xhermë është vërtetuar nga këqyrja e Procesverbalit për këqyrje në vendin e ngjarjes datë 15.9.2009 në orën 16.30 nga ana e gjykatësit hetues të Gjykatës themelore Tetovë OID. Nr. 159/9 dhe nga fotodokumentacioni i bashkangjitur gjatë këqyrjes në vendin e ngjarjes nga SPB Tetovë – OKT

Tetovë Nr. 136/09 datë 15.9.2009. Nga këto prova u vërtetua fakti se në vendin e quajtur “Livadhet e Jonuzit “, në ngastrën e f. Poroj, në anën e djathtë të rrugës e cila çon në drejtim të f. Xhermë, duke shikuar në drejtim të f. Xhermë ku fillon mali me dru dushku, është gjetur kufoma e të ndjerit Ismet Jahja, i lindur më 25.03.1952 në Tetovë, i shtrirë në shpinë, me plagë shpuese, me ç’rast në vendin e ngjarjes janë gjetur edhe tetë gëzhoja nga pushka automatike kalibri 7,62 mm dhe një plumb i pashkrepur pushke automatike, kalibër 7,62 mm, një predhë nga municioni i pushkës kalibër 7,62 mm dhe dy gëzhoja pistolete, njëra me kalibër 9 mm, kurse tjetra me kalibër 7,62 mm, të cilat janë marrë te vendi i ngjarjes dhe janë dërguar për ekspertizë. Po ashtu, nga këto prova u vërtetua fakti se në vendin e ngjarjes te gëzhojat ka pasur **njolla** gjaku nga dy të parat që janë gjetur në tokë dhe shenjat e predhave në tokë dhe se është dhënë urdhëresë për kryerje të obduksionit mbi trupin e të ndjerit. Ekzistimi i njollave të gjakut e vërteton faktin se trupi i të ndjerit nga vendi ku është privuar nga jeta është tërhequr në drejtim të malit.

Në këqyrjen e Protokollit të sekcionit të Shërbimit të mjekësisë ligjore dhe kriminalistike në Spitalin Klinik të Tetovës Nr. 03-102/2 datë 28.9.2009 nga personat ekspertë Dr. A. R. dhe Dr. D. D. - specialist i Mjekësisë ligjore dhe kriminalistike, në mënyrë të pakontestueshme u vërtetuan rrethanat se vdekja e të ndjerit I. J. është bërë dhunshëm, si pasojë e copëtimit të trurit dhe të indeve të trurit, të shkaktuar nga depërtimi i plumbit nga arma e zjarrit në pjesën e kokës së të ndjerit I. J. Janë konstatuar katër plagë shpuese në pjesën e kokës dhe tri plagë shpuese në pjesën e gjoksit në anën e majtë dhe dy plagë tangjente në pjesën e djathtë të hundës si dhe gjakderdhje të brendshme 7x4 cm në pjesën mbi gju nga pjesa e brendshme, nga e cila i dëmtuari ka vdekur në vendin e ngjarjes; se plagët shpuese janë nga arma e zjarrit dhe se vdekja ka ndodhur para 20 orëve që kur kufoma më 15.9.2009 është sjellë në Shërbimin e mjekësisë ligjore për obduksion, i cili obduksion ka filluar më 15.9.2009 në orën 21.00.

Nga rezultatet e personave ekspertë të pasqyruara në Protokollin e sekcionit për kohën e vdekjes, u vërtetua fakti se i ndjeri I. J. është privuar nga jeta më 14.9.2009 rreth orës 21 00.

Nga këqyrja e Vërtetimit për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i akuzuari H.Sh. nga SPB Tetovë SL. datë 15.9.2009 dhe nga fotodokumentacioni i SPB Tetovë Nr. 1373/09 të përpunimit teknik kriminalistik ndaj të akuzuarit H. Sh. në hapësirat e SPB Tetovë për shkak të dyshimit se ka kryer VRASJE, janë vërtetuar rrethanat se nga i akuzuari H. Sh. më 15.9.2009, pas arrestimit nga SPB Tetovë janë sekuestruar një palë xhinse me ngjyre të kuqe të tipit BG Star, një bluzë me krah ngjyre të kaltër dhe një palë atlete të bardha MGB të

cilat i kishte me vete, kurse nga këqyrja e Procesverbalit për kryerjen e bastisjes në bllok 82 Nr. 11 ku jetonte me bashkëshorten i akuzuari H., është vërtetuar se gjatë bastisjes i është gjetur dhe i është sekuestruar Leja e qarkullimit Nr. 1048994, e veturës “Daewoo Reiser” me targa TE 677-BL në emër të personit Z.S. nga Tetova dhe 12 SIM kartela për tel. celular të operatorit T-Mobil. Këta 12 SIM kartela që janë gjetur në banesën e të akuzuarit H .Sh. dëshmojnë për faktin se i akuzuari H.Sh., përveç telefonit me numër të T-Mobil xxxxxxxx, dispononte dhe mund të kontaktonte edhe nga numra telefoni të tjerë dhe jo vetëm nga numri i theksuar xxxxxxxx.

Nga këqyrja e Procesverbalit për gjetjen e gjurmëve dhe të sendeve në vendin e ngjarjes të SPB Tetovë, me Nr 1357/09 datë 15.9.2009 dhe e fotoalbumit të SPB Tetovë me Nr. 1375/09 datë 15.9.2009 për kryerje dhe përpunim kriminalistik teknik të veturës “Daewoo Reiser” me targa TE 677-BL janë vërtetuar rrethanat se vetura ngjyre të kuqe është gjetur më 15.9.2009 para autolyerësit afër stadiumit të qytetit në Tetovë dhe e njëjta është shfrytëzuar gjatë vrasjes së të ndjerit Ismet Jahja .Fakti që i akuzuari H.Sh. e posedonte këtë veturë dhe me të njëjtën e ka dërguar të ndjerin Ismet në vendin e quajtur “Livadhet e Jonuzit” më 14.9.2009 është vërtetuar edhe nga mbrojtja e të akuzuarit H. si dhe nga mbrojtja e të akuzuarve J. dhe A. se në vendin kritik, i akuzuari H. erdhi me veturë ngjyre të kuqe si dhe nga deklaratat e dëshmitarëve F. dhe A. A., pronarë të punëtorisë për lyerje të veturave, që gjendet te stadiumi i qytetit në Tetovë, me të cilët i akuzuari H., një ditë më parë është marrë vesh për lyerjen e veturës me çmim në vlerë prej 500 euro dhe se i akuzuari H. ka bërë marrëveshje që paratë t’i paguajë me kompensim duke kryer punë fasadimi, fakt ky i pakontestueshëm.

Se vetura me targa TE-677 BL është drejtuar nga i akuzuari H. Sh. është vërtetuar edhe nga ekspertiza e gjurmëve të vijave papilare TE-Nr. 2230/09 të personave ekspertë S. D. dhe M. P. – S. datë 30.12.2009 dhe nga ekspertiza Nr 19.9-62831/1 datë 30.10.2009 të personit ekspert S. D. nga e cila del se nga përpunimi fotolaboratorik kriminalistik teknik i gjurmëve të vijave të fiksuara papilare në sipërfaqen e dukshme të retrovizorit të brendshëm të veturës ”Daewoo Reiser” me targa TE-677-BL e cila është gjetur te stadiumi i qytetit më 15.9.2009 vërehen gjurmët e vijave papilare dhe të njëjtat kanë të bëjnë me gishtin e madh të dorës së të akuzuarit Haki Shabani.

Nga këqyrja e Procesverbalit për bastisjen nga SPB Tetovë të shtëpisë së të akuzuarit A.M. nga f. Xhermë ku jeton edhe familja e tij, të kryer më 15.9.2009 dhe nga fotodokumentacioni i SPB-Tetovë Nr. 1372/09 datë 15.9.2009, e Vërtetimit për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga SPB Tetovë datë 15.9.2009 nga M. M. -baba i të akuzuarit A. dhe

nga këqyrja e Procesverbalit për gjetje të gjurmëve të SPB Tetovë Nr. 1372/09 datë 15.9.2009 në shtëpinë e të akuzuarit A.M. në f. Xhermë, është vërtetuar se nga babai i të akuzuarit Agim Muzafer Miftari është sekuestruar një pushkë gjuetie me 15 plumba dhe Leja e posedimit të armës Nr. 4101 e cila është lëshuar nga ana e SPB Tetovë datë 9.7.1979 dhe një palë xhinse të lara dhe të varura në tel për t'u tharë në ballkonin e shtëpisë me gjurmë gjaku, të cilat janë sekuestruar dhe janë dorëzuar për ekspertizë për shkak të dyshimit se të njëjtat i ka pasur të veshura i akuzuari në kohën kur është privuar nga jeta i ndjeri Ismet Jahja.

Nga këqyrja e Procesverbalit për kryerjen e bastisjes nga SPB Tetovë datë 15.9.2009 në shtëpinë e të akuzuarit Jumni Xhemailit nga f. Xhermë, e fotoalbumit të SPB Tetovë, nga bastisja e kryer Nr 1371/09 datë 15,9,2009, e Vërtetimit për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga SPB Tetovë datë 15.9.2009 nga K. Xh. - gjysh i të akuzuarit J. dhe të Procesverbalit për gjetjen e gjurmëve dhe të sendeve në vendin e ngjarjes gjatë këqyrjes Nr. 1371/09 nga SPB Tetovë datë 15.9.2009, është vërtetuar fakti se gjatë bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit J. Xh. në të cilën jeton edhe familja e tij të kryer më 15,9.2009, në një orman të vjetër në bodrum është gjetur një kondak prej druri me ngjyrë kafeje, ndërsa në dhomën e shtëpisë në të cilën jetonte i akuzuari J., në një kuti me bizhuteri dhe imtësi të tjera është gjetur një plumb i cili është sekuestruar nga poseduesi i shtëpisë në shtëpinë e K.Xh.

Nga DEKLARATAT E DËSHMITARËVE – PERSONAVE ZYRTARË TË SPI Tetovë V.P. dhe Z. A. dhe nga këqyrja e përmbajtjes së Ditarit për ngjarjet ditore të SPB Tetovë për datën 17.9.2009 me Nr. rendor 3399, është vërtetuar se pushka automatike me numër..... pa kondak është sekuestruar nga i akuzuari J. Xh. në kohën kur i akuzuari J.Xh. dhe A. M. janë arrestuar në SPB Tetovë nga personat për pranim dhe nga deklarata e dëshmitarit D. M të punësuar në SPB Tetovë Sektori për tekniko-kriminalistikë, vërtetohet se e ka pranuar pushkën për përpunim tekniko kriminalistik, porse ai nuk e ka marrë nga i akuzuara J. dhe se nuk e ka përpiluar Vërtetimin për sendet e sekuestruara përkohësisht dhe se si person zyrtar, është nënshkruar në vërtetim gabimisht. Kjo e vërteton mbrojtjen e të akuzuarve A. dhe J. se pushkën me të cilën është privuar nga jeta i ndjeri I. J. vetë e kanë dorëzuar në SPB Tetovë.

Nga këqyrja në ekspertizën e SPB Shkup - Sektori për tek. Kriminalistike, Sektori për identifikim kriminalistik Nr. 19.9-62906/1 në lidhje me analizën daktiloskopike të gjurmëve të vijave papilare të dorëzuara, të gjetura në vendngjarje dhe 8 gëzhojat e sekuestruara të kalibrit 7,62x39 mm, 1 gëzhojë kal 7,62x39 mm, 1 plumb 7,62x39 mm nuk janë shkaktuar gjurmë nga

vijat papilare, gjegjësisht në gëzhojat dhe në plumbat e sekuestruar nuk ka gjurmë vijash papilare te asnjëri prej të akuzuarve.

Nga ekspertiza e bërë e SPB Shkup, Sektori për tek. Kriminalistike - Sektori për identifikim kriminalistik Nr. 19.9-62765/1 datë 22.10.2009 dhe gjatë analizës daktiloskopike të gjurmëve papilare nga pushka automatike e sekuestruar nga i akuzuari J. Xh., prodhim kinez Nr.14185309, vërtetohet se nuk janë shkaktuar gjurmë nga vijat papilare, nga karikatori i sekuestruar; nga një plumb janë shkaktuar gjurmë jo të qarta nga vijat papilare, gjë që korrespondon me mbrojtjen e të akuzuarit A. prej se i akuzuari H. ka krisur me pushkë automatike, drejt tanimë të ndjerit I. Pastaj të njëjtën e ka pastruar dhe ja ka hedhur në dorë, duke e porositur që ta fshehë diku dhe se bashkë me J. të dy e kanë pasur në dorë pushkën para se të dorëzohet në SPB Tetovë, gjegjësisht se për shkak të pastrimit të pushkës nuk është e mundur të shkaktohen gjurmë konkrete të mbetura nga vijat papilare. Fakti se pas krisjes tashmë mbi të ndjerin I., i akuzuari H. e ka pastruar pushkën, tregon se në atë mënyrë ka dashur t'i fshehë gjurmët nga vijat papilare dhe me atë edhe përgjegjësinë penale dhe një pastrim i tillë i pushkës korrespondon edhe me konstatimin e personit ekspert V. A. se në pushkë nuk ka gjurmë nga grimcat e barotit, të cilat mund të hiqen me fërkim me ndonjë stof.

Nga ekspertiza e bërë e gjurmëve biologjike të prejardhura, e gjurmëve nga arma e zjarrit të MPB Shkup, Sektori për tek. kriminalistike, Nr. 1088.09, Nr. 19.9-62906/1, 62729/1, 62765/162762/1, 62730/1 dhe 62831/1 datë 27.11.2009 të personave ekspertë fizikani i diplomuar N. M., inxhinieri i diplomuar - kimisti V. A. dhe inxhinieri i diplomuar - biologu R. J., nga të dhënat e tij plotësuese në seancën kryesore, në mënyrë të pakontestueshme u vërtetua se pushka automatike e dorëzuar, e prodhimit kinez me kalibër 7,62x39 mm, pushkë automatike ruse –“Kallashnikov AK-47” se ka gjuajtur në mënyrë individuale dhe në rafal. E njëjta është pa kondak të drurit dhe e pajisur me bajonetë dhe se nga gjuajtjet për provë u konstatua se funksionon në rregull .

Më tutje u vërtetua se gjatë analizave mikroskopike komparative, gëzhojat e dorëzuara nga municioni i pushkës kalibër 7,62x39 mm janë gjetur në vendin ku është gjetur kufoma e të ndjerit Ismet. Kjo përputhet me gëzhojat e fituara nga gjuajtja provuese e pushkës automatike e cila është sekuestruar nga i akuzuari J. nga SPB Tetovë. Kjo është konstatuar në mënyrë të ndërsjellë, duke i përfshirë edhe gjurmët e krismave të karakteristikave individuale sa i përket faktit se 8 gëzhojat e dorëzuara nga municioni i pushkës 7,62x39 mm të gjetura në vendngjarje janë gjuajtur nga pushka automatike e dorëzuar, kalibër 7,62x39 mm, me numër të fabrikës 14185309. Më tutje vërtetohet se kondaku i pushkës i drurit i sekuestruar nga shtëpia ku jeton

familja e të akuzuarit J.Xh. rrjedh nga pushka automatike e cila është dorëzuar dhe se vetë kondaku, në pjesën e cila është pjesë përbërëse e pushkës, është në përputhje mekanike dhe me pamje të konturuar nga kjo përbërje e theksuar. Gjatë kryerjes së analizës komparative vizuale të konturës së përbërjes së pushkës dhe të kondakut si përbërje individuale, tregon se kondaku si lëndë ka prejardhje nga pushka e dorëzuar. Dy gëzhojat e municionit të pistoletës të gjetura në vendngjarje gjatë kryerjes së analizave është vërtetuar se kanë shpërthyer më herët, gjegjësisht nuk kanë të bëjnë me ngjarjen.

Po ashtu nga të dhënat e personave ekspertë N. M. Të paraqitura në seancën kryesore është vërtetuar se plumbi i gjetur në kutinë e stolive në shtëpinë e të akuzuarit J. me kalibër 7,62x54 mm, është për tjetër lloj arme, gjegjësisht për pushkë luftarake nga ai kalibër dhe se ky plumb nuk mund të përdoret nga pushka automatike prej të cilës është privuar nga jeta i ndjeri I. për shkak se pushka është e kalibrit 7,62x39 mm dhe për këtë mund të shfrytëzohet vetëm municion i këtij kalibri, gjegjësisht 7,62x39 mm.

Nga kjo ekspertizë vërtetohet fakti se gjatë kryerjes së analizës së bluzës së dorëzuar, të sekuestruar nga i ndjeri I. J. është konstatuar një numër i madh i dëmtimeve në pjesën e përparme dhe të pasme. Në pjesën e përparme të majtë të bluzës si lëndë ka dëmtim prej 11 cm, kurse në pjesën e krahut të majtë 12 cm nga kjo përbërje dhe duke u bazuar në reaksionet e ndryshme cilësore dhe në gjendjen e materialit nga dëmtimi i përshkruar, është vërtetuar se e njëjta është realizuar nga hyrja e predhës. Është zbatuar metoda e quajtur Voker për përcaktimin e largësisë gjatë gjuajtje nga e cila është fituar gjendje pozitive, kurse fotografia e fituar nga baroti është analizuar në mënyrë komparative dhe është fituar nga kryerja e gjuajtjes si provë dhe me këtë rast është konstatuar se gjuajtja ndaj të ndjerit është bërë me pushkën automatike si lëndë nga një largësi prej 70-80 cm dhe se kryerësi dhe i ndjeri kanë qenë ballë për ballë në momentin e gjuajtjes, në një largësi prej 70-80 cm dhe se për një lloj të tillë të armës edhe atë pushkë automatike, sipas personit ekspert V. A., këto gjurmë mund të bëhen gjatë gjuajtjes nga një largësi maksimale 1,20 m. Me zbatimin e metodës Voker është vërtetuar prezenca e nitrateve të cilat janë gjurmë baroti, gjegjësisht është baroti vetë..

Po ashtu, nga të dhënat e personit ekspert V. A. si dhe nga përgatitja e ekspertizës është vërtetuar se në folitë e testit të barotit, të dala nga duart e të akuzuarve H. Sh., J. Xh., A. M. dhe nga i ndjeri I. J., nuk është vërtetuar se ka grimca të nitratis dhe për këtë mund të ketë shumë arsye, si: larje e duarve, fërkimi i fortë i duarve me tekstil, cilësia e gjendjes së municionit, të ketë zbrazje të plotë, kushtet klimatike dhe hapësirat, ngase sikur të ndodhet

jashtë në hapësirë të hapur ato shumë rëndë mund të ngelin për shkak se gazrat mund të shkojnë në drejtim tjetër .

Nga këto të dhëna të personit ekspert, gjegjësisht nga testi i barotit është e logjikshme të arrihet në përfundime të tilla, për shkak se pas ngjarjes, të akuzuarit A. dhe J. kanë shkuar në f. Xhermë, kurse i akuzuari H. - në Tetovë dhe se testet për barotin janë kryer tek i akuzuari H. të nesërmen, ndërsa ato të të akuzuarve J. dhe A., kur janë arrestuar më 17.9.2009 dhe pasojat janë të logjikshme nga koha e kaluar dhe nga mundësia e largimit.

Po ashtu, nga kryerja e ekspertizës si dhe nga deklarata plotësuese e personit ekspert V. A. është vërtetuar se gjatë analizës së bluzës të sekuestruar nga i akuzuari H. Sh. nuk është vërtetuar prezenca e grimcave të nitratit dhe gjatë gjuajtjes me pushkë automatike, në duar dhe në tesha të cilat i kishte të veshura personi që gjuajti, mund të ngelin gjurmë të gazit të barotit, por mund edhe të mos ngelin gjurmë për arsyeve të njëjta që kanë të bëjnë me gjurmët nga baroti dhe nga grimcat në duar, gjegjësisht mund në mënyrë shumë të lehtë të shkuden nga stofi, nga bluza apo nga ndonjë xhup i veshur.

Nga ekspertiza e bërë e gjurmëve biologjike të xhinseve të sekuestruara nga teli për tharje të teshave të cilat i ka mbajtur i akuzuari A.M., e veshjes dhe e atletet të sekuestruara nga i akuzuari H.Sh. u vërtetua se në xhinset - pronë e të akuzuarit A.M., edhe atë në pjesën e poshtme, prapa në këmbën e majtë, janë hasur gjurmë të ngjashme të gjakut në formë të shtrirjes së hollë sipërfaqësore, kurse në veshjet e sekuestruara nga i akuzuari H. Sh. nuk janë hasur gjurmë të dukshme të ngjashme të gjakut. Për të vërtetuar nëse në të njëjtën ka gjurmë të padukshme latente gjaku në sipërfaqen e veshjes së ofruar nga i akuzuari H.Sh., me analizën individuale, duke realizuar regresin e identifikimit për qasje të gjurmëve të gjakut – benzidin, është fituar reaksioni pozitiv për prezencë të gjurmëve latente të gjakut në bluzën me krahë të gjatë në gjithë pjesën e përparme, te pantallonat e zeza në pjesën e përparme dhe të pasme mbi gjurin e majtë dhe në dy atletet në pjesën e përparme. Më tutje u vërtetua se gjurmët të ngjashme me gjak nga vendngjarja dhe gjurmët e gjetura në predhë dhe në xhinset e të akuzuarit A. M. janë gjurmë gjaku dhe se është përdorur metoda e quajtur Ulenhut për testimin e gjurmëve të marra në vendngjarje dhe nga predha. Këto paraqesin gjurmë të gjakut të njeriut. Me analizën e gjurmëve të gjakut të marrë në vendngjarje është vërtetuar se i takon grupit “A” të gjakut.

Gjatë kësaj ekspertize të gjurmëve të gjakut në vendngjarje dhe të gjurmëve të mbetura në xhinset e të akuzuarit A.M. dhe të njollave të marra nga pantallonat e H.SH. në pjesën ku është fituar reaksion pozitiv për prezencë të gjurmëve të gjakut dhe të njollave të dorëzuara, të

marra nga vetura dhe të kampionëve të gjaku të të ndjerit Ismet Jahja, të njollave të marra nga goja e të akuzuarve, të dorëzuara për analizë të ADN-së, është vërtetuar se gjurmët e gjakut që gjendeshin në xhinset e të akuzuarit A.M. kanë prejardhje nga një individ mashkull dhe me kryerjen e analizave të ndërsjella është vërtetuar se kanë të bëjnë me ADN të profilit të përftuar nga gjurmët e gjakut në xhinset e A.M. Me ADN profil të përftuar nga kampioni i gjakut të marrë nga i ndjeri Ismet Jahja dhe nga gjurmët e marra nga xhinset e të akuzuarit A.M. është vërtetuar se kanë prejardhje nga i ndjeri I.J. Kjo mundësi përjashtohet po qe se ka vëlla binjak.

Më tutje nga ekspertiza e kryer dhe nga të dhënat e ekspertit R.J. vërtetohet se gjurmët e gjakut latent të veshjes së të akuzuarit H.SH. nuk ka rezultate të qarta për shkak se për ADN nuk ka sasi të mjaftueshme të gjurmëve, në njërën anë, kurse në anën tjetër veshmbathja është bartur nga personi edhe në rastin e marrjes së njollave mbi gjithë sipërfaqen e teshave dhe ato njolla do të ngjiteshin edhe te të gjitha gjurmët e tjera biologjike të cilat do të ishin në ato veshje, edhe atë gjurmë të djersëve, gjurmë epiteli dhe ngjashëm dhe do të kishte ardhur deri te përzierja e të gjitha atyre gjurmëve dhe për atë shkak ADN analiza nuk është e përshtatshme për identifikim.

Nga konstatimi i ekspertit R.J. në formë të shkruar, nga plotësimi në seancën kryesore dhe nga ekspertiza plotësuese në MPB – Sektori për krim teknik, në formë njoftimi, të dorëzuar gjykatësi hetues Nr.19.9-1985/1 datë 27.1.2010 vërtetohet se gjurmët latente të gjakut të konstatuara në veshjen e personit H.SH. ashtu siç është theksuar në ekspertizën me shkrim, janë të padukshme, ndaj nuk mund të konstatohet forma e tyre dhe këta gjurmë të teshave tek i akuzuari H.SH. mund të shfaqen gjatë kontaktit me predhë me trupin e të ndjerit për shkak se fuqia aerodinamike e predhës ka efektin kthyes të thërmijave të imëta shpërthyese nga vendi i kontaktit të cilat mund të kthejnë pas deri në një metër, varësisht nga fuqia kinetike e predhës, çfarë tasha ka pasur në sipërfaqen e trupit dhe nga kushtet atmosferike .

Një konstatim i tillë i ekspertit korrespondon me konstatimin e ekspertit V. A. se gjuajtja nga pushka automatike në drejtim të të ndjerit ishte nga një distancë 70-80 cm.

Gjatë kësaj u vërtetua se të akuzuari J. XH. nuk i janë marrë teshat dhe nuk kanë qenë si lëndë e ekspertizës, gjegjësisht tek i akuzuari J.XH. nuk është gjetur asnjë gjurmë që ka të bëjë me vrasjen e kryer.

Nga konstatimi i ekspertit A. R. - specialist i mjekësisë ligjore kriminalistike Nr.03-14/1 datë 18.2.2010, i përgatitur duke u bazuar në plagët shpuese të vërtetuara të të ndjerit I. J., në gjurmët latente nga gjaku të cilat janë gjetur në teshat dhe në mbathjet e të akuzuarit

H.SH. dhe në xhinset e të akuzuarit A. M., në dëmtimin e teshave të të ndjerit I. si dhe në plagët e tjera dhe në gjakderdhjen e konstatuar tek i ndjeri dhe në rikonstrukcionin e kryer për ngjarjen, sipas versionit të tre të akuzuarve, sipas plagëve hyrëse të vërtetuara në bazë të Protokollit të sekcionit, të cilat ishin në pjesën e kokës, kryesisht në pjesën e majtë të fytyrës dhe plagëve në pjesën e majtë të gjoksit si dhe në anën e djathtë të shpinës sipas dimensioneve të tyre dhe sipas konstatimit të ekspertizës balistike është vërtetuar se këto plagë janë marrë gjatë gjuajtjes me armë të kalibrit që është konstatuar gjatë ekzaminimit të gëzhgojave dhe të predhave të gjetura në vendngjarje.

Duke pasur parasysh se plagët hyrëse nga plagët shpërthyes të konstatuara në pjesën e majtë të gjoksit dhe në pjesën e majtë të fytyrës si dhe plagët në pjesën e djathtë të hundës dhe të fytyrës në drejtim nga e majta në të djathtë, ashtu si ishin plagët hyrëse nga pjesa e djathtë e shpinës, u vërtetua se me armë është gjuajtur nga pjesa e parë e majtë e të ndjerit. Gjatë kësaj të dy kanë qenë ballë për ballë ose fytyrë për fytyrë, kështu që dinamikat e gjuajtjeve të para janë drejtuar në drejtim të gjoksit ku ka filluar të zhvillohet dinamika për rënie në tokë, kështu që gjuajtjet e fundit e kanë goditur në pjesën e majtë të fytyrës dhe gjatë rënies në tokë i ndjeri Ismet Jahja ka marrë goditjet e fundit të plumbit i cili ka vepruar në pjesën e fytyrës dhe në dinamikën e rrotullimit të trupit në drejtim të personit që gjuante ose i ka marrë plagët nga ana e djathtë e pjesës së përparme të qafës, e cila ishte në drejtimin lartë-poshtë, nga para mbrapa dhe nga e djathta në të majtë. Plumbi që ka goditur tokën është gjetur në vendngjarje gjatë këqyrjes.

Sipas konstatimit të ekspertit Dr. A. R. të dhënë mbi baza shkencore dhe përvojës, me armë është krisur gjatë gjendjes vertikale të kryerësit të vrasjes dhe trupit të viktimës të cilët kanë qenë ballë për ballë, njëri kah tjetri, gjatë së cilës, sipas lartësisë së plagëve, trupi i të ndjerit ka qenë në nivel më të ulët në krahasim me trupin e personit i cili ka krisur. I ndjeri, të gjitha plagët i ka pranuar thjesht njëra pas tjetrës, të parën në gjoks në anën e majtë, pastaj në fytyrë në pjesën e majtë dhe në fund plagën në qafë në pjesën e përparme të djathtë. Gjatë rënies horizontale të trupit në dinamikën e rënies së trupit në tokë, personi i cili ka gjuajtur ndaj të ndjerit nuk ka qenë më larg se një metër, se arma ka qenë me tytë të gjatë, tip që hedh përmes barotit nga 1,5 m nga gryka e tytës. Po ashtu, sipas karakteristikave të plagëve shpuese, e posaçërisht karakteristikave të plagëve në kokë mund të konstatohet se arma me të cilën është gjuajtur ka qenë e fuqishme për shkak të së cilës janë shkatërruar strukturat e kafkës dhe të fytyrës gjatë veprimit të fuqishëm të plumbit me shpejtësi të madhe.

Posaçërisht nga konstatimi i ekspertit A.R. të dhënë në formë të shkruar dhe në seancën kryesore më 26.4.2010 u vërtetua se gjatë kontaktit, predha me shpejtësi të madhe të cilën e kishte edhe nga vetitë xhiroskopike që e jep fuqinë aerodinamike të plumbit nga ky lloj karakteri dhe nga kjo lloj pushke - lëviz me një shpejtësi prej 300 m në sekondë dhe në vendin ku ka depërtuar plumbi, fuqia aerodinamike kur has në pengesë në momentin kur plumbi depërton në trup, vepron dhe reagon në mënyrë hidrodinamike dhe nga ky veprim shkatërron indet e buta në atë pjesë ku ka hasur në rezistencë të trupit, fillon të lëvizë në drejtim të kundërt nga drejtimi i gjuajtjes dhe të njëjtat janë thërmija të imëta më të vogla se një mm, shpërthen dhe mund të gjenden deri në një metër afër trupit të të vrarit dhe kanë aftësi që të hyjnë në mes rrobave dhe nuk shihen me sy dhe janë si pasojë e plagëve hyrëse. Këto pika të imta të gjakut si pasojë e fuqisë hidrodinamike të cilat janë më të vogla se një mm, gjatë daljes zgjerohen në trup në të cilin është shtënë me armë, gjegjësisht të gjitha lëvizin në drejtim të kundërt prej nga ka ardhur plumbi, e posaçërisht kur vepron në pjesën e kokës, po ashtu ekziston mundësia që nga fuqia të shpërndahen në formë të stërpikjes edhe më shumë se një metër dhe ekziston mundësia që pikat e imëta të gjakut të bien edhe në tytën e pushkës, në duart e personit që ka gjuajtur dhe në pjesën e përparme të sulmuesit, në formë të pikave latente të gjakut të cilat janë shumë të imëta dhe për shkak të kësaj mund të ngjiten në rrobat e stofit, në mes thërmijave të cilat nuk tregojnë asgjë dhe e tregon me vizatim (sipas ligjeve të fizikës, në çdo aksion ka edhe reaksion). Më tutje është vërtetuar se mënyra e tillë e hedhjes së pikave është karakteristikë e plagëve hyrëse për shkak se një hedhje e tillë ekziston edhe në pjesën e plagëve dalëse në drejtimin në të cilin lëviz predha dhe të njëjtat shihen me sy, menjëherë shihen nga largësia, e po qe se objekti është në drejtim të lëvizjes së predhës dhe pasi del nga plaga dalëse, atëherë e njëjta predhë mund ta godasë atë objekt ose mund t'i sjellë lëndime edhe personit i cili do të gjendet në atë drejtim.

Sipas konstatimit të ekspertit A. R., gjurmët latente të gjakut në bluzën e të akuzuarit H.SH., në pjesën e përparme të saj nuk shihen me sy, por zbulohen gjatë zbatimit të metodës së posaçme. E njëjta mund të paraqitet gjatë reaksionit kthyes nga trupi i të ndjerit edhe atë nga plagët hyrëse dhe nga pjesa e fytyrës së të ndjerit, nga ana e majtë dhe nga një distancë prej një metri është e mundshme të gjuhet me armë. Këto gjurmë nuk janë nga plagët dalëse për shkak se shihen me sy dhe intensivisht nuk mund të caktohen nga ADN-ja. Profili ose grupi i gjakut i këtyre shenjave të plumbit i cili lëviz në atë drejtim do ta lëndonin edhe atë – H.SH., po të gjendej në anën e daljes së plumbit prej trupit.

Nga kjo dhe nga gjurmët latente të gjakut të bluzës së të akuzuarit H.SH. dhe nga konstatimi i ekspertit Dr A. R. është vërtetuar se i akuzuari H.SH. është ai që ka gjuajtur ndaj të ndjerit dhe se në momentin kur ka gjuajtur me pushkë automatike ishte në një largësi deri në një metër dhe ishte në drejtim të të ndjerit në pozicionin ballë për ballë.

Më tutje, nga konstatimi i ekspertit Dr. A. R., nëpërmjet detektimit, është vërtetuar se në pantallonat me ngjyrë të zezë të cilat i mbante i akuzuari H.SH., në pjesën e përparme dhe të pasme të anës së majtë, janë gjetur gjurmë latente të gjakut të cilat mund të ndodhin gjatë një prekjeje të shkurtër me gjakun e të ndjerit, edhe atë pasi është vrarë dhe në momentin kur të ndjerin Ismet e ka kapur për dore të majtë në gjendje të njëjtë, që i përgjigjet gjendjes kur i akuzuari Haki e ka kapur të ndjerin për ta tërhequr dhe për ta fshehur në afërsi të malit dhe se nga ai pozicion mundet të përlyhen pantallonat nga pjesa e parme dhe e pasme, bashkë me pjesën e parme të atleteve ku ka pasur një kontakt të shkurtër me gjakun e të ndjerit, me trupin si dhe me pjesën e tokës ku janë përlyer atletet.

Po ashtu nga konstatimi i ekspertit është vërtetuar se gjurmët e gjakut të njeriut në pjesën e poshtme të xhinseve, të gjetura tek i akuzuari A.M. kanë të bëjnë me të ndjerin; ato janë krijuar gjatë përlyerjes së asaj pjese të xhinseve me gjak ose kullosa bari që me siguri janë lyer me gjak; të akuzuarit J. XH. nuk i janë ekzaminuar rrobat dhe në bazë të kësaj mund të konstatohet gjendja në vendngjarje gjatë veprimit të këtij të akuzuari, gjegjësisht gjatë kryerjes së vrasjes.

Po ashtu, nga konstatimi i ekspertit Dr. A. R. gjithsesi vërtetohet se tek i ndjeri I. J. janë konstatuar lëndime në formën e gjakderdhjes me sipërfaqe 7x4 cm në pjesën e djathtë mbi gjurin e djathtë dhe se ky lëndim i të ndjerit, gjegjësisht sipas karakteristikave të tij, është pasojë e goditjes së asaj pjese dhe se është e izoluar nga lëndimet e tjera dhe gjendet në pjesën e brendshme të gjurit të djathtë dhe nuk ka lidhje me lëndimet e tjera dhe se ky lëndim është pasojë e fuqisë së fortë të formës së goditjes në atë pjesë, si kontakt i asaj pjese të trupit me ndonjë send të fortë ose sipërfaqe të fortë dhe se ky lëndim është bërë derisa i ndjeri ishte gjallë dhe akoma kishte qarkullim të gjakut. Këtë lëndim të pjesës së djathtë të gjurit tek i ndjeri, i cili sipas ekspertit është bërë derisa i ndjeri ishte gjallë, si pasojë e veprimit të një force goditëse të fortë, ku nuk përjashtohet as goditja, e vërteton edhe i akuzuari J., se i ndjeri I., para se të privohet nga jeta me pushkë automatike, është sulmuar fizikisht, është tërhequr dhe është goditur me grushte nga tre të akuzuarit. H. i kërkoi të ndjerit që t'ia kthente borxhin prej 20.000 eurosh. Eksperti e konstatoi vendin dhe pozitën e të ndjerit Ismet dhe të akuzuarit Haki, në momentin kur i akuzuari H. ka gjuajtur me pushkë automatike në drejtim të të ndjerit; i

konstatoi edhe rrethanat se më parë të tre kanë filluar ta sulmojnë dhe ta godasin të ndjerin, me ç'rast J. e mbante në një rënë dorë pushkën automatike të cilën mandej ia mori nga dora i akuzuari H. dhe me të njëjtën filloi të gjuajë kah i ndjeri, nga të cilat mandej i ndjeri ka rënë në shpinë; pastaj J. dhe H., duke e kapur për dore, e kanë tërhequr drejt malit. Kjo korrespondon tërësisht me dëshmitë e të akuzuarit Jumni dhe A. dhe me Procesverbalin e këqyrjes së bërë në vendngjarje dhe me Procesverbalin e rikonstruksionit në vendngjarje, sipas tregimit të të akuzuarit J., ngase nga këqyrja në vendngjarje janë konstatuar njolla gjaku të cilat janë shkaktuar gjatë tërheqjes së trupit nga vendi, të cilat shtrihen nga vendi ku kanë qenë gëzhojat drejt malit. Kjo përputhet me vendin të cilin e tregon i akuzuari J. gjatë rikonstruksionit të ngjarjes në vendngjarje ku i ndjeri është privuar nga jeta; mandej, tërheqja drejt malit, nga ai dhe nga i akuzuari H., përputhen edhe me rrethanat se në momentin kur i ndjeri është privuar nga i akuzuari H, ky dhe i ndjeri kanë qenë në pozitë vertikale dhe të kthyer njëri kah tjetri, ballë për ballë. Nga fotografitë e konfiguracionit në vend, ku sipas tregimit të të akuzuarit J. kanë qenë i akuzuari H. dhe i ndjeri I., kur i ndjeri është privuar nga jeta, vërtetohet fakti se i ndjeri ka qenë në pozitë më të ulët në krahasim me të akuzuarin H., për të cilën pozitë tregon eksperti Dr. A. R. dhe se gjatë kësaj, të dy kanë qenë të kthyer ballë për ballë dhe në një distancë të shkurtër.

Nga këqyrja e listave të thirrjeve të dala dhe të hyra drejt numrave të telefonave celularë të të akuzuarve dhe të të ndjerit Ismet Jahja të dorëzuar në operatorin VIP dhe T-Mobil gjithsesi vërtetohen rrethanat se i akuzuari Haki Shabani nga telefoni i tij celular me numër dhe i ndjeri I.J. nga celulari numër më 13.9.2009 dhe 14.9.2009 disa herë kanë bërë biseda telefonike edhe atë me paraqitje të shkurtra nga i akuzuari H. I ndjeri I. i është paraqitur gjë që korrespondon me deklaratën e dëshmitares D.J. se i ndjeri i është paraqitur të akuzuarit H. për shkak që të mos harxhohet i akuzuari H. se nuk kishte para për thirrje. Nga thirrjet telefonike të të akuzuari H. dhe nga telefoni celular i të ndjerit I.J. është vërtetuar se më 13.9.2009 në periudhën kohore prej 11:48:53 e deri më 17:16:30, i akuzuari H. dhe i ndjeri I. kanë biseduar dhe se më 14.9.2009 i akuzuari H. dhe i ndjeri I. kanë pasur kontakte përmes telefonit celular në orën 20:15:44 dhe në orën 20:15: 45 dhe se bisedën e fundit i akuzuari H. me të ndjerin Ismet e ka bërë me telefonin e tij me numër..... në orën 20:15:45, kohë që përputhet me kohën të cilën e potencon dëshmitarja D.J. kur i ndjeri dhe i akuzuari H kanë biseduar që të takohen para Shkollës së muzikës në kohën pas "iftarit" dhe në kohën kur për herë të fundit është takuar i ndjeri me vllahun e tij para se të shkojë në xhami.

Po ashtu është vërtetuar se i akuzuari H. ka bërë bisedë me të ndjerin I. më 19:49:18 min. nga telefoni celular i A., ashtu siç thekson edhe vetë i akuzuari H. nga OH “Amazon” për shkak se kinse nuk kishte kredit në telefonin e vet. Por, një konstatim i këtillë për mungesë të kreditit të telefonit, mohohet tërësisht nga biseda telefonike, që kishte bërë i akuzuari H. me telefonin e tij me të ndjerin I. në orën 20:15:14. Se i akuzuari H. dy herë kishte biseduar me të ndjerin I. i cili gjendej në shtëpi në kohën e iftarit është vërtetuar edhe nga deklarata e dëshmitares D.J.

Gjatë këqyrjes së thirrjeve të shkuara dhe të ardhura të telefonit celular - pronë e të akuzuarit A.M. me numër ,..... ndaj të akuzuarit J.XH. me numër në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet se A. me të akuzuarin J. kanë bërë vetëm një bisedë telefonike më 14.9.2009 në orën 17:47:53, gjegjësisht para se të takohen në OH “Amazon” para fillimit të darkës së ramazanit – iftarit gjë që në mënyrë të plotë korrespondon me mbrojtjen e të akuzuarit J. se ai është thirrur nga A që të vijë në OH “Amazon” ku A ndodhej me të akuzuarin H dhe këtu që të tre bashkë kanë ngrënë darkë. Se i akuzuari Haki dhe i akuzuari A. kanë komunikuar më 14.9.2009 në kohën kur i akuzuari A. ishte me punë në Shkup dhe kur u morën vesh për t’u takuar në Tetovë që të qerasen, ashtu siç thekson i akuzuari A., është vërtetuar nga thirrjet hyrëse-dalëse nëpërmjet telefonit celular me numër nga i akuzuari A. dhe me numër nga i akuzuari H. Pra, kontakti i fundit mes A dhe H për t’u takuar në Tetovë është bërë në orën 16:41:03 nga Tetova dhe kjo korrespondon edhe me kohën që e thekson i akuzuari A. kur u kthye nga puna në Shkup dhe kur është dëgjuar në telefon me të akuzuarin H. për t’u takuar në OH “Amazon”.

I akuzuari J kur është kthyer nga f. Xhermë e ka marrë pushkën nga stalla e të akuzuarit H. dhe me veturën e vet është kthyer dhe e ka pritur A. te “Livadhet e Jonuzit”. Këtu ka arritur i akuzuari Haki me veturën me ngjyrë të kuqe me një person të cilin nuk e njihnin ata. I akuzuari J., para se t’ia merrte i akuzuari H. Pushkën, atë e mbante në duar, kurse nga vetura dolën i akuzuari H. dhe i ndjeri I. I akuzuari H. filloi që ta sulmojë të ndjerin në mënyrë verbale kinse ai i ka borxh para dhe se duhet t’ia kthejë borxhin prej 20.000 eurosh dhe filloi që ta shtyjë dhe ta godas të ndjerin me grushte dhe në këto goditje me grushte ndaj të ndjerit janë bashkuar edhe J dhe A duke besuar se vërtet i ka “borxh” H-së. Pastaj i akuzuari H. ia mori nga duart pushkën J-së dhe nga një distancë e vogël ka gjuajtur në drejtim të të ndjerit I. me të cilin ishin ballë për ballë, gjë që vërtetohet nga mbrojtja e dhënë e të akuzuarve J dhe A, e cila mbrojtje në mënyrë të plotë korrespondon me provat e analizuara.

Fakti që të akuzuarit A dhe J ia kanë sjellë pushkën të akuzuarit J ngase ai u ka thënë se dëshiron ta shesë sepse nuk ka para dhe se pushka ka qenë e fshehur në stallën e të akuzuarit H dhe se stalla ka qenë rreth 30 m larg shtëpisë së të akuzuarit H dhe se pushka ka qenë e mbuluar me bar, është vërtetuar nga deklarata e të akuzuarit J dhe se largësia e stallës vërtetohet edhe nga deklarata e të akuzuarit H në seancën kryesore.

Po ashtu, nga deklarata e J, në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet fakti se gjatë rrugës për në f. Xhermë të akuzuarit A dhe H kanë biseduar në telefon dhe gjatë kësaj i akuzuari A e porositi Hakiun që ta sjellë pushkën e cila gjendej e fshehur në stallë për shkak se ai nuk mund ta bënte një gjë të tillë me arsyen se nuk kishte marrëdhënie të mira me vëllezërit e vet dhe nuk mund të shkonte në shtëpinë e tij e cila gjë korrespondon me bisedat telefonike të zhvilluara në orën 20:28:27 nga Tetova në mes A dhe H, kohë që përputhet me kohën kur i akuzuari J dhe A, pas darkës janë drejtuar për në f. Xhermë para kohës që i ndjeri Ismet është privuar nga jeta. Rrethanat lidhur me personalitetin e të akuzuarve janë vërtetuar nga të dhënat e tyre gjenerale në certifikatën EN nga e cila vërtetohet se të akuzuarit deri tani kanë qenë të padënuar. Duke u bazuar në provat e dhëna është vërtetuar gjendja faktike. Trupi gjykues në mënyrë bindëse konstatoi se veprimet e të akuzuarit H. Sh. përmbajnë elemente të veprës penale VRASJE sipas nenit 123 paragrafi 2 pika 1, lidhur me nenin 22 të KP, se në veprimet e të akuzuarve J. Xh. dhe A. M. ka elemente të veprës penale vrasje sipas nenit 123 paragrafi 1, lidhur me nenin 22 të KP, se i akuzuari H.Sh. më 14.9.2009 rreth orës 21 në f. Xhermë, me të akuzuarit J. dhe A. si bashkëkryerës me paramendim në mënyrë tinëzore e kanë privuar nga jeta personin I. J. nga Tetova, mosha 58 vjeç. në atë mënyrë pasi që më parë në OH “Amazon” në Tetovë i akuzuari Haki me telefon celular i është paraqitur të ndjerit, e ka lutur që ta presë para Shkollës së muzikës në Tetovë për të shkuar në f. Xhermë ku do t’ia paguante qiranë e banesës për dy muaj. Kësaj, i njëjti i ka besuar dhe ka ardhur në vendin e caktuar ku i akuzuari H erdhi me veturë të tipit “Daewoo Reiser” me targa TE-677-BL. Kur hyri në veturë, u drejtuan drejt f. Xhermë, kur arritën te “Livadhet e Jonuzit” aty e prisnin të akuzuarit A dhe J të cilët e kishin sjellë pushkën automatike të tipit 56 kal 7,62x39 mm me Nr prodhues 14185309 e prodhimit kinez. I akuzuari H e ndali veturën para tyre dhe nga i ndjeri kërkoi që të dalë jashtë veturës me ç’rast tre të akuzuarit filluan ta sulmojnë fizikisht duke e goditur me grushte në pjesën e trupit. Gjatë kësaj, i akuzuari Haki ia mori pushkën të akuzuarit J. dhe e repetoi duke gjuajtur nëntë plumba në drejtim të tij, duke i shkaktuar katër plagë shpuese në pjesën e kokës dhe tri plagë shpuese në pjesën e gjoksit, në anën e majtë dhe dy plagë tangjente në hundë nga ana e djathtë si dhe gjakderdhje me sipërfaqe prej 7x4 cm në pjesën e përparme mbi gju nga të

cilat i dëmtuari vdiq në vendngjarje, kështu që të akuzuarit J dhe H e tërhoqën trupin e të ndjerit zvarrë në largësi prej 10,5 m në drejtim të malit ku e lanë aty dhe kaluan në arrati. Për shkak të kësaj, Trupi gjykues të akuzuarin H. Sh. e shpalli fajtor për vepër penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 1, lidhur me nenin 22 të KP, edhe të akuzuarit J. Xh. dhe A. M. i shpalli fajtorë për vepër penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 1, lidhur me nenin 22 të KP.

Trupi gjykues provave të nxjerra u kushtoi besim të plotë duke marrë parasysh faktin se të njëjtët janë të qarta, plotësohen me njëri-tjetrin dhe formojnë një tërësi të plotë, kështu që mund të vërtetohen të gjitha faktet dhe dinamika në lidhje me vendin, mënyrën dhe kohën e kryerjes së veprës penale.

Nga provat e nxjerra u vërtetua se i akuzuari i parë H. Sh. më 14.9.2009 rreth orës 21 me paramendim dhe në mënyrë tinëzare, me pushkë automatike e ka privuar nga jeta të ndjerin I. J. nga Tetova dhe se është kryerës direkt i veprës penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 1, lidhur me nenin 22 të KP, me të akuzuarit J. Xh. dhe A. M. si bashkëkryerës, kështu që:

Në mënyrë të pakontestueshme u vërtetua se i akuzuari H. Sh. e ka shfrytëzuar me qira banesën e të ndjeri Ismet në bllok 82 Tetovë dhe si i ka pasur borxh të ndjerit I. qira për dy muaj. Nuk kontestohet se i akuzuari H. ka qenë ai që më 14.9.2009, pas iftarit e ka thirrur të ndjerin Ismet që të vijë te Shkolla e muzikës në Tetovë që t'ia paguajë qiranë për banesë për dy muaj dhe se me këtë e ka bindur të ndjerin I. që të vijë te Shkolla e muzikës. Se kjo është e saktë, u vërtetua nga dëshmitarja D..J. dhe I. J. dhe nga lista e thirrjeve telefonike të bëra me të ndjerin më 13.9.2009 dhe më 14.9.2009.

Nuk kontestohet se i akuzuari H. ka qenë ai që e ka bindur të ndjerin I. të futet në veturën e tij “Daewoo Reiser” dhe mandej me veturë të nisen drejt f. Xhermë me premtimin se atje do t'ia paguajë qiranë dhe se i ndjeri aspak nuk ka dyshuar tek i akuzuari H. se diçka do t'i ndodhë. Me ardhjen e të ndjerit Ismet te Shkolla e muzikës dhe futjen në veturë bashkë me të akuzuarin H. dhe udhëtimin me të, drejt f. Xhermë, duket qartë se i ndjeri I. ka pasur besim tek i akuzuari H. dhe se aspak nuk ka dyshuar në qëllimet e fshehta dhe në sjelljen lajthitëse të të akuzuarit H. Se kjo është e saktë, vërtetohet nga deklaratat e të akuzuarve J dhe A të cilët kësaj radhe, në një farë mënyre janë edhe dëshmitarë të ngjarjes. Është vërtetuar edhe fakti se i ndjeri ka dalë nga shtëpia që të takohet me të akuzuarin H. në Tetovë te Shkolla e muzikës, ashtu siç ishin marrë vesh paraprakisht, e që pas takimit me të akuzuarin H. të gjendet në vendin kritik ku është privuar nga jeta dhe ku është gjetur trupi i pajetë

Nuk kontestohet se i akuzuari H ka kërkuar nga të akuzuarit A dhe J t'ia sjellin pushkën automatike te vendi "Livadhet e Jonuzit" që gjendet pranë rrugës në f. Xhermë, me premtimin se do ta shesë, ngase nuk ka para dhe se të akuzuarit A dhe J i kanë besuar kësaj dhe ia kanë sjellë pushkën automatike te "Livadhet e Jonuzit" dhe aty i akuzuari Haki është ndalur me veturën e tij dhe bashkë me të ndjerin I. kanë dalë nga vetura.

Nuk kontestohet se i akuzuari H., pasi i ndjeri I. ka dalë nga vetura, ka filluar që ta shajë dhe t'i bërtasë duke inskenuar se duhet t'i kthejë borxhin prej 20.000 eurosh dhe se ka filluar ta godasë me grushte, se të akuzuarit J dhe A, duke i besuar se i ndjeri I. i ka borxh të akuzuarit H. edhe ata kanë nisur ta godasin me grushte të ndjerin që t'ia kthejë borxhin Hakiut dhe se gjatë kësaj i akuzuari J. në njërin dorë e ka mbajtur pushkën automatike, se nga dora pushkën ia ka marrë i akuzuari H., se e ka repetirë, se i akuzuari H. me pushkën ka krisur drejt të ndjerit Ismet dhe se i akuzuari H. ka qenë ai që e ka privuar nga jeta të ndjerin I. Se kjo është kështu, del edhe nga mbrojtja e të akuzuarve A dhe J e cila korrespondon edhe me ekspertizën e rrobave të cilat i kishte të veshura i akuzuari H. dhe me konstatimin e ekspertit Dr. A. R. dhe rikonstruktimin e bërë që përputhet me përshkrimin e ngjarjes sipas rëfimit të të akuzuarit J dhe ekspertizës së bërë nga Dr. A. R. për pozitën në të cilën janë gjetur i dëmtuari dhe i akuzuari H. kur H. ka krisur drejt të ndjerit.

Nga kjo që u tha më sipër, vërtetohet se i akuzuari H. ka qenë ai i cili në një mënyrë tinëzore dhe dinake e ka mashtruar të ndjerin Ismet që të takohen te Shkolla e muzikës dhe së bashku të nisen për në f. Xhermë, me mashtrimin se do t'ia paguajë qiranë në f. Xhermë. E ka sjellë të ndjerin deri te vendi i quajtur "Livadhet e Jonuzit" dhe të ndjerin, në një situatë të papritur, e ka privuar nga jeta, pa pasur mundësi që i dëmtuari I. të tentojë të mbrohet.

Vrasje tinëzore është ajo që kryhet fshehurazi, nga pusia ose kur me përdorim të gënjeshtres arrihet deri te viktima ose te mjeti i cili mundëson që vepra penale të mbetet e pazbuluar. Element qenësor për këtë lloj vepre penale është që personi i sulmuar të mos ketë mundësi t'i vërejë veprimet ose mjetet me të cilat dëshirohet të kryhet vepra penale. Këto elemente përfshihen në veprimet të cilat i ka ndërmarrë i akuzuari H.SH.

Nëse me të vërtetë i akuzuari H. ka dashur t'ia paguajë qiranë të ndjerit, ai ka pasur mundësi atë ta bëjë në Tetovë ku ai jeton dhe çdo ditë ka mundur të dëgjohet me telefon ose të takohet me të ndjerin, pa e dërguar të ndjerin në f. Xhermë madje në orët e mbrëmjes, nëpër një rrugë që nuk është e ndriçuar dhe të çon kah fshati malor dhe në kushte kur i ndjeri nuk insiston që t'i paguhet qiraja. Edhe po qe se pranohet mbrojtja e tij se ka dashur të huazojë para

nga i akuzuari A, gjë të cilën me asgjë nuk e mbështeti, ai paratë ka mundur t'i huazojë dhe t'ia sjellë të ndjerit, sepse ai e ka shfrytëzuar banesën me qira dhe ka qenë i obliguar ta paguajë qiranë. Nga provat u vërtetua se i akuzuari H.SH. është ai i cili me veprimet e veta e ka realizuar qenësinë e veprës penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 2 pika 1, sepse kur e ka marrë dhe me pushkë automatike ka gjuajtur ndaj të ndjerit, ka qenë i vetëdijshëm për veprimin e tij, për kundërligjshmërinë dhe pasojën e tij, e ka dashur pasojën dhe është pajtuar me ndodhjen e së njëjtës. Në mes të veprimit të të akuzuarit H.SH. dhe pasojës, ekziston kauzalitet, përkatësisht lidhshmëria shkak-pasoj është elementi bazë për ekzistimin e veprës penale.

Nga provat e nxjerra lidhur me të akuzuarit J.XH. dhe A.M., Trupi gjykues gjeti se në veprimet e tyre ka elemente të veprës penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 1, lidhur me nenin 22 të KP, përkatësisht se në veprimet e të dy të akuzuarve ka elemente të bashkëveprimit në kryerjen e veprës penale, sepse me veprimet e tyre, kur ia kanë sjellë pushkën automatike të akuzuarit H. në vendin e ngjarjes, si bashkëveprues sipas nenit 22 paragrafi 1 të KP, kanë dhënë kontribut cilësor për kryerjen e veprës penale **vrasje** të kryer nga i akuzuari H.SH., pa marrë parasysh se veprimet e tyre nuk e kanë përfshirë qenësinë e veprës penale **vrasje**, siç është caktuar në KP, përkatësisht se këta dy të akuzuar nuk e kanë privuar nga jeta tash të ndjerin I.J., sepse ata me veprimet e tyre i kanë krijuar kushtet për kryerje të veprës penale dhe me këtë kanë dhënë kontribut të veçantë për kryerjen e veprës penale, kështu që lidhur me ta, Trupi gjykues ka bërë rikualifikimin e veprës penale, nga vepra penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 2 pika 1, lidhur me nenin 22 të KP në vepër penale **vrasje sipas nenit 123 paragrafi 1, lidhur me nenin 22 të KP**, pa e cenuar identitetin objektiv dhe subjektiv të të akuzuarit. Kjo, për arsye se kontributi i veçantë rrjedh nga situata e dhënë dhe nga ajo varet kryerja e veprës penale dhe është e natyrës së tillë që pa të nuk do të mund të kryhej vepra penale.

Akti që i akuzuari H ka kërkuar nga të akuzuarit J dhe A që t'ia sjellin pushkën në vendin e caktuar sepse ka dashur që ta shesë, nuk do të thotë se ata është dashur ta bëjnë këtë. Ata kanë mundur ta refuzojnë dhe të mos ia sjellin pushkën në vendin e caktuar, ndërsa të kishin vepruar në këtë mënyrë nuk do të krijonin kushte që të privohet nga jeta i ndjeri Ismeti.

Trupi gjykues rikualifikimin e veprës penale në raport me të akuzuarit J.Xh. dhe A.M. nga vepra penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 2 pika 1 lidhur me nenin 22 të KP në vepër penale **vrasje sipas nenit 123 paragrafi 1 lidhur me nenin 22 të KP**, e bëri edhe për shkak të faktit se nga provat e nxjerra nuk mund të vërtetohet ekzistimi i marrëveshjes në ndërmjet këtyre dy të akuzuarve dhe të akuzuarit H., që ta privojnë nga jeta të ndjerin I., ashtu si ngarkohen me aktakuzën.

Me fjalë të tjera, me aktakuzë, të akuzuarit A dhe J ngarkohen se me të akuzuarin H.Sh. janë marrë vesh që ta privojnë nga jeta tash të ndjerin I.J. Por, në rastin konkret në aktakuzë, përveç asaj që është theksuar se “janë marrë vesh që ta privojnë nga jeta të ndjerin” nuk theksohen as prova e as fakte të tjera nga të cilat do të rezultonte se ekziston një marrëveshje e tillë. Në aktakuzë nuk është theksuar në çfarë mënyre janë marrë vesh, kur janë marrë vesh dhe si janë marrë vesh që ta privojnë nga jeta të ndjerin e as është theksuar sipas “marrëveshjes së bërë” se cili nga të akuzuarit do ta ndërmarrë veprimin për privimin nga jeta të të ndjerit, nëse bëhet fjalë për privim të tij me armë zjarri edhe atë me pushkë automatike, përkatësisht nuk u vërtetua nëse ka ekzistuar marrëveshje e fortë me plan të saktë paraprak, të përgatitur mes të tre të akuzuarve gjë që është esenciale për ekzistimin e një marrëveshjeje për kryerje të një veprë penale, me të cilin plan paraprakisht do merreshin vesh dhe do të caktoheshin detyrat e çdonjërit prej të akuzuarve për kryerjen e veprës penale. Njëkohësisht, te të akuzuarit J dhe A, që të ekzistojë marrëveshje për ta privuar nga jeta të ndjerin, duhet të vërtetohet nëse ka ekzistuar vendim fortë, ndërgjegje dhe dëshirë që të privohet nga jeta tash i ndjeri I. dhe në bazë të kësaj të vërtetohet cili do të jetë roli i tyre në gjithë këtë.

Nga provat e nxjerra si dhe nga përshkrimi në aktakuzë, Trupi gjykues nuk mund të vërtetojë se paraprakisht është bërë plan me role dhe veprime të caktuara që më parë të cilat duhet t’i ndërmarrin të akuzuarit A dhe J bashkë me të akuzuarin H që të privohet nga jeta i ndjeri I. dhe as që mund të vërtetohet se te të akuzuarit A dhe J ka ekzistuar dëshira që i ndjeri I të privohet nga jeta, duke pasur parasysh se në aktakuzë theksohet se që të tre janë marrë vesh që ta privojnë nga jeta të ndjerin I.J. dhe asgjë më shumë, por gjeti se në veprimet e të akuzuarve J. Xh. dhe A.M. ka elemente për bashkëveprim sipas dispozitave të nenit 22 paragrafi 1 të KP, sepse të dy të akuzuarit me faktin se në vendin kritik ia kanë sjellë pushkën automatike të akuzuarit H., kanë dhënë kontribut të veçantë për kryerje të veprës penale **vrasje**, i cili kontribut është i cilësisë së tillë që nuk e amnistion përgjegjësinë penale të tyre, pa marrë parasysh faktin se gjatë sjelljes së pushkës, kanë menduar se është për shitje, sepse përsëri bëhet fjalë për pushkë zjarri të cilën të akuzuarit J dhe A nuk kanë guxuar t’ia sjellin të akuzuarit H. dhe për të cilën të dy kanë qenë të vetëdijshëm dhe e kanë ditur se ajo armë, si e tillë, përveç se të shitet, ka mundur të përdoret edhe për kryerje të veprave të tjera penale.

Nga provat nuk është e kontestueshme se të tre të akuzuarit më datë 14.09.2009, gjatë kohës së iftarit janë takuar në OH “Amazon” në Tetovë dhe se atje kanë ngrënë darkë, por nga provat nuk rrjedh se takimi në OH “Amazon” është për marrëveshje që të privohet nga jeta i ndjeri I. dhe në rrethana të tilla thëniet në aktakuzë janë supozime, ndërsa supozimi ose

dyshimi nuk është provë nga e cila mund të vërtetohet ndonjë fakt për ekzistimin e veprës penale dhe të bazohet aktgjykimi dhe për këtë, Trupi gjykues marrëveshjen nuk e përfshiu në dispozitivin e aktgjykimit. Nuk mund të pranohet as mbrojtja e të akuzuarit H, e cila me asgjë nuk vërtetohet, se i akuzuari A i ka ofruar para hua të akuzuarit H. për ta paguar qiranë dhe se paratë do t'ia jepte në f. Xhermë. I akuzuari H po qese nuk ka pasur qëllim që ta privojë nga jeta të ndjerin I., nuk ka pasur arsye që ta çojë të ndjerin në f. Xhermë. I akuzuari H ka mundur të shkojë vetë në f. Xhermë, t'i marrë A-së para hua, të kthehet dhe t'ia sjellë të ndjerit në Tetovë, sepse i akuzuari H edhe ashtu ka jetuar në Tetovë. I qartë ka qenë qëllimi i të akuzuarit H për mashtrim që të futet në veturë i ndjeri dhe ta sjell në lajthitje se paratë do t'ia japë në f. Xhermë, me qëllim që ta sjellë në atë gjendje që të mos dyshojë në qëllimin e tij, ndërsa në vendin ku e ka sjellë të ndjerin, të mos mund të mbrohet. I akuzuari H, me të njëjtën mënyrë, me mashtrim, duke i shfrytëzuar marrëdhëniet fqinjësore me të akuzuarit A dhe J ka krijuar kushte që t'ia sjellin pushkën automatike në vendin për të cilin janë marrë vesh që ta realizojë qëllimin e tij, duke u thënë se kinse nuk ka para dhe se patjetër duhet ta shesë atë.

Në këtë kontekst, është logjikshme mbrojtja e të akuzuarve A dhe J se i akuzuari H, për shkak se nuk ka qenë në marrëdhënie të mira me familjen, nuk ka mundur të vijë personalisht dhe ta marrë pushkën nga stalla, e për këtë arsye ka kërkuar prej këtyre dyve t'ia sjellin pushkën, sepse në të kundërtën, sikur vetë të vinte në stallë, ka ekzistuar rreziku të shihet nga familja; për këtë arsye të akuzuarit A dhe J janë pajtuar t'ia marrin pushkën nga stalla dhe t'ia dërgojnë në vendin e quajtur "Livadhet e Jonuzit" afër f. Xhermë.

Lidhur me veprën penale *përpunim, armëmbajtje dhe trafikim të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyes* sipas nenit 396 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KP, Trupi gjykues, të akuzuarin J.Xh., në pajtim me nenin 368 pika 1 të LPP e liroi nga aktakuza për të cilën veprë penale ngarkohet i akuzuari Jumni, se të njëjtën ditë, më datë 14.09.2009 kur është privuar nga jeta i ndjeri I.J., në bodrumin e shtëpisë së tij në f. Xhermë, në mënyrë të palejuar ka mbajtur armë zjarri - pushkë automatike të tipit 56 kal. 7,62x39 mm me Nr. fabrike 14185309, prodhim kinez, me kondak druri, e cila u është e ndaluar qytetarëve dhe e cila është përdorur gjatë privimit nga jeta të personit I.J. dhe se pas bastisjes më datë 15.09.2009 në shtëpinë e tij, është gjetur dhe është sekuestruar kondaku prej druri me ngjyrë kafeje e të njëjtës pushkë automatike dhe një plumb i kal. 7,62x54 mm për pushkë luftarake dhe mitraloz; në rastin konkret, pushka automatike paraqet mjet me të cilin është kryer vepra penale **vrasje** dhe pikërisht sjellja e pushkës automatike nga të akuzuarit A dhe J në vendin kritik e përfshin bashkëveprimin e tyre në lidhje me kryerjen e veprës penale **vrasje** për të cilën janë shpallur fajtorë sipas nenit 123

paragrafi 1 lidhur me nenin 22 të KP dhe me këtë rast, gjatë përshkrimit të veprës penale, rrjedh se bëhet fjalë për bashkëveprim të fshehtë në vepër penale **vrasje** dhe vepër penale **përpunim, armëmbajtje dhe trafikim të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyes** dhe se vepra penale *përpunim, armëmbajtje dhe trafikim të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyes* është përfshirë në veprën penale **vrasje** sipas nenit 123 paragrafi 1 lidhur me nenin 22 të KP, kështu që sa i përket objektit mbrojtës dhe në raport me dënimin, në rastin konkret nuk ekziston subsidialiteti “i armëmbajtjes pa leje” me të cilën armë është kryer vepra penale “vrasje”. Më tej, në shtëpinë e të akuzuarit J. Xh. se është gjetur pushka automatike - as në shtëpinë e tij në f. Xhermë, prej tij nuk është marrë pushka automatike që të ekzistojë mbajtja pa leje e armës së zjarrit, por pushka automatike si mjet me të cilin është kryer vepra penale vrasje, është sekuestruar prej tij në SPB Tetovë.

Lidhur me plumbin kal. 7,62x54P mm i cili gjithashtu i ngarkohet të akuzuarit J.Xh. se në dhomën e tij në f. Xhermë në mënyrë të palejuar e ka mbajtur në formë të municionit që për qytetarët është e ndaluar, Trupi gjykues gjeti se vetë fakti se plumbi është gjetur në shtëpinë e të akuzuarit J. në një kuti për bizhuteri dhe imtësi të tjera dhe është marrë nga gjyshi i tij K. Xh. dhe jo nga i akuzuari J., edhe atë në shtëpinë ku jeton familja me shumë anëtarë, tregon se tek i akuzuari J.Xh. nuk ka elemente për mbajtje të plumbit me të cilin do ta konsumonte esencën e veprës penale *përpunim, armëmbajtje dhe trafikim të palejuar me armë ose me lëndë shpërthyes* sipas nenit 396 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KP për të cilën ngarkohet.

Trupi gjykues e studioi mbrojtjen e të akuzuarit H.SH. se nuk e ka privuar nga jeta të ndjerin I, por se mbi të ndjerin ka gjuajtur i akuzuari J. me pushkë automatike dhe se pushka automatike është sekuestruar nga i akuzuari J. Megjithatë, mbrojtjen e tillë Trupi gjykues e refuzoi si të pabazë dhe gjeti se është dhënë me qëllim që t'i ikë ose t'i zvogëlohet përgjegjësia penale dhe mbrojtja e tillë është kontradiktore me provat e nxjerra dhe njëkohësisht e pranoi mbrojtjen e të akuzuarve A.M. dhe J. Xh. në rrethanën se ata dy nuk kanë pasur marrëveshje me të akuzuarin H. që ta privojnë nga jeta të ndjerin dhe se i akuzuari H. ka qenë ai i cili e ka privuar nga jeta të ndjerin I. me gjuajtur nga pushka automatike e cila ka qenë e të akuzuarit H., ndërsa të akuzuarit A dhe J ia kanë sjellë të akuzuarit H. në vendin e quajtur “Livadhet e Jonuzit” me kërkesë të akuzuarit H. kinse për shitje, pa pasur dijeni për qëllimin e të akuzuarit H se me të njëjtën do të privohet nga jeta i ndjeri I. të cilin i akuzuari A dhe J aspak më parë nuk e kanë njohur, asnjëherë nuk e kanë takuar dhe nuk kanë pasur asnjë mosmarrëveshje apo diçka të ngjashme.

Domethënë, nga provat nuk është e kontestueshme se i akuzuari H, nga fillimi është shërbyer me mashtrime, edhe atë herën e parë kur e ka vënë në lajthitje të ndjerin I. se nuk ka shtëpi dhe se shtëpinë ia ka rrënuar lumi në f. Xhermë, me qëllim që ta zvogëlojë lartësinë e qirasë, herën e dytë kur e ka thirrur të ndjerin I. te Shkolla e muzikës që t'ia paguajë qiranë, ndërsa herën e tretë kur e ka gënjyer dëshmitarin I. se pas takimit të Shkolla e muzikës, i ndjeri I. ka shkuar në shtëpi, edhe pse e ka ditur se i ndjeri ka qenë i vvarë.

Më tej, mbrojtja e të akuzuarit H. Lidhur me faktit se i ndjeri ka qenë i rrëzuar kur është gjuajtur mbi të, gjithashtu është në kundërshtim me provat e nxjerra, sepse nga ekspertiza mjeko-ligjore del se në momentin kur është gjuajtur mbi të ndjerin, ai ka qenë në pozitë vertikale, ballë për ballë dhe në largësi prej 70 deri 80 cm nga personi që ka gjuajtur, ndërsa se ka gjuajtur i akuzuari Haki, dëshmojnë provat materiale – gjurmët latente; gjurmët e gjakut janë gjetur në veshjen e të akuzuarit H që e kanë prejardhjen nga plagët hyrëse të të ndjerit.

I akuzuari H ka qenë ai i cili ka pasur biseda telefonike intensive me të ndjerin Ismet në datën 13.09.2009 dhe në datën 14.09.2009, kur i ndjeri është privuar nga jeta dhe kontaktin e fundit, i ndjeri para se të dilte nga shtëpia, e ka realizuar pikërisht me akuzuarin H në orën 20:15:45, kohë e cila përputhet me deklaratën e dhënë nga gruaja e të ndjerit – dëshmitarja D.J., nga vëllai i tij I. J. dhe pas asaj thirrjeje, i ndjeri ka dalë nga shtëpia dhe më nuk është kthyer.

Kundërthëniet e këtilla të të akuzuarit H. e vërtetojnë mbrojtjen e të akuzuarve J dhe A sa ata ia kanë sjellë pushkën të akuzuarit H në vendin kritik “Livadhet e Jonuzit” me kërkesë të të akuzuarit H., në të cilin vend i akuzuari H. ka ardhur me të ndjerin dhe se kur ata ia kanë sjellë paraprakisht, i akuzuari J e ka mbajtur në dorën e djathtë, ndërsa i akuzuari H ia ka marrë nga dora dhe përsëri duke u shërbyer me gënjeshtër, ka inskenuar se i ndjeri I. duhet t'ia kthejë borxhin prej 20.000 eurove dhe e ka sulmuar fizikisht të ndjerin, duke e goditur me grusht dhe pastaj, me pushkën automatike ka gjuajtur kah i ndjeri dhe e ka privuar nga jeta. Në favor të kësaj se kjo është kështu, është edhe pjesa e mbrojtjes së të akuzuarve A dhe J se edhe ata e kanë goditur me grusht të ndjerin që ta detyrojnë t'ia kthejë borxhin të akuzuarit H, ndërsa fakti se i ndjeri është goditur me grushte derisa ka qenë i gjallë është vërtetuar nga gjakderdhja nën lëkurë mbi gjurin e djathtë nga ana e brendshme e të ndjerit, të ekzaminuar nga eksperti Dr. A. R. i cili në mënyrë profesionale shpjegoi se janë shkaktuar duke qenë gjallë.

Këtë fakt për sulm fizik ndaj të ndjerit i akuzuari H aspak nuk e përmend në mbrojtjen e tij, ndërsa sikur kjo të mos ishte ashtu, nuk ka arsye pse ta përmendin të akuzuarit A dhe J dhe me këtë, në mënyrë plotësuese ta ekspozojnë vetveten në përgjegjësi penale.

Se pas gjuajtjes mbi të ndjerin, i akuzuari H bashkë me të akuzuarin J e kanë tërhequr të ndjerin kah pylli, në mënyrën si e tregon i akuzuari J. në mbrojtjen e tij dhe në rikonstruktimin e rastit në vendin e ngjarjes, vërtetohet edhe nga konstatimi i ekspertit Dr. A. R., në bazë të faktit se gjaku që është detektuar në pantallonat me ngjyrë të zezë të cilat i ka pasur të veshura i akuzuari H. Sh., në të cilat, në pjesën e përparme dhe të pasme të këmbëzës së majtë - janë gjetur gjurmë latente të gjakut; ato kanë mundur të ndodhin edhe nga prekja e shkurtër e gjakut të të ndjerit edhe atë pasi ka qenë i vrarë dhe në momentin kur të ndjerin I. e ka kapur në dorën e tij të majtë, në pozitë të ulur, e cila i përgjigjet pozitës së treguar sesi i akuzuari H. e ka kapur të ndjerin që ta tërheqin dhe ta fshehin në afërsi në pyll dhe se në atë pozicion ka mundur t'i përlyejë pantallonat edhe nga ana e përparme dhe nga ana e pasme, bashkë me pjesën e përparme të atleteve të cilat kanë pasur kontakt të shkurtër me gjakun e të ndjerit nga trupi dhe nga dheu prej ku janë ngjyer atletet.

Se i akuzuari H. pas gjuajtjes ndaj të ndjerit e ka fshirë pushkën dhe pastaj ia ka hedhur në duar të akuzuarit A., sikundër thotë i akuzuari A., vërtetohet edhe me ekspertizën e MPB për mosekzistimin e vijave papilare në pushkë, të cilat sikur të mos fshiheshin, do të mund të gjendeshin pas sekuestrimit të pushkës.

Pohimet e të akuzuarit H. se i akuzuari J. ka gjuajtur, sepse pushka është sekuestruar nga J. dhe se e njëjta ka qenë e J-së, ngase është sekuestruar nga i akuzuari J. më datë 17.09.2009, është vetëm mënyrë për t'i shtrembëruar faktet, sepse me asnjë provë nuk u vërtetua se pushka me të cilën është privuar i ndjeri ka qenë në pronësi të të akuzuarit J, sepse ajo pushkë është sekuestruar në stacionin e policisë dhe jo në shtëpinë e të akuzuarit Jumni; kondaku i cili është sekuestruar nga gjyshi i Jumniut, K. Xh. gjatë bastisjes në shtëpinë familjare në f. Xhermë më datë 15.09.2009, e cila nuk paraqet armë zjarri dhe mjet me të cilin ndokush mund të privohet nga jeta, është gjetur në shtëpinë e Jumniut, pasi ka ndodhur ngjarja dhe kjo është e logjikshme, sepse nga provat nuk është e kontestueshme se pas ngjarjes, të akuzuarit A dhe J kanë shkuar në shtëpi gjë që dëshmohet me faktin se xhinset që i ka pasur të veshura i akuzuari A., i kanë larë dhe janë lënë që të thahen në shtëpinë e tij dhe është e logjikshme që pas ngjarjes, para se të dërgohet në polici pushka, të gjendet te njëri nga të akuzuarit dhe kondaku të jetë lënë në shtëpi. në këtë rast tek i akuzuari J., ndërsa pushka të

dërgohet pa kondak, sepse pa kondak, sipas konstatimit të ekspertit N.M., duket se pushka mund të mbahet më lehtë.

Këtë e vërteton mbrojtja e të akuzuarit Jumni se pushka ka qenë e të akuzuarit H dhe se vullnetarisht është dorëzuar në SPB Tetovë, sepse po qe se do të ishte e të akuzuarit Jumni, duke pasur parasysh faktin se pas ngjarjes të akuzuarit J dhe A janë privuar nga liria më datë 17.09.2009, i akuzuari J ka pasur mundësi gjatë periudhës kohore prej datës 14 deri 17.09.2009 ta fshehtë pushkën ose ta zhdukë dhe aspak të mos gjendet dhe me këtë tërësisht t'i zhdukë provat për çfarëdo involvimi personal në kryerje të veprës penale dhe kështu nuk do të zbulohet as arma – mjete me të cilin është privuar nga jeta i ndjeri Ismet.

Pohimet e të akuzuarit H se ndaj të ndjerit Ismet ka gjuajtur i akuzuari J. Xh. nuk janë të mbështetura me asnjë provë të nxjerrë, sepse për të akuzuarin J. nuk ka asnjë gjurmë materiale të cilat do të çonin në atë drejtim, për dallim nga provat dhe gjurmët materiale të cilat shkojnë në favor të pohimeve të të akuzuarve J. dhe A. se ndaj tash të ndjerit I/ ka gjuajtur i akuzuari H.

Gjatë caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit ndaj tre të akuzuarve, Trupi gjykues i vlerësoi të gjitha rrethanat sipas nenit 29 të KP dhe si rrethana rënduese në raport me të akuzuarin H. Sh. i kishte parasysh mënyrën e kryerjes, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe pasojat nga vepra e kryer penale, me të cilën, në mënyrë tinëzore i është marrë jeta të ndjerit Ismet Jahja, edhe pse i ndjeri me asgjë nuk ka kontribuar dhe as që ka sfiduar që të privohet nga jeta, ndërsa në raport me të akuzuarit J. dhe A., se me veprimet e tyre i kanë krijuar kushtet që i ndjeri Ismet të privohet nga jeta, ndërsa si rrethana lehtësuese gjeti se të akuzuarit, të gjithë janë të rinj, deri tash nuk kanë qenë të dënuar, ndërsa për të akuzuarit A dhe J, se kanë kontribuar në zbulimin e mjetit dhe në mënyrën si është kryer vepra penale dhe se me shqiptimin e këtillë të dënimit me burg prej 20 vjetësh ndaj të akuzuarit H.Sh. dhe nga 5 vjet ndaj të akuzuarve J. Xh. dhe A. M., do të arrihen qëllimet e dënimit si në planin e preventivës gjeneralë, ashtu edhe në atë të preventivës speciale, sipas nenit 32 të KP, gjatë së cilës, në pajtim me nenin 47 të KP, në dënimet e shqiptuara me burg ua llogarit edhe kohën që kanë qëndruar në paraburgim, edhe atë për të akuzuarin H.Sh. nga data 16.09.2009 e më tej, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, ndërsa të akuzuarve J.Xh. dhe A. M. nga data 17.09.2009 deri më datë 15.06.2010 e më tej, duke llogaritur nga data 08.07.2010 kur janë paraqitur në ENP - burgu Tetovë, deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Pasi që Trupi gjykues i shpalli fajtorë, njëkohësisht i obligoi të paguajnë çdonjëri për vete, në emër të paushallit penal shumë prej 3.000 denarë dhe që të tre, në mënyrë solidare t'i kompensojnë shpenzimet reale të procedurës për ekspertizë dhe për shoqërim në shumë prej 43.720,00 denarë, në pajtim me dispozitat e nenit 89, lidhur me nenin 92 të KP dhe njëkohësisht vendosi që arma e zjarrit – pushka automatike me një karikator të sekuestrohet si mjet me të cilin është kryer vepra penale, në pajtim me nenin 100-a paragrafi 2 të KP. Gjithashtu, në pajtim me nenin 532 të LPK të sekuestrohet edhe plumbi i gjetur i kal. 7,62x54 P mm në shtëpinë e familjes së të akuzuarit J. si mjet i cili detyrimisht duhet të sekuestrohet, edhe pse është nxjerrë aktvendim lirues për veprën penale *armëmbajtje, përpunim dhe trafikim të palejuar me armë ose lëndë shpërthyes* sipas nenit 396 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KP. Njëkohësisht, përfaqësuesi ligjor i të ndjerit, gruaja D. J., e përfaqësuar nga i autorizuari i saj avokati O. R. nga Shkupi, në pajtim me deklarinimin e tyre për realizimin e kërkesës pronësore-juridike, i udhëzoi në kontest civil.

Gjykuar në Gjykatën themelore – Tetovë, më datë 15.06.2010 me KNr. 193/10.

Mbajtëse e procesverbalit
GORDANA PETROVSKA d.v.

Kryetar i Këshillit - Gjykatësi
LIDIJA ILIEVSKA d.v.

Udhëzim:

**Kundër këtij aktgjykimi lejohet e drejta për ankesë,
brenda 15 ditëve nga data e pranimit, nëpërmjet kësaj gjykate,
Gjykatës së Apelit Gostivar.**

Dorëzuar:

**PPTH –Tetovë, të akuzuarve: H.SH në ENP burgu Shkup, J.Xh. dhe A.M. në ENP
burgu Tetovë, mbrojtësve - aokatëve E.I. dhe L.K., përfaqësuesit ligjor D.J. dhe të
autorizuarit – avokatit O. R.**

Gjykatësi

Mendimi kritik

Duke u bazuar në aktakuzën me të cilën ngarkohen të akuzuarit, veprat të cilat janë paraparë me KP, gjykata gjatë shqyrtimit të rastit i ka marrë parasysh të gjitha faktet që janë relevante. Përshkrimi i veprës është ashtu siç parasheh KP gjatë zhvillimit të procedurës penale kundër të pandehurve H.SH, J.XH dhe A.M nga fshati Xhermë. Tre të akuzuarit për një veprë penale, VRASJE të parashikuar me nenin 123 paragrafi 1, pika 1, lidhur me nenin 22 të KP, ndërsa i akuzuari J.XH. edhe për veprën penale PËRPUNIM, ARMËMBAJTJE DHE TRAFIKIM TË PALEJUAR ME ARMË OSE LËNDË SHPËRTHYESE të parashikuara me nenin 369 paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 të KP. Mendoj se gjykata nga të gjitha faktet e procedurës, nga pohimi i vetë të pandehurve dhe nga deklaratat e dëshmitarëve i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme. Procedura është zhvilluar duke e respektuar LPP. Po ashtu, në bazë të shqyrtimit të të gjitha rrethanave, ajo ka nxjerrë aktgjykim me të cilin i ka shpallur fajtorë të akuzuarit, H.SH, J.XH dhe A.M, të cilët ngarkohen për tri vepra penale të rënda, duke përfshirë edhe vrasjen. Ata janë shpallur fajtorë pasi gjykata ka vërtetuar se në momentin dhe në ditën kritike ata me vetëdije dhe me paramendim e kanë privuar nga jeta I.J. Gjykata i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e mbrojtjes se të akuzuarit në atë moment kanë qenë pa vetëdije dhe se vepra ka qenë e rastësishme. Të akuzuarit janë ngarkuar edhe për pagimin e shpenzimeve të procedurës penale. Kurse për masën e dënimit gjykata ka vendosur: i akuzuari H.SH, dënim me burg në kohëzgjatje prej 20 viteve, kurse J.XH. dhe A.M - dënim me burg në kohëzgjatje prej nga 5 vite burg. Mendoj se gjykata këtë aktgjykim e ka nxjerrë ashtu siç duhet, duke e respektuar zhvillim e procedurës, të drejtat e palëve, vlerësimin e të gjitha fakteve deri në nxjerrjen e aktgjykimit meritor.

2.6. Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore

Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore ekziston në rastet kur privimi nga jeta i personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjell ndonjë dobi pasurore¹². Vrasja është mjet që të arrihet deri te dobia materiale për vete ose për tjetrin, që shprehet si zmadhim (p.sh. që të arrihet deri te pasuria e viktimës, deri te shpërblimi i premtuar) ose që t'i shmanget zvogëlimit të pasurisë së kryerësit (p.sh. që të mund të lirohet nga borxhi i vet ndaj viktimës).

¹² Kodi penal i RM-së, neni 123, par.2

Vepra ekziston edhe kur kryerësi vetëm presupozon, beson se do ta arrijë dobinë e tillë. Gjithashtu, nuk është e domosdoshme të realizohet fitimi kah i cili ka synuar kryerësi.

2.7. Vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale

Vrasja e tillë ekziston atëherë kur privimi nga jeta i personit tjetër është mjet për realizimin e ndonjë qëllimi tjetër, kryerjen e ndonjë veprë penale apo edhe fshehjen e veprës penale të kryer më herët¹³.

Ajo është karakteristike për të dy situatat. Në të parën (vrasje për shkak të kryerjes së veprës tjetër penale), privimi nga jeta është faza paraprake, veprim përgatitor për kryerjen e cilës do qoftë veprë penale (p.sh. kur dikush e vret rojtarin që më vonë të hyjë në ndërtesë, ose e vret burrin që më vonë ta përdhunojë gruan e tij). Vrasja e kualifikuar ekziston pa marrë parasysh nëse vepra tjetër është kryer në të vërtetë. Situata e dytë ekziston në rastet kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër, me qëllim që të pengojë zbulimin e veprës penale e cila është kryer më parë.

2.8. Vrasja nga hakmarrja e paskrupullt

Nocioni i përgjithshëm i vrasjes nga hakmarrja e paskrupullt asocion në gjakmarrjen. KP nocionin “*i / e paskrupullt*” e ndërlidh vetëm me hakmarrjen¹⁴. Hakmarrja e paskrupullt ka disa elemente të përbashkëta me hakmarrjen dhe gjakmarrjen, por ka edhe disa dallime të rëndësishme të cilat i përkasin vetë personalitetit të kryerësit të vrasjes nga hakmarrja, siç janë më shpesh: arsyeja që është shkak i kësaj forme të hakmarrjes, personi ndaj të cilit është drejtuar kjo vrasje dhe një varg rrethanash të tjera të cilat mund të gjejnë shprehje me rastin e kryerjes së veprës në fjalë.

Në lidhje me personalitetin e kryerësit, sipas mendimit të disa autorëve, nocioni i “*i / e paskrupullt*” te kjo vrasje, në radhë të parë është i lidhur me sjelljet negative të njerëzve.

Është i pranuar qëndrimi se çdo vrasje nga hakmarrja nuk mund të konsiderohet si vrasje nga hakmarrja e paskrupullt. Një vrasje nga hakmarrja e paskrupullt mund të

¹³ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.4

¹⁴ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.6

konsiderohet si e tillë nëse është e drejtuar ndaj ndonjë personi të pafajshëm apo nëse qëllimi i hakmarrjes nuk është në përpjesëtim me të keqen e shkaktuar më parë.

2.9. Vrasja për motive të ulëta

Nocioni “ *motive të ulëta* ” nuk është përcaktuar në ligj, por mund të nxirret nga konteksti i tërë dispozitës dhe nga ajo që i karakterizon motivet e ulëta të sipërpërmendura¹⁵.

Edhe praktika jonë gjyqësore nisët nga qëndrimet dhe pikëpamjet etike, morale dhe sociale siç janë p.sh.: xhelozia, e cila nuk është motiv, por, gjendje specifike shpirtërore e një personi; nga ajo gjendje mund të dalin motive të ulëta që duhet në mënyrë të veçantë të verifikohen.

2.10. Vrasja në bazë të porosisë

Për dallim nga vrasja nga lakmia (përfitimi), kjo vrasje e kualifikuar mund të kryhet edhe për motive të tjera, që nuk do të thotë se synimi i saj çdoherë të jetë arritja e dobisë (përfitimit) pasurore¹⁶. Bëhet fjalë për vrasje të organizuar, në realizimin e së cilës marrin pjesë së paku dy persona: personi që e porosit (porositësi) dhe kryerësi i drejtpërdrejtë.

Përveç vrasjes së paguar, pas kësaj vrasjeje të kualifikuar mund të qëndrojnë edhe motive dhe lidhje të tjera të kryerësit dhe të porositësit, siç mund të jenë lidhjet politike, ekonomike, etj. Porositësi është përgjegjës si nxitës i vrasjes së rëndë.

2.11. Vrasja e gruas shtatzënë

Vrasja e fiton llojin e kualifikuar për shkak të kumulimit të dy veprave penale të shaktuara me marrjen e dy jetëve: të jetës aktuale (të gruas shtatzënë) dhe të jetës së ardhshme (foshnjës). Në fakt, fjala është për të ashtuquajturën “ vrasje e dyfishtë ”, ngase me këtë vepër penale nuk vritet vetëm gruaja shtatzënë, por edhe fëmija i saj i cili ende nuk ka lindur. Paramendimi i kryerësit duhet të përmbajë vetëdijen për karakteristikën e viktimës, për atë se bëhet fjalë për grua shtatzënë¹⁷.

¹⁵ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.7

¹⁶ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.5

¹⁷ Kodi penal i RM-së, neni 123 par.6

Ky lloj i vrasjes do të konsiderohet se ekziston vetëm nëse kryerësi ka ditur se objekti i kësaj vepre penale është gruaja shtatzënë. Nëse dorasi nuk ka ditur se gruaja të cilën e privon nga jeta është shtatzënë, atëherë kryerësi i kësaj vepre do të përgjigjet për vrasje të rëndomtë, apo ndonjë lloj tjetër të vrasjes së rëndë, varësisht nga motivet, rrethanat apo mënyra e kryerjes, e jo për kryerjen e vrasjes së kualifikuar. Te kjo vepër penale nuk ka rëndësi faza e shtatzënisë.

2.12. Vrasje për motive fisnike - eutanazia

Me konceptet filozofike, etike, mjekësore dhe juridike për vdekjen është ndërlidhur ngushtë edhe çështja e eutanazisë. Dhënia e ndihmës në vdekje, “*vdekja e butë*”, përkatësisht “*vdekja e butë dhe e lehtë*” ka të bëjë me situatat e ndryshme: vrasja e personit të sëmurë të pashërueshëm që nuk ka shpëtim dhe është duke vdekur - që t’i zvogëlohen dhimbjet gjatë vdekjes; vdekja nga mëshira e personit që është i sëmurë dhe i pashpresë për t’u shëruar edhe pse nuk vdes - që t’i shkurtohen mundimet dhe të çohet në vdekje të shpejtë dhe pa dhimbje; shkurtimi nga mëshira e një jete të pavlefshme, siç është vrasja e personit të paaftë për jetë.

Ai i cili do ta privojë tjetrin nga jeta për motive fisnike, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet¹⁸.

Në favor të legalizimit të eutanazisë përmenden më shumë argumente. Për shembull, thuhet se është humane që të shkurtohen vuajtjet e njeriut “të dënuar të vdesë”, njeriu ka të drejtë për jetën e vet dhe për zgjedhjen e vdekjes, kur këtë vetë ai nuk mund ta realizojë, atëherë të tjerët mund t’i ndihmojnë në këtë; në fund të fundit, çdo njeri ka të drejtë për vdekje dinjitoze, pa mundim. Përkundër kësaj, nga ana tjetër, theksohen më tepër kundër argumente: mjekësia zhvillohet me një dinamikë të përshpejtuar, ashtu që rastet që deri dje janë shpallur “*si raste të pashpresë*” sot paraqesin sëmundje që shërohen¹⁹. Në Republikën e Maqedonisë eutanazia nuk është e lejuar.

2.13. Vrasja nga pakujdesia

Vrasja nga pakujdesia konsiderohet se është kryer nëse dikush privohet nga jeta për shkak të pakujdesisë së kryerësit të veprës penale²⁰. Vrasja nga pakujdesia paraqet një

¹⁸ Kodi penal i RM-së, neni 124

¹⁹ I. Zejneli, “E drejta penale pjesa e posaçme”, Tetovë 2007, fq. 25

²⁰ Kodi penal i RM-së, neni 126 par.1

rrezikshmëri shoqërore më të vogël në krahasim me vrasjet e kryera me dashje. Konsiderohet si formë më e lehtë e vrasjes vetëm për shkak të formës së fajit me të cilën kryhet²¹.

Te vrasja nga pakujdesia, privimi i ndonjë personi nga jeta manifestohet në mënyrë specifike. Zakonisht, këtu bëhet fjalë për veprime të cilat janë ndërmarrë për qëllim tjetër e jo për qëllim të privimit të ndonjë personi nga jeta.

Subjekti i kryerjes së kësaj vepre penale mund të jetë cilido person që ka arritur moshën e duhur dhe që është i përgjegjshëm. Lidhur me anën subjektive (pakujdesia) nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme.

Sipas K. të RM-së, ai i cili tjetërkujt do t'ia marrë jetën nga pakujdesia, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

²¹ I. Zejneli, Po aty, fq. 27

3. Faktorët objektivë dhe subjektivë që ndikojnë në veprën penale të vrasjes

Sipas mendimit të disa kriminologëve, ndikimin më të madh në paraqitjen e kriminalitetit e kanë faktorët e jashtëm kriminogjenë. Sipas tyre, faktorë të jashtëm ose egzogjenë, përbëjnë kushtet dhe rrethanat determinuese të sjelljes kriminale. Ata ndikojnë drejtpërsëdrejti në paraqitjen e aktiviteteve kriminale në shoqëri. Faktorët e jashtëm ose objektivë janë të shumtë dhe secili ka rëndësinë dhe rolin e vet në paraqitjen e sjelljeve kriminale²².

Nga kërkimet empirike kriminologjike, e sidomos duke marrë parasysh rezultatet e shënimeve dhe të të dhënave statistikore mbi kriminalitetin, në shumë vende vërehet se disa faktorë objektivë apo të jashtëm, kanë një ndikim më të madh se sa faktorët e tjerë.

Kësisoj, si faktorë me ndikim të dukshëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale trajtohen: grupi i faktorëve ekonomiko-shoqërorë, faktorët ideopolitikë, mikrogruporë, sociopatologjikë dhe të tjerë.

Ndër faktorët objektivë të cilët kanë ndikim në paraqitjen e veprës penale të vrasjes në RM do të veçojë: **varfëria, papunësia, migrimi i popullsisë, kushtet e vështira të banimit, konfliktet politike, arsimimi, mjetet e informimit, familja, shkolla dhe mjedisi shkollor.**

3.1. Varfëria

Varfëria, gjithashtu konsiderohet si një faktorë objektiv i kriminalitetit i cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Në literaturën kriminologjike flitet për ndikimin e madh që kanë kushtet e vështira materiale dhe varfëria në paraqitjen e kriminalitetit. Ato janë prezente veçanërisht në kohën e krizave dhe depresioneve ekonomike. Për ndikimin e madh të skamjes dhe të varfërisë në paraqitjen e dukurive negative, ka bërë fjalë edhe filozofi antik Aristoteli i cili ka theksuar se *“varfëria është nëna e kriminimit, ndërsa begatia nënë e amoralitetit”*.

Është e vërtetë e madhe dhe e pakontestueshme se kushtet materiale, e sidomos skamja, ndikojnë fuqishëm në sjelljet dhe në qëndrimet e individëve dhe të grupeve të caktuara. Varfëria dhe skamja mund të ushtrojnë ndikim në sjelljet dhe në qëndrimet e disa individëve,

²² R. Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë 2008 fq. 241

sidomos skamja, ndikojnë fuqishëm në sjelljet dhe në qëndrimet e individëve sidomos te disa individë të cilët edhe ashtu janë zhytur në veprime dhe në sjellje kriminale.²³

Për fat të keq, në Maqedoni një numër i madh i popullsisë jeton në varfëri të skajshme sipas raporteve të disa anketave dhe kjo është fakt shqetësues se pikërisht këta persona mund të përfshihen në krimin e vrasjes.

3.2. Papunësia

Papunësia është e ngjashme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe të kyçjes në punë të njerëzve, e kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Papunësia si dukuri dhe s problem social, veçmas vjen në shprehje gjatë krizave dhe recesioneve ekonomike. Papunësia ndikon në keqësimin e pozitës materiale të individëve dhe të familjeve. Për shkak të pamundësisë së plotësisimit të nevojave elementare për jetesë, të anëtarëve të familjes, për shkak të pamundësisë së shkollimit dhe të mbrojtjes shëndetësore, pason braktisja e shkollës dhe e mësimin, paraqitja e sëmundjeve dhe e sjelljeve kriminale.²⁴

Sipas kriminalistit të njohur francez J. Konstant, papunësia dhe problemet të cilat shfaqen te individët dhe te familjet, i konsideron si faktorë dhe rrethanë që i paraprijnë krimin në shoqëri.

Sipas Ismail Zejnelit, papunësia është tejet prezente në RM në mjediset urbane. Por edhe në ato rurale përqindjet janë të mëdha, kur të kemi parasysh zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit, ku jo të gjitha rajonet janë njësoj të zhvilluara.

Për shkak të papunësisë së madhe, shumë persona duke kërkuar dalje nga varfëria, inkuadrohen në rrjete të ndryshme kriminale, kryejnë vrasje apo edhe vetëvriten.

Sipas disa të dhënave, përqindja e papunësisë në RM në vitet 2012-2016 është si vijon:²⁵

| Viti | Të papunësuar |
|------|---------------|
| 2012 | 37.3% |
| 2013 | 36.0% |
| 2014 | 34.9% |
| 2015 | 33.8% |
| 2016 | 32.2% |

²³ R. Halili, "Kriminologjia", Prishtinë 2008, fq. 247

²⁴ R. Halili, po aty, fq. 249

²⁵ Të dhëna të marra nga Enti Shtetëror për Statistikë

Ndërsa sa i përket moshës së të papunësuarve është si vijon: Në vitin 2012 personat e moshës nga 15-24 vjeç, rezultojnë të papunë 62.6 %, kurse të moshës 25-74 janë 33.7 % të papunë. Në vitin 2006, persona të moshës nga 15-24 vjeç rezultojnë të papunë 59.8 %, kurse të moshës 25-74 janë 32.5 %. Në vitin 2013, persona të moshës nga 15-24 vjeç, rezultojnë të papunë 57.7 %, kurse të moshës 25-74 janë 31.6%. Në vitin 2008, persona të moshës nga 15-24 vjeç, rezultojnë të papunë 56.4 %, kurse të moshës 25-74 janë 30.5 %. Në vitin 2009, persona të moshës nga 15-24 vjeç, rezultojnë të papunë 55.1 %, kurse të moshës 25-74 janë 29.0 %.

Ky fakt është brengosës pasi shumica e të papunëve i takojnë moshës aktive të popullsisë, të cilët nuk janë të inkuadruar në punë dhe të njëjtit është e mundshme të merren me dukurinë e krimit.

3.3. Migrimi i popullsisë

Migrimi i popullsisë fshat-qytet është përcjellë me ndryshime të mëdha, para së gjithash gjatë përpjekjeve që të arrihet standardi jetësor i kushteve të jetës së qytetit për shkak të ndërprerjes së shpejtë të lidhjeve jetësore me fqinjët, me miqtë dhe të lidhjeve të tjera, si dhe heqjes dorë nga ambienti fshatar dhe mënyra fshatare e jetesës. Migruesit shpeshherë nuk janë në gjendje që t'u adaptohen kushteve të reja të jetës, sidomos nuk janë në gjendje që të ndjekin dhe të bashkëveprojnë me ecuritë e reja kulturore, politike, ekonomike dhe të tjera. Si pasojë e gjithë këtyre, paraqitet depresioni emocional dhe urrejtja²⁶.

3.4. Kushtet e vështira të banimit

Kushtet e vështira të banimit si faktorë kriminogjenë, gjithashtu zënë vend të rëndësishëm në trajtimet dhe në kërkimet empirike të etiologjisë kriminale. Problem i banimit, e sidomos mungesa e zgjidhjes përkatëse të çështjes së banimit është i lidhur me procesin e migrimit të popullsisë, me përqendrimin e saj nëpër qendra dhe qytete, me lëvizjet masive prej viseve fshatare drejt viseve urbane dhe industriale. Për shkak të lëvizjeve të mëdha të popullsisë dhe ardhjes stihike nëpër qendra urbane dhe industriale, krijohet situatë e mungesës së hapësirës për banim. Për këtë arsye, shpeshherë, me qëllim të zgjidhjes provizore të problemit

²⁶ I. Zejneli, "Delikuenca e të miturve", Tetovë 2018, fq. 131

të banimit, ndodh që nëpër kuarte dhe në lagjet periferike të këtyre qendrave, të lindin kuarte të ngritura shpejt e shpejt, pa kurrfarë plani urbanistik²⁷.

Gjatë vitit 2010 kanë ndodhur vrasje të tmerrshme në Maqedoni, në të cilat djemtë kishin vrarë baballarët e tyre, kush me sëpatë, kush me çekan, e kush me shufër hekuri. Ekspertët dhe psikologët thonë se faktorë dhe shkaktarë kryesorë për vrasjet e tilla janë krizat që shfaqen te karakteret e disa personave që nuk mund të ballafaqohen me realitetin. Mediat dhe gazetat për çdo ditë raportojnë dhe botojnë artikuj me tituj si: “Babai vret djalin narkoman”, “Nëna mbyti fëmijën e sapolindur”, “Vrau vëllain” etj. Psikologu Lulzim Murtezani, për agjencinë e lajmeve INA thotë: “Në kohëra të vështira si p.sh. koha e krizës ekonomike, e papunësisë dhe e varfërisë së skajshme, e mosfunksionimit të institucioneve shtetërore, edhe njerëzit e mirë i manifestojnë veset e tyre të këqija. Me fjalë të tjera, lehtë mund të devijojnë në sjelljet e tyre duke shkaktuar pasoja të rënda në shoqëri. Të gjitha këto rrethana ndikojnë që për arsye banale disa të rinj, por edhe njerëz të moshave të rritura të kenë nivel të ulët të tolerancës, të shpërthejnë emocionalisht, të humbin rezonin dhe të lëndojnë, të plagosin dhe të vrasin njerëz të cilët mund të jenë të afërm të tyre por dhe të tjerë të cilët i konsiderojnë si armiq, qoftë koleg të punës, të përkatësisë tjetër nacionale, partiake, religjioze”.

Punëtorët socialë shpjegojnë se në këto raste kemi të bëjmë me gërshetim të një morie dhe të sërë faktorësh që ndikojnë te një individ të jetë destruktiv, të shkrepë revolen apo këmbëzën e revoles, duke plagosur ose duke vrarë të tjerët dhe ndonjëherë ndodh që gjithë këtë energji negative ta drejtojë ndaj vetes duke bërë vetëvrasje. Edhe ekspertët e sociologjisë vlerësojnë se individit i cili është me prirje agresive, shpesh i ngushtohet vetëdija dhe nuk arrin t'i kontrollojë sjelljet. Ky tip i njeriut, së pari vepron e pastaj mendon, ndryshe nga njerëzit e tjerë që e bëjnë të kundërtën. Përveç kushteve të brendshme, në këtë fenomen të vrasjeve ndikon pa dyshim mjedisi i papërshtatshëm social, ekonomik dhe politik²⁸.

3.5. Konfliktet politike

Konfliktet politike, në literaturën bashkëkohore kriminologjike, trajtohen si faktorë të rëndësishëm kriminogjenë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në paraqitjen e disa sjelljeve kriminale në shoqëri. Bota bashkëkohore, fatkeqësisht, ballafaqohet me një varg krizash dhe tronditjesh politike. Këto konflikte dhe kundërthënie, në dekadat e fundit në disa

²⁷ R. Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë 2008, fq. 251

²⁸ Marrë nga www.google.com (INA)

rajone janë ashpërsuar shumë. Kjo gjendje shkakton rreziqe të mëdha në rajon dhe nxit konflikte të pandërprera politike. Në anën tjetër, vërehet tendenca e disa qarqeve dhe partive të ndryshme politike në pushtet, që t'i mohojnë të drejtat dhe liritë elementare të kombeve të ndryshme. Posaçërisht, në mënyrë më drastike pengohet aktiviteti i lirë politik. Bëhet ndjekja dhe persekutimi i anëtarëve dhe i aktivistëve të partive, të grupeve dhe të organizatave të ndryshme që angazhohen dhe që luftojnë për interesat dhe të drejtat jetike të kombeve, të popujve dhe të etnikumeve të ndryshme. Në këto shtete dhe shoqëri, përherë janë të pranishme kundërthëniet të cilat sjellin krime të llojllojshme.²⁹

Kjo gjendje e konfliktit permanent politik, përveç që ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e dhunës politike dhe të kriminalitetit politik, ndikon edhe në shtimin e kriminalitetit të përgjithshëm. Konfliktet politike e favorizojnë kriminalitetin e dhunës, korrupsionin, rryshfetin dhe krimin e organizuar.

3.6. Arsimimi

Arsimimi është një faktor me rëndësi në formimin dhe në ngritjen e personalitetit të njeriut për një jetë më të sigurt dhe më të suksesshme. Një kohë të gjatë është menduar se arsimimi është mjet i fuqishëm për parandalimin e sjelljeve devijuese dhe kriminale. Personat e paarsimuar më vështirë mund të kyçen në shumë procese jetësore. Atyre u mungon aftësia për t'i kuptuar dhe për t'i gjykuar drejt pasojat e veprimeve të ndryshme, për ç'arsye ata nuk janë të aftë t'u rezistojnë nxitjeve dhe sprovave të ndryshme të mjedisit shoqëror.

Shpeshherë në literaturën kriminologjike, për t'u dëshmuar roli dhe rëndësia që ka arsimimi dhe dituria, përmendet një mendim i shkrimtarit të madh francez, **Viktor Ygos**: **“Hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu”**.

Pa marrë parasysh pikëpamjet e ndryshme që u prezantuan, është një e vërtetë e pamohueshme se të dhënat e ndryshme të statistikave gjyqësore, të shumë vendeve, tregojnë se pjesëmarrja e personave të paarsimuar ose me shkallë të ulët të arsimimit është e madhe në kryerjen e veprimeve kriminale, duke përfshirë edhe vrasjen në shumë vende të botës. Në botën bashkëkohore, në kryerjen e disa veprimeve kriminale po rritet pjesëmarrja e personave me arsimim të lartë. Kryerësit e veprave penale të kriminalitetit ekonomik, të kriminalitetit politik, të krimit të organizuar, të jakës së bardhë dhe të kriminalitetit profesional, në të shumtën e

²⁹ R. Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë 2008, fq. 253

rasteve janë persona të arsimuar, persona të cilët kanë njohuri dhe përgatitje profesionale të gjithanshme ekonomike, financiare dhe politike.³⁰

Numri i personave të cilët herët e braktisin shkollimin në RM është si vijon³¹:

| Viti | Gjithsej |
|------|----------|
| 2008 | 31.4% |
| 2009 | 26.8% |
| 2010 | 30.1% |
| 2011 | 27.4% |
| 2012 | 25.7% |
| 2013 | 23.1% |
| 2014 | 22.2% |
| 2015 | 19.9% |
| 2016 | 19.6% |
| 2017 | 16.2% |

Në vazhdim do të paraqes të dhënat statistikore për personat që e kanë braktisur shkollimin: Në vitin 2008 e kanë braktisur shkollimin 31.4% e popullatës; prej tyre 18.2% janë meshkuj, kurse 13.2% janë femra. Në vitin 2009 e kanë braktisur shkollimin 26.8% e popullatës ku 12.4% janë femra dhe 18.4% janë meshkuj. Në vitin 2010 e kanë braktisur shkollimin 30.1% e popullatës ku 18.1% janë femra, kurse 12% janë meshkuj. Në vitin 2011 e kanë braktisur shkollimin 25.7% ku 10.3% janë femra, kurse 17.1% janë meshkuj. Në vitin 2012 e kanë braktisur shkollimin 25.7% e popullatës ku 18.3% janë femra, kurse 7.4% janë meshkuj. Në vitin 2013 e kanë braktisur shkollimin 23.1% e popullatës ku 7.1% janë femra dhe 16% janë meshkuj. Në vitin 2014 e kanë braktisur shkollimin 22.2% e popullatës ku 12.2% janë femra dhe 10% janë meshkuj. Në vitin 2015 e kanë braktisur shkollimin 19.9% e popullatës ku 8.4% janë femra dhe 11.5% janë meshkuj. Në vitin 2016 e kanë braktisur shkollimin 19.6% e popullatës ku 12.3% janë femra dhe 7.8% janë meshkuj. Në vitin 2017 e kanë braktisur shkollimin 16.2% e popullatës ku 3.1% janë femra dhe 13.1% janë meshkuj.

³⁰ R. Halili, "Kriminologjia", Prishtinë, 2008

³¹ Të dhëna të marra nga Enti shtetëror për statistik nga broshura "Maqedonia në numra, 2012"

3.7. Mjetet e informimit

Konstatimet lidhur me ndikimin dhe rolin e mjeteve të komunikimit masiv në kriminalitet, janë të llojlojshme. Prandaj theksohet nevoja që kjo çështje të analizohet dhe të vështrohet në mënyrë të gjithanshme, duke e theksuar në mënyrë objektive rolin dhe rëndësinë e këtyre mjeteve në paraqitjen e kriminalitetit apo në parandalimin e tij. Është fakt i pamohueshëm se mjetet e komunikimit masiv mund të ndikojnë në formimin e drejtë dhe të gjithanshëm të personalitetit, kur në to transmetohen, paraqiten dhe kultivohen përmbajtje dhe emisione që kanë vlera të shëndosha morale, ligjore, edukative, shkencore, artistike dhe zbavitëse. Përmbajtjet e këtilla, të prezantuara me anë të mjeteve të komunikimit masiv ndikojnë në pengimin e sjelljeve delikuede dhe kriminale.³²

3.8. Faktorët subjektivë

Sado që faktorëve të jashtëm apo objektivë u takon një rol me rëndësi në paraqitjen e sjelljeve kriminale, dukuria e kriminalitetit dhe shkaqet e tij, në fund nuk mund të shpjegohen drejt pa analizën dhe ndriçimin e faktorëve të brendshëm, subjektivë. Zakonisht mendohet për individin, për personalitetin e njeriut, në rastin konkret të njeriut delikuent³³. Në literaturën kriminologjike, faktorët subjektivë të sjelljes kriminale zakonisht ndahen në faktorë psikologjikë ose psikikë dhe në faktorë biologjikë. Ndër to po përmendim: **personaliteti, karakteri, temperament, shprehitë, prirjet, inteligjenca, emocionet, motivet.**

3.8.1. Personaliteti

Personaliteti i njeriut është i ndërtuar në baza psikike dhe biologjike. Këto janë dy komponentë me rëndësi për zhvillimin dhe për formimin e tij si personalitet normal. Njeriu si personalitet, ka një strukturë të veçantë psikike e cila nga lindja e deri në vdekje ka ndikim të madh në sjelljet dhe në veprimet e tij. Varësisht sesi është zhvilluar, është formuar dhe është kultivuar personaliteti gjatë jetës së tij, baza psikike ka ndikim dhe reflektohet në sjelljet dhe në veprimet e tij. Bota shpirtërore e psikike e njeriut është komplekse, e nduarnduarshme. Në shumë raste, disa veprime dhe sjellje të individëve nuk mund të kuptohen në shikim të parë.

³² R. Halili, "Kriminologjia" Prishtinë 2008, fq. 263

³³ R. Halili, Po aty, fq. 339

Njeriu si personalitet, paraqet strukturë të veçantë. Bota e tij e brendshme, bota psikike, ka rëndësi të veçantë në shpjegimin e sjelljeve kriminale³⁴.

3.8.2. Karakteri

Karakteri është një ndër vetitë kryesore të personalitetit të njeriut. Karakteri konsiderohet si cilësi esenciale e një personaliteti. Në literaturën psikologjike, shpeshherë kuptimi ose nocioni **karakter** identifikohet me nocionin **personalitet**. Kësisoj, në të folurit e përditshëm dëgjohej të thuhet për një njeri se ai është “karakter i fortë” ose “i dobët”, “labil” etj. Mirëpo, kuptimi ose nocioni karakter këtu paraqet vetëm një veti psikike të një individi, të një personi, e jo individin komplet apo personalitetin e tij. Duhet shtuar se kur flitet për karakterin, zakonisht mendohet për vetitë më të qenësishme të individit apo për cilësitë të cilat e vulosin tërë aktivitetin njerëzor të tij. Kështu, si komponentë të karakterit, në literaturën psikologjike dhe kriminologjike konsiderohen: vullneti, qëndrueshmëria, vendosmëria, konsekuenca, iniciativa, guximi, besnikëria, altruizmi, stabiliteti, siguria etj.

Me karakter duhet kuptuar para së gjithash, sistemin e tipareve dhe të vetive të personalitetit të cilat tregojnë si vepron individi, përballë disa parimeve dhe vlerave morale të shoqërisë së caktuar. Pra, si karakter trajtohen të gjitha ato veti që tregojnë qëndrimin e individit ndaj disa parimeve, vlerave dhe rregullave morale e etike të shoqërisë apo të ambientit të caktuar. Mirëpo, shpeshherë këto veti nuk përmbushen nga një individ.³⁵

Si individ me karakter të fortë cilësohen personat që e flasin të vërtetën, që e mbrojnë të vërtetën, personat që nuk gënjejnë, personat që nuk u nënshtrohen motiveve dhe interesave të ulëta dhe lakmisë materiale. Si persona me karakter konsiderohen edhe personat që janë konsekuentë në qëndrimet dhe në pikëpamjet e tyre për ndonjë çështje apo për ndonjë problem. Përkundrazi, si persona me karakter të dobët konsiderohen ata individë të cilëve u mungojnë këto veti.

3.8.3. Temperamenti

Temperamenti është një veti dhe cilësi me rëndësi psikike për individin, e cila manifestohet në reagimin e tij ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve të ndryshme, të jashtme.

³⁴ R. Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë 2008, fq. 340

³⁵ R. Halil, Po aty, fq. 341

Temperamenti nuk paraqet vetëm mënyrat e reagimit psikik. Ai nënkupton shpejtësinë dhe zgjatjen e reaksioneve të individit ndaj ngjarjeve dhe ngacmimeve të ambientit që e rrethon.³⁶ Për këtë arsye, disa autorë me të drejtë me nocionin "temperament" nënkuptojnë mobilizimin e energjisë që disponon individit në drejtim të caktuar. Njerëzit ndahen në katër tipa themelorë të temperamentit: **kolerik, sanguinik, flegmatik dhe melankolik.**

Temperamenti kolerik si tip i individit, manifestohet me ndjenja dhe emocione intensive, me vendosjen e lehtë për të ndërmarrë ndonjë aktivitet apo veprim. Ky tip i personalitetit shqetësohet shpejt, për gjëra të imta dhe të vogla bie në konflikt me individë dhe me persona të tjerë. Gjithashtu, këta tipa zemërohen e hidhërohen shpejt dhe këtë gjendje e manifestojnë gjatë dhe haptas. Personat e tipit kolerik nuk janë stabil, cilësohen me emocione të vrullshme. Po ashtu, këta persona e ndërrojnë disponimin shpejt. Këta persona, shpeshherë janë të vendosur në ndërmarrjen e disa veprimeve, e nga ana tjetër lehtë bien edhe në gjendje afektive të cilat janë të pafavorshme për ambientin dhe rrethin që i shoqëron. Këto veti të këtij tipi të temperamentit ndikojnë në paraqitjen e disa sjelljeve negative të cilat u paraprijnë aktiviteteve devijuese dhe kriminale³⁷.

Temperamenti sanguinik i përket tipit të personave që gjithashtu reagojnë shpejt, me vrull, mirëpo emocionet e tyre nuk janë aq të fuqishme dhe nuk zgjasin shumë. Edhe këta persona e ndërrojnë disponimin lehtë. Shpeshherë, prej zemërimit të madh kalojnë në gëzim dhe hare. Reaksionet e tyre ndaj ngacmimeve të jashtme janë të shpejta dhe të atypëratyshme, por ato nuk zgjasin shumë sikur te tipi kolerik. Te këta vërehet një ngushtim i aftësisë së gjykimit dhe të logjikimit në situatë të caktuara. Tipat e tillë shpesh i quajnë edhe si persona gjaknxehtë. Për këtë arsye, këta persona shpesh i kryejnë disa sjellje kriminale në afekt, në çaste të cilat shpjegohen si gjendje psikike shpirtërore të veçanta.³⁸

Temperamenti flegmatik paraqet tipin e personit i cili me sjelljet dhe me qëndrimet e veta reagon në mënyrë të ngadalshme dhe rrallë shqetësohet, ndërsa emocionet i ka më të dobëta dhe vështirë manifestohen. Për këtë tip është karakteristikë reagimi i qetë dhe stabil. Tipi flegmatik nuk është i ndjeshëm ndaj ngacmimeve të jashtme, nuk ngutet në marrjen e veprimeve të ndryshme. Karakteristikë tjetër është se gjithmonë përpiqet të gjejë zgjidhje dhe arsyetim për ndërmarrjen e aktiviteteve dhe të reagimeve ndaj ngacmimeve të jashtme. Për këta persona, në bisedat e rëndomta thuhet se "i kanë nervat e forta", se nuk bëhen nervozë për gjëra

³⁶ R. Halili, "Kriminologjia", Prishtinë 2008, fq. 342

³⁷ R. Halili, Po aty, fq. 342

³⁸ R. Halili, Po aty, fq. 343

të imta, se janë indolentë dhe gjakftohtë. Personat që i përkasin këtij tipi, veprimet e ndryshme delikuede dhe kriminale i kryejnë me paramendim³⁹.

Temperamenti melankolik është një tip i veçantë i personalitetit i cili është mjaft i përhapur në jetën e përditshme, e gjithashtu edhe në praktikën gjyqësore. Te këta persona është karakteristike se janë të tërhequr në vetvete, se reagojnë me vonesë, janë të pavendosur. Ata në jetën e përditshme fare lehtë preken dhe fyhen. I përjetojnë rëndë vështirësitë, pengesat, ngjarjet dhe situatat e pakëndshme në jetën e përditshme. Këta persona rëndom janë të preokupuar me ndjenjën dhe shtytjen e vetëvrasjes. Në pikëpamje emocionale janë shumë të ndjeshëm. Në veprimet dhe në reagimet e tyre ndaj ngacmimeve të jashtme vërehet një intensitet i madh emocional. Çrregullimi emocional tek ata është i fuqishëm dhe zgjat shumë. Kështu, shpeshherë gjendja e pakënaqësisë, e dëshpërimit dhe e pikëllimit zgjat me ditë të tëra. Në jetën e përditshme këta persona shpeshherë bëhen të mërzitshëm për familjen dhe për kolektivin dhe vështirë i përshtaten rrethit dhe mjedisit shoqëror. Tipat melankolikë më rrallë kryejnë krime, mirëpo krimet e tyre, rëndom janë të rënda, të përcjella me intensitet të fuqishëm të emocioneve. Këta persona zakonisht kryejnë krime nga xhelozia, sidomos nga xhelozia në dashuri, në martesë, për shkak të rivalitetit në punë, në gara, në mësim etj.⁴⁰

3.8.4. Shprehitë, prirjet dhe kriminaliteti

Shprehitë dhe prirjet janë veti subjektive të individit dhe shpeshherë luajnë rol me rëndësi në sjelljet e tij. Si veti psikologjike, shprehitë krijohen, zhvillohen dhe ndryshojnë, varësisht nga ndikimet e mjedisit shoqëror në të cilin jeton dhe formohet individi. Zakonisht, shprehitë dhe prirjet formohen nën ndikimin e vazhdueshëm të edukatës, të raporteve shoqërore-ekonomike, kulturore dhe familjare. Ndikimet nga jashtë kanë ndikim të dukshëm në formimin e shprehive të individit. Nëse ndikimet janë të fuqishme dhe të vazhdueshme, ato lënë gjurmë të thella në shpirtin dhe në psikën e personalitetit të njeriut. Duke qëndruar një kohë të gjatë në mjedisin e caktuar shoqëror, individi pranon, absorbon dhe merr ndikime nga rrethi familjar, nga rrethi shkollor, nga mjedisi shoqëror, nga mjetet e informimit, nga literatura dhe nga filmi. Në këtë mënyrë ai formohet me veti dhe me shprehi të caktuara. Siç dihet, në këtë mënyrë individë të ndryshëm në procesin mësimor, edukativ dhe të punës fitojnë dije e shprehi dhe zhvillojnë e përsosin prirje të caktuara, në pjesën më të madhe për punë

³⁹ R. Halili, Po aty, fq. 343

⁴⁰ R. Halili, "Kriminologjia", Prishtinë 2008, fq. 345

konstruktive dhe të dobishme. Nëse në një mjedis në të cilin lind, zhvillohet, edukohet dhe formohet një personalitet dominojnë rrethana dhe kushte të pafavorshme familjare, sociale, shkollore etj., vetvetiu mund të vijë deri te formimi i disa shprehive dhe prirjeve që janë rezultat i ndikimit të gjendjeve të këtilla. Nëse një individ rritet dhe zhvillohet në një mjedis ku vjedhja, mashtrimet, falsifikimet, konfliktet, deliktet seksuale dhe konsumimi i drogës janë dukuri të rëndomta, është krejtësisht e arsyeshme të pritet që pas një kohe ai individ të formohet në mënyrë negative, të fitojë shprehi dhe prirje të cilat e nxisin në veprime dhe sjellje të njëjta kriminale. Në këtë mënyrë theksohet se individ i që gjendet nën ndikimin e një rrethi të caktuar shoqëror, fiton shprehi dhe prirje të cilat atë e zhvillojnë në një delikuent profesional. Në këtë mënyrë ai vjen dhe specializohet për kryerjen e një lloji të caktuar të sjelljeve kriminale.

Karakteristikë e delikenteve për nga shprehitë dhe prirjet është se nuk ndjejnë përgjegjësi për veprimet dhe sjelljet devijuese dhe antishoqërore. Për këto veprime, ata nuk pendohen⁴¹.

3.8.5. Inteligjenca

Inteligjenca është një veti me rëndësi e personalitetit, e cila ka ndikim të madh në sjelljet dhe në veprimet e tij në jetën e përditshme. Mendohet se inteligjenca paraqet një aftësi unike, pra ajo është një tërësi e vetëdijes dhe e aftësive të personalitetit. Mirëpo, ka edhe mendime se inteligjenca përbëhet prej një varg aftësish. Inteligjenca si veti psikike e individit është mjaft komplekse dhe përbëhet prej një varg faktorësh dhe aftësish të cilat e përcaktojnë lartësinë, vëllimin dhe cilësinë e inteligjencës së një individit. Në literaturën psikologjike dhe kriminologjike theksohet se inteligjenca paraqet një sferë me rëndësi të jetës shpirtërore të çdo njeriu dhe si e tillë, ajo ushtron ndikime të shumta në veprimet dhe në sjelljet e njeriut. Në këtë drejtim veçmas vështrohet ndikimi i saj në sjelljet delikente dhe kriminale.⁴²

3.8.6. Emocionet

Njeriu, edhe pse është qenie racionale, nuk vepron gjithherë kësisoj, por shpeshherë është i detyruar të ndërmarrë disa veprime dhe sjellje që nxisin gjendje të posaçme emocionale të cilat ndikojnë shpeshherë në sjellje dhe veprime kriminale⁴³. Për këtë arsye theksohet se

⁴¹ R. Halili, "Kriminologjia", Prishtinë 2008, fq. 345

⁴² R. Halili, Po aty, fq. 346

⁴³ R. Halili, Po aty, fq. 349

ndjenjat apo emocionet paraqesin përjetime subjektive të njeriut ndaj asaj që ai di dhe vepron, ndaj të tjerëve dhe ndaj sjelljeve dhe veprimeve të veta. Këto përjetime emocionale të njeriut emërtohen me fjalët: afekt, brengosje, dashuri, dhembje, frikë, gëzim, hidhërim, indinjatë, kënaqësi, lemeri, mallëngjim, neveri, rënkim, shpresë, dëshpërim, tmerr, zemërim etj.

3.8.7. Motivet

Motivet janë gjithashtu cilësi dhe veti të personalitetit. Aktiviteti njerëzor, veprimet dhe angazhimet e individit paraqiten dhe zhvillohen në bazë të disa shtytjeve dhe nxitjeve të brendshme. Motivet janë fuqitë nxitëse të cilat e shtyjnë një individ që të jetë aktiv, e orientojnë dhe e udhëheqin aktivitetin e tij në jetë. Motivet, si veti të personalitetit përbëhen prej elementeve të vetëdijes dhe të vullnetit. Për këtë arsye, në literaturën kriminologjike dhe psikologjike thuhet se të gjitha aktivitetet njerëzore paraqiten dhe zhvillohen në bazë të elementeve të vetëdijes dhe të vullnetit, sepse të gjitha janë të motivuara. Sjelljet kriminale, si aktivitete të vetëdijshme dhe të ndërmarra me vullnet të njeriut janë gjithashtu të nxitura dhe të drejtuara nga forcat e tilla të brendshme⁴⁴. Është e njohur që çdo individ apo person normal, para se të ndërmarrë një veprim, sjellje dhe aksion duhet të mendojë që të vendosë dhe të vihet në lëvizje nga disa shtytje dhe nxitje të brendshme. Këto veprime të individit janë të përbëra nga një varg procesesh që nxiten dhe shtyten nga forcat e brendshme që gjenden në sferën e vetëdijes dhe të vullnetit të tij. Pra, të gjitha sjelljet dhe veprimet e individëve janë të motivuara. Çdo aktivitet i njeriut normal është aktivitet i nxitur nga motivet, nga vetëdija dhe nga vullneti i tij.

Për këtë arsye, thuhet se nuk ka aktivitete dhe sjellje të pamotivuara. Pra edhe aktiviteti kriminal në literaturën juridiko-penale dhe kriminologjike trajtohet si proces dhe veprim që është i motivuar, që nisat prej disa shtytjeve dhe nxitjeve të brendshme. Këto shtytje dhe nxitje i motivojnë interesat, nevojat, dëshirat e ndryshme të individit të cilat gjithashtu mbështeten në vetëdijen dhe në vullnetin e tij. Kur flitet për motivin dhe motivimin e sjelljeve të njeriut, gjithmonë kihet parasysh njeriu dhe personaliteti normal. Te këta persona është karakteristikë se veprojnë në mënyrë të vetëdijshme, racionale, ndërsa personat me motive të çrregulluara reagojnë dhe veprojnë në mënyrë të pakuptueshme, ndërsa në veprimet dhe në sjelljet e tyre nuk vërehen motive të qarta. Për këtë arsye, personat e tillë zakonisht kanë përgjegjësi të zvogëluar ose nuk përgjigjen fare.

⁴⁴ R. Halili, "Kriminologjia", Prishtinë 2008, fq. 252

4. Viktimat e krimeve të vrasjes

Sipas kërkimeve kriminologjike dhe viktimologjike, në shumë vende të botës, numrin më të madh të viktimave e përbëjnë ato që janë pasojë e dhunës së krimeve të ndryshme, që atakojnë jetën dhe trupin e njeriut. Krimet e vrasjeve, të plagosjeve, të lëndimeve trupore janë shumë të përhapura dhe si të tilla shkaktojnë edhe numër të madh të viktimave. Nëse vështrohen të dhënat e ndryshme mbi numrin e krimeve të vrasjes ose të krimeve të plagosjes brenda periudhave të ndryshme kohore, vetvetiu del se edhe numri i viktimave prej tyre është i madh. Viktimat e dhunës kundër jetës dhe trupit zakonisht rrjedhin nga rastet e veprave penale të vrasjeve, të plagosjeve dhe të lëndimeve trupore, të shtytjeve në vetëvrasje dhe të ndihmës në vetëvrasje, të pjesëmarrjes në rrahje, në grabitje dhe në vjedhje me thyerje me pasoja të vdekjes apo të lëndimeve të rënda trupore⁴⁵.

4.1. Raporti ndërmjet viktimës dhe kryerësit të krimit te krimi i vrasjes

Fenomeni i viktimave të krimeve kundër jetës dhe trupit, veçmas të krimeve të vrasjeve i ka nxitur shumë autorë të njohur që të merren me kërkimin dhe hulumtimin e disa veçorive të raporteve ndërmjet viktimës dhe shkaqeve të viktimizimit. Një ndër autorët e parë të studimeve viktimologjike, Benjamin Mendelsohn ka qenë i mahnitur me njohuritë dhe me përvojën nga praktika si avokat lidhur me raportin, kontributin dhe rolin e viktimës në paraqitjen e krimit të vrasjes dhe të disa krimeve tjera kundër personalitetit⁴⁶.

Në praktikë ndodh që viktima të gjendet në pozitë pasive dhe indiferente, kur viktima nuk ka pasur kurrfarë kontakti dhe nuk është njohur më parë me kryerësin e krimit dhe ajo viktimizohet papritmas dhe aksidentalisht. Por, ka raste kur viktima dhe kryerësi më parë janë njohur dhe kanë pasur raporte të ndryshme ndër vete. Kërkimet e bëra mbi raportet në mes kryerësit dhe viktimave të vrasjes në disa vende, si Gjermani, SHBA etj., dëshmojnë se kryerësit e vrasjeve dhe viktimat e tyre rrjedhin nga anëtarët e grupeve primare, si anëtarë të familjes së ngushtë, miq të afërt, njerëz të tjerë të njohur. Në këto raporte, si viktima paraqiten deri në 52 % të të gjitha rasteve. Ndërsa në grupin e dytë bëjnë pjesë njerëz, persona që pak a

⁴⁵ R. Halili, "Viktimologjia", Prishtinë 2008, fq. 65

⁴⁶ R. Halili, Po aty, fq. 66

shumë janë njohur, por që nuk janë të rrethit të ngushtë dhe ata përbëjnë 40 % të rasteve të vrasjeve, domethënë të viktimave.

4.2. Motivet e viktimizimit te vrasjet

Nëse shikohen motivet dhe arsyet më të shpeshta të viktimizimit te krimet kundër jetës dhe trupit, veçmas te vrasjet, del se ato shpesh janë të nxitura nga sulmi dhe atakimi fizik i vetë viktimës ndaj kryerësit. Sipas disa kërkimeve të dukurisë së vrasjeve, del se këto raste përbëjnë rreth 14,4 %. Si motiv dhe nxitje për viktimizim paraqiten rastet e çrregullimeve të rënda të raporteve familjare, martesore, fqinjësore, fafëfisnore, banesore, në mjedisin e caktuar etj. Në këto raste, viktimat e para e provokon kryerësin. Sjelljet agresive të viktimës në familje, në raportet martesore, në raportet me fqinjët gjithashtu janë të shpeshta⁴⁷.

Hakmarrja, gjakmarrja ndaj viktimës për cenim nderi, për shkaktim të plagëve, për shkak të vrasjes së mëparshme të ndonjë të afërmi të kryerësit, po ashtu janë motive që nxisin viktimizimin. Këto motive marrin pjesë gati në 12 % të rasteve. Xhelozia në lidhje dashurie apo në martesë, xhelozia dhe rivaliteti në dashuri apo në sferën e biznesit, ose në punë të tjera janë rast i shpeshtë i viktimizimit dhe i viktimave te krimet e vrasjes.

Në Sektorin për punë të brendshme në Tetovë është denoncuar një rast ku një person vritet me sëpatë në gjumë nga një person nga Tetova. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 8 e 30 të mëngjesit, më 17.10. 2014 në rrugën “Ivo Ribar Lolla”, kur gjyshi i viktimës, 68 vjeçar, e ka marrë sëpatën dhe ka shkuar drejt dhomës ku ka qenë duke fjetur nipi i tij.⁴⁸ Pas vrasjes që e ka kryer gjyshi i të ndjerit, është drejtuar për në polici ku e ka treguar rastin. Sipas informacioneve jozyrtare të policisë së Tetovës, mësohet se shkakut i vrasjes kanë qenë marrëdhëniet e prishura mes prindërve të të vërrit dhe gjyshit të tij, i cili për një kohë të gjatë ka jetuar dhe ka punuar në Perëndim. Ndërsa sipas Sektorit të punëve të brendshme të Tetovës, as vrasësi dhe as viktimat nuk kanë pasur precedent penal.

4.3. Moshat e viktimave të vrasjes

Moshat e viktimave të vrasjeve përafërsisht përputhet me moshën e kryerësve të tyre. Në studimet empirike të krimit të vrasjeve, të bëra në shumë vende, del se si viktimat më shpesh

⁴⁷ R. Halili, “Viktimologjia”, Prishtinë 2007, fq. 68

⁴⁸ Të dhëna të marra nga Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë

paraqiten personat mes moshës 20 dhe 45 vjeç. Si viktimat dominojnë personat e moshës më aktive të popullatës në shoqëri. Kjo është e kuptueshme, ngase kjo kategori e grupmoshave është edhe më e pranishme në rrjedhat e jetës së përditshme dhe njëherësh më e rrezikuara nga takimet e llojllojshme.⁴⁹

Fëmijët dhe të miturit bëhen viktimat të vrasjeve më rrallë, ndërsa kur viktimizohen, kjo ndodh për shkak të paaftësisë së tyre që vetë të mbrohen dhe të kujdesen për veten e tyre.

Sipas një analize të kryerësve të vrasjeve sipas moshës së tyre, të kryer nga MPB-ja, numri më i madh janë të moshës prej 35 deri 50 vjeç, 13 vetë janë të moshës 18 deri 35 vjeç, shtatë vetë janë të moshës mbi 50 vjeç, prej të cilëve më i vjetri ka pasur 68 vjet. Kryerësi më i ri për vrasje në vitin 2012 është adoleshent i moshës 16 vjeçare, i cili me shufër të metalit ka vrarë një person 49 vjeçar⁵⁰.

4.4. Gjinia e viktimave të vrasjes

Për sa i përket gjinisë së viktimave të krimeve të vrasjeve, ato janë më tepër të gjinisë mashkullore. Mirëpo, edhe femrat paraqiten si viktimat. Ky konstatim deri diku përputhet edhe me faktin se edhe në kryerjen e krimeve të vrasjeve meshkujt marrin pjesë disa herë më shumë se femrat. Kërkimet e ndryshme viktimologjike dhe kriminologjike në vende të caktuara vërtetojnë se femrat janë disa herë më shumë viktimë e krimit të vrasjes sesa që janë kryerëse të këtyre krimeve.⁵¹ MPB-ja nënvizon se nga analiza e viktimave sipas gjinisë, në vitin 2012, 27 viktimat janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 9 viktimat janë femra⁵².

Në qytetin e Tetovës sipas të dhënave të Gjykatës themelore, numri i viktimave sipas gjinive është si vijon:

| VITI | FEMRA | MESHKUJ |
|-------------|--------------|----------------|
| 2012 | 2 | 12 |
| 2013 | / | 4 |
| 2014 | 1 | 5 |
| 2015 | 2 | 5 |
| 2016 | / | 10 |

⁴⁹ R. Halili, Po aty, fq. 69-70

⁵⁰ Të dhëna të marra nga Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë

⁵¹ R. Halili, "Viktimologjia", Prishtinë 2007, fq. 70

⁵² Të dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë

Duke u bazuar në të dhënat e marra nga Gjykata themelore e Tetovës, numri i viktimave për periudhën kohore 2012-2016 është si vijon: Në vitin 2012 kemi 2 viktimë të gjinisë femërore, 10 të gjinisë mashkullore dhe 2 të mitur të gjinisë mashkullore. Në vitin 2013 nuk ka asnjë viktime femër dhe kemi 4 viktimë meshkuj. Në vitin 2014 kemi 1 viktimë të gjinisë femërore dhe 4 viktimë të gjinisë mashkullore. Në vitin 2015 kemi 2 viktimë të gjinisë femërore dhe 5 viktimë të gjinisë mashkullore. Në vitin 2016 nuk kemi asnjë viktimë të gjinisë femërore, por kemi 10 viktimë të gjinisë mashkullore.

Përfundim

Gjatë këtij hulumtimi dhe me paraqitjen e të gjitha të dhënave në këtë punim mund të konstatojmë se vepra penale e vrasjes ka shënuar rritje jo vetëm në qytetin e Tetovës por në mbarë territorin e RM-së. Këto fakte janë shqetësuese, pasi me vrasje nënkuptojmë atë veprim me të cilin cenohet një nga të drejtat themelore të njeriut që është e drejta e tij për jetë. Prandaj edhe dukuria e vrasjes duhet që të parandalohet jo vetëm në qytetin e Tetovës, por në përgjithësi në mbarë vendin.

Faktorët që ndikojnë në krimin e vrasjes janë të ndryshëm. Në mesin e tyre bëjnë pjesë faktorët objektivë dhe subjektivë. Në mesin e faktorëve objektivë bën pjesë edhe papunësia e cila po dominon me të madhe në vitet e fundit në RM dhe përmendet si një nga faktorët me rëndësi në paraqitjen e krimit të vrasjes. Prandaj, institucionet shtetërore duhet të jenë të alarmuara nga faktet në terren, me qëllim që të ndërmarrin masa të përkatëse me të cilat do të ulen niveli i papunësisë, pasi shumë persona në Tetovë jetojnë në varfëri të skajshme, pa pasur mundësi të tjera të inkuadrohen në grupe të ndryshme, ndaj kryejnë vepra nga më të rëndat, duke përfshirë edhe vrasjet.

Shteti ynë ka për obligim që të ndërmarrë masa të cilat do të parandalonin veprën penale të vrasjes, pasi me këtë veprë rrezikohet jeta e njeriut e cila është e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Në luftë kundër veprës penale të vrasjes duhet të inkuadrohen të gjitha institucionet, e sidomos policia, gjykata, prokuroria, institucionet ndëshkuese etj. Si faktorë të cilët kanë ndikuar që në Tetovë të ketë rritje të veprës penale të vrasjes mund të potencojmë edhe konfliktin e armatosur në vitin 2001. Pas kësaj periudhe, konkretisht nga viti 2012 e këndej, në Tetovë janë kryer krime të rënda të vrasjes në mënyrë misterioze, kurse shumë raste nuk janë zbardhur dhe kryerësit ecin të lirë, pa u ndëshkuar për krimin e kryer.

Në qytetin e Tetovës, për fat të keq, pjesëmarrës në kryerjen e krimit të vrasjes janë edhe personat e mitur. Ky fakt është konstatuar nga të dhënat statistikore të gjykatës dhe të institucioneve të tjera. Prandaj nevojitet një qasje më serioze në këtë drejtim, pasi bëhet fjalë për persona të mitur të cilët gjenden në fazën e zhvillimit bio-psikik dhe duhet të edukohen drejtë. Nëse ata që në moshën të reja kyçen në kryerjen e veprave të tilla, e ardhmja nuk do të jetë e ndritur, pasi në çdo shoqëri ku nuk ka rini të shëndoshë, ka ngecje.

Po ashtu, në qytetin e Tetovës, në vitet e fundit janë paraqitur shumë raste të vrasjeve të kryera nga anëtarë të familjes me mjete të ndryshme dhe të kryera në mënyrë mizore. Të dhënat statistikore nga hulumtime të ndryshme flasin se qyteti i Tetovës renditet i dyti në vendin tonë për nga numri i vrasjeve, që tregon për rëndësinë që duhet t'i kushtohet kësaj dukurie negative.

Prandaj institucionet shtetërore duhet në terren t'i bëjnë hapat e duhur, për të ndikuar në parandalimin e vrasjes, si janë çelja e vendeve të punës, ndëshkimi e personave fajtorë me qëllim që në të ardhmen të parandalohen veprat penale të vrasjes, vetëdijesimi i popullsisë në mënyra të ndryshme, ndihma viktimave të krimit të vrasjeve, si në momentin e viktimizimit, ashtu edhe më pas, inkurajimi i tyre që t'i denoncojnë rastet e vrasjeve. Po ashtu, personat që kanë kryer vrasje, gjatë vuajtjes së dënimit me burg duhet të përgatiten për jetën në liri, duhet të punohet me ta që ta kuptojnë gabimin e tyre dhe të mos e përsërisin. Pra, duhet të kthehen në shoqëri të shëndoshë, e kjo arrihet nëse pas daljes nga burgu, të njëjtit kyçen në shoqëri dhe jo të anashkalohen për shkak të së kaluarës së tyre. Këta persona, me vetë faktin që kanë gabuar, janë ndëshkuar dhe pas dënimit duhet të kthehen në shoqëri. Por kthimi i tyre, jo çdoherë është i mirëpritur nga njerëzit të cilët mund t'u shkaktojnë pengesa të ndryshme. Qëndrimet e tilla mund të ndikojnë që ai të shndërrohet në recidivist.

Literatura

I - Libra

- Dr. Vllado Kambovski & Dr. Ismail Zejneli, E drejta penale, Tetovë 2018;
- Dr. Ismail Zejneli, “E drejta penale pjesa e posaçme”, Tetovë 2007;
- Dr. Ismail Zejneli, “Delikuenca e të miturve në Republikën e Maqedonisë”, Tetovë 2008;
- Dr. Ismail Zejneli, “Delikuenca e të miturve”, Tetovë 2018;
- Dr. Vesel Latifi, “Kriminalistika”, Prishtinë 2015;
- Dr. Vesel latifi, “Politika kriminale”, Prishtine 2008;
- Dr. Ragip Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë 2014;
- Dr. Ragip Halili, “Viktimologjia”, Prishtinë 2012;
- Dr. Ragip Halili, “Kriminaliteti kundër martesës dhe familjes në Kosovë-monografi”, Prishtinë 1987;
- Dr. Ragip Halili, “Vrasja dhe hakmarrja”, Prishtinë 1969;
- Dr. Ragip Halili “Shkaqet dhe kushtet ekonomike-shoqërore të delikteve të gjakut në Kosovë”, Prishtinë 1971;
- Dr. ”Ragip Halili, ”Aspekti juridik dhe kriminologjik i alkoolizmit dhe i narkomanisë, Prishtinë 1984;
- Dr. Ragip Halili, “Për një tretman më adekuat dhe më me përgjegjësi ndaj të miturve”, Prishtinë 1983;
- Dr. Ragip Halili, “Kriminologjia dhe penologjia”, Prishtinë 1995;
- Dr. Ragip Halili, “Disa veçori kriminologjike të kriminalitetit ekonomik”, Prishtinë 2002;
- Dr. Vllado Kambovski, “Kazneno pravo, poseben del”, Shkup 1997;
- Dr. Vllado Kambovski, “Megjunarodno kazneno pravo”, Shkup 1998;
- Dr. Ejup Sahiti, “Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurën penale”, Prishtinë 1993;
- Dr. Ejup Sahiti, “Argumentet në procedurën penale”, Prishtinë 1993;
- Dr. Zejnulla Gruda, “E drejta ndërkombëtare publike”, Prishtinë 2007;
- Dr. Zejnulla Gruda, “Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut”, Prishtinë 2007;
- Dr. Joseph.L. Albini, “The american mafia: genesis of a legenda Appleton-Century-Crofts”, New York 1971;

- Dr. Adrioong Bongger, “Race and crime”, New York 1963;
- Dr. Jean Carbonnier, “Sociologie juridique”, Paris 1972;
- Dr. Maria Ginanini, “Aspetti economici della criminalita Trattato di criminologia”, Milano 1987;
- Dr. Konrad Lorenz, “OOon Aggresion”, New York 1971;
- Dr. Jean Pinatel, “La criminology”, Paris 1979;
- Dr. Jean Pinatel, “Alcoolisme et criminalite, Revue de science criminelle”, Paris 1958;
- Dr. Jean Pinatel, “La societe criminogene”, Paris 1971;
- Dr. Jean Pinatel, “La definition criminologique de crime et le caractere scientifique de la criminology”, Paris 1957;
- Dr. Jean Pinatel, “Clacifications des criminels”, Paris 1956;
- Dr. Ismet Salii, “E drejta penale”, Prishtinë 2015;
- Dr. Ismet Elezi, “E drejta penale”, Tiranë 2004;
- Dr. Krivokapić Vladimir, “Prevenција kriminaliteta”, Beograd 2002;
- Dr. Leonard Prifti, “Psikologjia e krimit”, Tiranë 2003;
- Politika e luftimit të kriminalitetit, Grup autorësh, Prishtinë 2012;
- Dr. Alija Ramljak, “Kriminalistika mjekësore”, Sarajevë/Prishtinë 2007;
- Dr. Aleksić Živojin, Škulić Milan i Žarković Milan, “Leksikon kriminalistike”, Beograd 2004;
- Dr. Fatos Haziri, “E drejta e policisë”, Prishtinë 2010;
- Dr. Srđan Aleksić, “Pritvor u krivičnom pravu”, Niš 2009.

II - Burime të tjera

- Kodi penal i Republikës së Maqedonisë;
- *Të dhëna nga Gjykata themelore e Tetovës;*
- *Të dhëna nga Sektori i punëve të brendshme në Tetovë;*
- *Të dhëna nga Ministria e punëve të Brendshme e Maqedonisë;*
- *Të dhëna të marra nga Enti Shtetëror i Statistikës;*
- Interneti (Agjencia Informative e Maqedonisë (MIA));
- www.google.com (INA);
- Enti Shtetëror i Statistikës nga broshura “Maqedonia në numra, 2012”.